

20
24

VJETARI

Statistikor Rajonal

Q A R Q E D H E B A S H K I

VJETARI 2024

Statistikor Rajonal

Q A R Q E D H E B A S H K I



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confederation suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zviceriane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



VJETARI RAJONAL STATISTIKOR, 2024

Drejtori i Publikimeve:
Dr. ELSA DHULI

Përgatitur nga INSTAT

© Copyright INSTAT 2024

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mënyre pa lejen paraprake me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 355 4 2233358 / 2233356
Fax: +355 4 2222 411
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al



Pikëpamjet dhe konkluzionet e përfshira në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të qeverisë Zvicerane ose të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE DHE MIRËNJOHJE.....	7
I. PROFILI STATISTIKOR I PREFEKTURAVE.....	9
II. STRUKTURA ADMINISTRATIVE DHE NJËSITË TERRITORIALE TË SHQIPËRISË	25
1. POPULLSIA.....	31
2. NDËRTESAT	45
3. TREGU I PUNËS DHE PAGAT	51
4. KONSUMI I FAMILJEVE	65
5. MBROJTJA SOCIALE.....	75
6. ARSIMI	87
7. SHËNDETËSIA.....	101
8. KRIMI DHE DREJTËSIA PENALE.....	109
9. STATISTIKAT E BIZNESIT	117
10. BUJQËSIA	129
11. BLEGTORIA	151
12. TURIZMI	161
13. TRANSPORTI.....	171
14. MJEDISI.....	179
15. FINANCAT PUBLIKE	187

PARATHËNIE DHE FALENDERIME

VJETARI RAJONAL 2024

Vjetari Statistikor Rajonal 2024 siguron informacion mbi popullsinë, ekonominë, bujqësinë, mjedisin, ndërmjet qarqeve dhe bashkive, duke dhënë një perceptim më të gjerë të statistikave që janë grumbulluar nga subjektet nëpërmjet vrojtimeve statistikore apo burimeve administrative.

Karakteristikat e veçanta të çdo qarku apo bashkie paraqiten nëpërmjet statistikave. Treguesit rajonalë në këtë botim ofrojnë krahasime të treguesve statistikorë më të rëndësishëm të vendit në nivel rajoni/qarku/bashkie. Zakonisht rajonet janë të krahasueshme ndërmjet tyre nga pikëpamja statistikore, por në realitet është vështirë të krahasohet një rajon i vogël me një rajon të madh për nga popullsia. Nëpërmjet këtij botimi, jepet informacion i vlefshëm statistikor, i cili shërben për krahasimin e treguesve ekonomikë, social, mjedisor, etj, ndërmjet rajoneve.

Çdo vit, INSTAT punon për zgjerimin e fushë së statistikave që sigurohen përtej atyre në nivel vendi apo qarku, duke mbuluar me statistika një tipologji tjetër territoriale, duke adresuar rritjen e nevojave të hartuesve të politikave brenda kontekstit të zhvillimit rajonal. Këto ndryshime janë bazuar në harmonizimin dhe integrimin e tipologjive të ndryshme, të përcaktuar në Klasifikimin statistikor të njësive territoriale, i cili lejon grumbullimin, hartimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare shqiptare në nivele të ndryshme territoriale, vendi, rajon, qark dhe bashki.

Vjetari Statistikor Rajonal 2024 është një botim me 203 faqe i ndarë në 20 kapituj, 3 kapituj të përgjithshëm dhe 17 kapituj tematikë të cilët përmbajnë informacione statistikore në nivel qarku apo bashkie.

Informacioni i prezantuar nëpërmjet tabelave, grafikëve dhe hartave e bën më të lehtë për përdoruesit leximin dhe kuptimin e statistikave sipas qarqeve dhe bashkive.

Vjetari Statistikor Rajonal i ofrohet përdoruesve në format elektronik dhe format letër, në shqip dhe anglisht.

INSTAT synon që vit pas viti ky publikim të përmirësohet dhe të pasurohet me tregues të rinj, burimi i të cilave mund të jenë vetë bashkitë/qarqet nëpërmjet të dhënave që ato grumbullojnë për qëllimet e tyre.

Shtimi i numrit të të dhënave të sigurura në nivel bashkie, do të çojë në rritjen e treguesve statistikore për këtë nivel, të prodhuar me cilësi dhe për periudha të shpeshta kohore nga Instituti i Statistikave.

INSTAT në bashkëpunim me ekspertët e Zyrës Federale të Statistikave të Zvicrës dhe ekspertëve lokalë ka investuar për zhvillimin e kapaciteteve të bashkive, në forcimin e dijeve të tyre në drejtim të statistikave, duke i bërë ata jo vetëm profesionist në grumbullimin dhe përpunimin e tyre, por dhe të ndërgjegjshëm për rolin dhe rëndësinë e statistikave në nivel bashkie, qarku dhe rajoni.

Statistikat e prezantuara janë përgatitur me kujdes të veçantë nga sektorët e specializuar të INSTAT-it dhe me mbështetjen dhe këshillimin e vazhdueshëm të ekspertëve të Zyrës Federale të Statistikave (ZFS), Zvicër, nëpërmjet projektit SALSTAT “Për Statistika të Forta Lokale Shqiptare”.

Një falënderim i veçantë i dedikohet projektit SALSTAT dhe ZFS-së për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë këtij institucioni për fuqizimin e qeverisjes vendore në Shqipëri nëpërmjet zhvillimit të statistikave në nivel rajonal (qark/bashki).

Dr. Elsa Dhuli
Drejtor i Përgjithshëm, INSTAT






PROFILI STATISTIKOR I QARQEVE





Berat

Qarku Berat është qarku i dytë me prodhimin më të madh të perimeve në serra, duke mbuluar 30,6% të prodhimit kombëtar në këtë kategori.




Numri i popullsisë Cens 2023	140.956
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	66,9
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	3,1
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	83.006
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	57.409
Numri i ndërmarrjeve aktive	4.044
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	13,2
Investime publike (milion lekë)	90
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	212
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	36
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	9,0

Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëtia në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
BERAT	BERAT	5	-69	-313	58.209	2,9	11	10,1	2.220
	DIMAL	4	38	-150	57.021	4,6	11	9,8	647
	KUÇOVË	4	-146	-264	54.535	2,3	9	8,2	151
	POLIÇAN	3	-17	-266	57.669	1,2	3	6,6	196
	SKRAPAR	9	-51	-260	54.768	2,2	2	5,5	830



Dibër

Qarku Dibër ka numrin më të ulët të lejeve të ndërtimit për ndërtesa të reja.




Numri i popullsisë Cens 2023	107.178
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	60,5
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	16,5
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	74.479
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	61.840
Numri i ndërmarrjeve aktive	2.221
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	22,9
Te ardhura buxhetore (milion lekë)	46
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	176
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	11
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	8,7

Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëtia në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
DIBËR	DIBËR	15	155	-785	62.930	8,2	7	9,0	990
	BULQIZË	8	47	-368	58.433	4,6	2	9,5	556
	MAT	8	-19	-301	63.537	5,9	2	8,2	542
	KLOS	4	4	-216	62.290	4,3	0	7,2	133



Durrës

Qarku Durrës renditet i dyti pas Tiranës për përqindjen më të lartë të ndërmarrjeve të reja me pronësi të huaj ose të përbashkët, që përbëjnë 14,5% të totalit.



Numri i popullsisë Cens 2023	226.863
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	66,1
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	6,3
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	89.561
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	61.190
Numri i ndërmarrjeve aktive	13.441
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	12,8
Investime publike (milion lekë)	52
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	301
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	564
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	13,0


Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëtia në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
DURRËS	DURRËS	6	386	1.110	61.861	5,8	182	13,3	10.570
DURRËS	SHIJAK	4	27	11	64.460	1,4	49	11,6	996
DURRËS	KRUJË	6	231	-298	56.575	5,6	333	12,4	1.875



Elbasan

Qarku Elbasan përmban një numër të lartë bashkish dhe bashki të vogla rurale me një shpërndarje të gjerë të ndërmarrjeve aktive dhe bujqësisë tradicionale.

Numri i popullsisë Cens 2023	232.580
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	66,1
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	15,9
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	80.070
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	60.819
Numri i ndërmarrjeve aktive	7.728
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	20,5
Investime publike (milion lekë)	10
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	173
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	113
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	8,8




Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëtia në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
ELBASAN	ELBASAN	13	113	-237	61.189	5,4	47	9,9	4.802
	BELSH	5	-35	17	59.363	0,9	16	8,1	534
	CËRRRIK	5	-56	-71	53.487	1,2	23	8,2	573
	GRAMSH	10	-32	-277	60.675	3,7	0	5,9	403
	LIBRAZHD	7	-7	-205	60.497	4,4	11	7,4	655
	PRRENJAS	4	42	-165	60.648	3,0	7	9,3	357
	PEQIN	6	-18	-26	65.293	1,9	9	8,9	404



Fier

Qarku Fier ka përqindjen më të lartë të ndërmarrjeve aktive në sektorin e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit me 27,3% të totalit të ndërmarrjeve të reja.



Numri i popullsisë Cens 2023	240.377
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	63,7
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	5,9
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	85.237
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	61.700
Numri i ndërmarrjeve aktive	9.684
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	38,9
Investime publike (milion lekë)	14
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	214
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	63
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	9,9


Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëti në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
FIER	FIER	10	-128	-202	66.707	13,3	11	10,7	4.734
	PATOS	3	-61	-179	65.172	1,4	3	9,5	522
	ROSKOVEC	4	33	-47	53.658	3,9	2	9,8	463
	LUSHNJE	11	-124	-96	52.381	11,7	32	9,5	2.803
	DIVJAKË	5	9	-197	53.505	7,5	12	9,5	720
	MALLAKASTËR	9	-74	-423	54.669	1,0	3	8,0	442



Gjirokastrër

Qarku Gjirokastrër është i dyti pas Tiranës për përqindjen e lartë të grave administrative në ndërmarrje të reja aktive, me 31% të totalit.

Numri i popullsisë Cens 2023	60.013
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	61,5
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	5,3
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	82.021
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	65.055
Numri i ndërmarrjeve aktive	2.543
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	10,7
Investime publike (milion lekë)	4
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	263
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	18
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	9,8




Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëtia në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
GJIROKASTËR	GJIROKASTËR	7	-74	-161	70.638	2,9	6	11,7	1.310
	LIBOHOVË	3	-17	-41	70.165	0,9	0	6,2	48
	DROPULL	3	-79	22	56.908	0,6	3	5,6	193
	TEPELENË	4	-20	-148	64.906	2,6	0	7,4	326
	MEMALIAJ	6	-52	-261	56.057	1,7	5	5,3	145
	PËRMET	5	-62	-59	53.495	1,0	1	6,9	399
	KËLCYRË	4	-34	-128	48.814	1,0	3	6,3	122

Korçë

Qarku Korçë renditet i dyti për shpenzimet mesatare mujore më të larta pas Tiranës.

Numri i popullsisë Cens 2023	173.091
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	65,5
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	9,1
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	91.034
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	57.664
Numri i ndërmarrjeve aktive	6.240
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	31,0
Investime publike (milion lekë)	65
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	165
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	148
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	8,8




Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëtia në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
KORÇË	KORÇË	8	-394	-148	59.807	6,9	122	9,9	3.310
	MALIQ	7	-101	-372	55.845	7,0	4	8,4	531
	PUSTEC	1	-33	12	54.891	1,8	2	4,6	28
	DEVOLL	5	-87	-169	53.800	2,5	7	8,2	493
	KOLONJË	8	-60	-176	60.849	6,8	4	6,1	256
	POGRADEC	8	-85	-323	53.889	6,0	9	8,6	1.622



Kukës

Qarku Kukës ka shkallën më të lartë të pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë mbi 15 vjeç, me një përqindje prej 73,8%.

Numri i popullsisë Cens 2023	61.998
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	73,8
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	8,1
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	73.225
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	61.406
Numri i ndërmarrjeve aktive	1.408
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	20,9
Investime publike (milion lekë)	3
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	224
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	11
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	8,6




Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëti në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
KUKËS	KUKËS	15	221	-362	62.826	7,3	4	8,8	871
	HAS	4	-9	-58	56.745	7,3	3	9,4	204
	TROPOJË	8	-33	-194	60.191	6,3	4	7,2	333



Lezhë

Qarku Lezhë ka numrin e dytë më të lartë të autoveturave për 1.000 banorë në vend, pas Tiranës, me një vlerë prej 287 mjete.



Numri i popullsisë Cens 2023	99.384
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	58,3
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	19,6
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	84.083
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	56.802
Numri i ndërmarrjeve aktive	4.432
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	19,7
Investime publike (milion lekë)	8
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	287
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	88
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	9,8


Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëtia në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
LEZHË	LEZHË	10	111	299	57.597	8,3	63	10,3	2.852
	KURBIN	4	44	-242	53.947	7,5	22	9,7	1.144
	MIRDITË	7	-41	-406	58.490	3,9	3	8,0	436



Shkodër

Qarku Shkodër renditet i treti pas Vlorës dhe Tiranës për përqindjen e ndërmarrjeve aktive në sektorin e akomodimit, me një nivel prej 9,9%.

Numri i popullsisë Cens 2023	154.479
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	60,8
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	6,3
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	84.546
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	57.043
Numri i ndërmarrjeve aktive	6.483
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	28,3
Investime publike (milion lekë)	47
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	241
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	48
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	8,5




Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëtia në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
SHKODËR	SHKODËR	11	-152	19	57.170	16,5	21	9,8	5.148
	VAU-DEJËS	6	-16	-144	55.757	3,1	19	7,4	502
	MALËSI E MADHE	6	-54	-8	58.756	3,6	7	6,6	526
	PUKË	5	-20	-146	59.589	2,5	1	4,9	224
	FUSHË-ARRËS	5	-6	-146	49.464	2,5	0	4,3	83



Tiranë

Qarku Tiranë ka pagën mesatare mujore më të lartë në vend, me një vlerë prej 79.212 lekë, duke reflektuar përqendrimin më të madh ekonomik dhe institucional.



Numri i popullsisë Cens 2023	758.513
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	59,5
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	10,7
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	108.098
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	79.212
Numri i ndërmarrjeve aktive	61.602
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	22,4
Investime publike (milion lekë)	44
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	241
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	411
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	13,8


Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëti në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
TIRANË	TIRANË	14	2.880	6.415	81.716	11,5	222	13,9	54.624
	KAMËZ	2	640	940	56.282	3,0	81	17,3	3.544
	VORË	3	108	-43	67.093	1,0	26	12,1	1.181
	KAVAJË	5	-24	63	54.750	4,3	47	9,1	1.719
	RROGOZHINË	5	-56	-10	59.130	2,7	35	7,0	534



Vlorë

Qarku Vlorë mban nivelin më të lartë të prodhimit të agrumeve në vend, duke kontribuar me 63,2% të totalit të prodhimit kombëtar në këtë kategori.

Numri i popullsisë Cens 2023	146.681
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsia 15+	57,3
Shkalla e papunësisë, popullsia 15+	6,3
Shpenzimet mesatare mujore për familje (lekë)	83.611
Paga mesatare mujore e personave të punësuar (lekë)	58.952
Numri i ndërmarrjeve aktive	10.512
Numri i gjedheve (bagëti në 1.000 krerë)	22,3
Investime publike (milion lekë)	70
Makina për pasagjerë për 1.000 banorë	244
Lejet e ndërtimit të lëshuara për ndërtesat e reja	91
Raporti i mësuesve të nxënësve PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	9,5



Qarku	Bashkitë	Nr. i njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për të punësuar	Nr. i gjedhëve (bagëtia në mijë kokë)	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara për ndërtesa të reja	Raporti i mësuesve për nxënës PTR-në arsimin e detyrueshëm publik (shkolla 9 vjeçare)	Numri i ndërmarrjeve aktive
VLORE	VLORE	5	-182	383	60.998	6,3	11	10,2	6.410
	SELENICË	6	-62	-227	58.386	5,1	7	5,4	190
	HIMARË	3	-59	73	49.442	1,2	22	6,5	757
	SARANDË	2	22	67	55.277	2,0	47	14,1	2.632
	FINIQ	5	-80	6	54.234	2,3	3	4,8	214
	DELVINË	2	-31	-75	55.309	1,8	0	10,1	170
	KONISPOL	3	-20	-44	51.979	3,6	1	5,7	139



STRUKTURA ADMINISTRATIVE DHE NJËSITË TERRITORIALE TË SHQIPËRISË

Pozita e përgjithshme gjeografike

Shqipëria është e pozicionuar në Evropën Juglindore, në perëndim të Gadishullit të Ballkanit. Ajo ndodhet ndërmjet koordinatave gjeografike 39 gradë e 38 minuta (Konispol) dhe 42 gradë e 39 minuta gjerësi gjeografike veriore (Vermosh) dhe 19 gradë e 16 minuta (Sazan) dhe 21 gradë e 40 minuta gjatësi gjeografike lindore (Vernik).

Shqipëria ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 28.748 kilometra katrorë. Gjatësia e përgjithshme e vijës kufitare është 1094 km, nga të cilat 657 km kufi tokësor, 316 km kufi detar, 48 km kufi lumor dhe 73 km kufi liqenor. Kryeqyteti i vendit është Tirana.

Në pjesën veriore, Shqipëria kufizohet me Malin e Zi, në verilindje kufizohet me Kosovën, në lindje kufizohet me Maqedoninë e Veriut, ndërsa në jug kufizohet me Greqinë. Në pjesën perëndimore, Shqipëria ka si kufinj natyrorë detet Adriatik dhe Jon.

Ndarja administrativo-territoriale e Shqipërisë

Nga pikëpamja administrative Shqipëria ndahet në 12 qarqe dhe 61 bashki me nënndarjet e parashikuara në ligj. Bashkia përbën nivelin e parë të njësive të qeverisjes vendore. Qarku përbën nivelin e dytë të njësive të qeverisjes vendore. Në përbërje të qarkut janë bashkitë.

Në tabelën II.1 jepet lista e qarqeve sipas ndarjes administrativo-territoriale e vitit 2014, ndërsa në tabelën II.2 jepen bashkitë në përbërje të qarqeve. Referuar Ligjit Nr. 115/2014 dhe Ligjit Nr. 34/2021, vetë bashkitë ndahen në njësi më të vogla të cilësuar si njësi administrative. Në përbërje të tyre janë qytetet dhe fshatrat.



Tab II.1 - Lista e qarqeve

01	Berat
02	Dibër
03	Durrës
04	Elbasan
05	Fier
06	Gjirokastër
07	Korçë
08	Kukës
09	Lezhë
10	Shkodër
11	Tiranë
12	Vlorë

Burimi: Fletorja Zyrtare 137/2014

Tab II.2 - Lista e bashkive

BERAT	01	MALLAKASTËR	23	FUSHË ARRËS	45
KUÇOVË	02	PATOS	24	MALËSI E MADHE	46
POLIÇAN	03	ROSKOVEC	25	PUKË	47
SKRAPAR	04	DROPULL	26	SHKODËR	48
DIMAL	05	GJIROKASTËR	27	VAU I DEJËS	49
BULQIZË	06	KËLCYRË	28	KAMËZ	50
DIBËR	07	LIBOHOVË	29	KAVAJË	51
KLOS	08	MEMALIAJ	30	RROGOZHINË	52
MAT	09	PËRMET	31	TIRANË	53
DURRËS	10	TEPELENË	32	VORË	54
KRUJË	11	DEVOLL	33	DELVINË	55
SHIJAK	12	KOLONJË	34	HIMARË	56
BELSH	13	KORÇË	35	KONISPOL	57
CËRRIK	14	MALIQ	36	FINIQ	58
ELBASAN	15	POGRADEC	37	SARANDË	59
GRAMSH	16	PUSTEC	38	SELENICË	60
LIBRAZHID	17	HAS	39	VLORË	61
PEQIN	18	KUKËS	40		
PRRENJAS	19	TROPOJË	41		
DIVJAKË	20	KURBIN	42		
FIER	21	LEZHË	43		
LUSHNJE	22	MIRDITË	44		

Burimi: Fletorja Zyrtare 137/2014 dhe 55/2021



NUTS dhe rajonet statistikore në Shqipëri

Nomenklatura e Ndarjes Territoriale për Qëllime Statistikore (NUTS), në frëngjisht 'Nomenclature d'Unités Territoriales', është një nomenklaturë gjeografike, që e ndan territorin e Bashkimit Evropian (BE) në rajone sipas tre niveleve të ndryshme (përkatësisht NUTS 1, 2 dhe 3), duke lëvizur nga njësitë territoriale më të mëdha drejt atyre më të vogla.

NUTS është bazuar në Rregulloren Nr. 1059/2003 të Parlamentit Evropian për krijimin e një klasifikimi të përbashkët të njësive territoriale për statistikat, të miratuar në vitin 2003 dhe të ndryshuar në vitet e mëvonshme. Klasifikimi NUTS e ndan territorin e shteteve anëtare në njësi territoriale. Ai i përcakton çdo njësi territoriale një kod dhe një emër të veçantë.

Edhe pse klasifikimi NUTS është përcaktuar së pari për vendet anëtare të BE-së, rajonet statistikore gjithashtu janë përcaktuar nëpërmjet negociatave midis vendeve candidate dhe vendeve candidate potenciale dhe Eurostat-it (zyra statistikore e Komisionit Evropian).

Parimet kryesore për klasifikimin NUTS

Për përcaktimin e rajoneve statistikore, janë përdorur disa kritere. Parimet kryesore për përcaktimin e klasifikimit NUTS janë:

1. Rregullorja NUTS përcakton një kufi minimal dhe një kufi maksimal të popullsisë për madhësinë e rajoneve NUTS. Pavarësisht nga qëllimi kryesor për të siguruar që rajonet me madhësi të krahasueshme shfaqen të gjitha në të njëjtin nivel NUTS, secili nivel ende përmban rajone që ndryshojnë në masë të madhe në aspektin e popullsisë.
2. Klasifikimi NUTS favorizon ndarjet administrative. Aty ku është e mundur, ndarjet administrative janë përdorur për nivele të ndryshme NUTS. Në ato vende të BE-së, ku ndarjet administrative nuk përkojnë me një nivel të caktuar NUTS, rajonet janë krijuar duke bashkuar njësi të vogla administrative.

Për të përcaktuar nivelin NUTS përkatës në të cilin duhet të klasifikohet një klasë e caktuar e njësive administrative të një shteti anëtar, ose vendi kandidat, madhësia mesatare e kësaj klase të njësive administrative duhet të qëndrojë sa më pranë kufirit të popullsisë të identifikuar në rregulloren NUTS (personat që kanë vendbanimin e tyre të zakonshëm në atë zonë duhet të llogariten si popullsi e asaj zone).

Kufinj të përdorur janë:

Niveli NUTS	Numri minimal i popullsisë	Numri maksimal i popullsisë
NUTS 1	3.000.000	7.000.000
NUTS 2	800.000	3.000.000
NUTS 3	150.000	800.000

Rajonet statistikore në Shqipëri

Rajonet statistikore të nivelit 1, 2 dhe 3 në Shqipëri janë përcaktuar sipas Nomenklaturës së Ndarjes Territoriale për Qëllime Statistikore (NUTS).

Përshtatja e klasifikimit NUTS në Shqipëri, është bërë me Vendim të Këshillit të Ministrave në vitin 2010¹ dhe nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet Shqipërisë dhe Eurostat-it, të hyrë në fuqi në prill të vitit 2011². Rajonet Statistikore në Shqipëri ndjekin hierarkinë administrative në vend. Përfshihen në nivelin NUTS 2. Shqipëria (NUTS 1) ndahet në 3 rajone statistikore në nivelin NUTS 2, dhe në 12 rajone në nivelin NUTS 3. Dymbëdhjetë rajonet e nivelit NUTS 3 përkojnë me 12 qarqet e vendit. Tre rajonet e nivelit NUTS 2 janë agregim i qarqeve bazuar në kritere gjeografike.

Në tabelën II.3 tregohen rajonet statistikore në nivelet 2 dhe 3 dhe korrespondueset e tyre me klasifikimin NUTS të Bashkimit Evropian.

Tab II.3 Rajonet Statistikore në Shqipëri dhe korrespondueset me klasifikimin NUTS

RAJONI STATISTIKOR	EMËRTIMI	KORRESPONDENCA ME NUTS
AL00	Shqipëria	NUTS 1
AL01	VERI	NUTS 2
AL011	Dibër	NUTS 3
AL012	Durrës	NUTS 3
AL013	Kukës	NUTS 3
AL014	Lezhë	NUTS 3
AL015	Shkodër	NUTS 3
AL02	QENDËR	NUTS 2
AL021	Elbasan	NUTS 3
AL022	Tiranë	NUTS 3
AL03	JUG	NUTS 2
AL031	Berat	NUTS 3
AL032	Fier	NUTS 3
AL033	Gjirokastrë	NUTS 3
AL034	Korçë	NUTS 3
AL035	Vlorë	NUTS 3

1. Shih Fletoren Zyrtare 183: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1037, datë 15 dhjetor 2010 "Për zbatimin e nomenklaturës "Shqipëria në 3 (tre) rajone NUTS II", sipas nomenklaturës së njësive territoriale për statistikat (NUTS), të Bashkimit Evropian

2. Shih letrën e nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i Eurostat-it, Valter Rademaher më 28 prill 2011



Njësitë Administrative Vendore (LAU)

Qëllimi kryesor për ndarjen e një vendi në rajone NUTS është përcaktimi i një klasifikimi statistikor të përbashkët të njësive territoriale, për të bërë të mundur mbledhjen, përgatitjen dhe shpërndarjen e statistikave rajonale të harmonizuara në të gjithë Sistemin Statistikor Evropian. Për të përmbushur kërkesat për statistika në nivel vendor, Eurostat-i ka ngritur dhe mirëmban një sistem të Njësive Administrative Vendore e njohur ndryshe si LAU (Local Administrative Units), në pajtueshmëri me klasifikimin NUTS.

Në Shqipëri është përcaktuar një nivel i njësive administrative vendore (LAU), që përkon me 61 bashkitë e vendit sipas ndarjes administrativo-territoriale.

Në Vjetarin Statistikor Rajonal, përdoruesit do të gjejnë një gamë të gjerë treguesish në nivel rajonal (NUTS) dhe në nivel të njësive administrative vendore (LAU).





POPULLSIA



Lindjet

Numri i lindjeve në Shqipëri është zvogëluar gjatë vitit të kaluar. Në vitin 2023 ka pasur 1.071 lindje më pak se në vitin 2022.

Në vitin 2023, qarku me numrin më të madh të lindjeve ishte i Tiranës, me 8.893 lindje, ndërsa qarku me numrin më të vogël të lindjeve ishte i Gjirokastrës, me 393 lindje. Në të njëjtin vit, bashkia me numrin më të madh të lindjeve ishte e Tiranës, me 7.086 lindje.

Në vitin 2023, raporti gjinor në lindje, në Shqipëri, ishte 107 lindje meshkuj për çdo 100 lindje femra. Qarku me raportin gjinor më të lartë në lindje ishte i Lezhës, me 117 lindje meshkuj për çdo 100 lindje femra. Vlera më e ulët e raportit gjinor në lindje është regjistruar në Gjirokastrë, me thujse 95 lindje meshkuj për çdo 100 lindje femra. Ky është qarku ku numri i lindjeve femra ishte pak më i madh se i të lindurve meshkuj.

Tab 1.1 Lindjet sipas qarkut, gjinisë dhe raporti gjinor, 2023

Qarku	Gjithsej	Gjinia		Raporti gjinor
		M	F	
Berat	873	438	435	101
Dibër	1.064	571	493	116
Durrës	2.655	1.387	1.268	109
Elbasan	2.057	1.036	1.021	101
Fier	1.965	1.013	952	106
Gjirokastrë	393	191	202	95
Korçë	1.298	658	640	103
Kukës	700	359	341	105
Lezhë	1.082	583	499	117
Shkodër	1.478	758	720	105
Tiranë	8.893	4.581	4.312	106
Vlorë	1.159	624	535	117
*Të panjohur	0	0	0	
Shqipëria	23.617	12.199	11.418	107

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Ilogaritjet vjetore të INSTAT-it

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja mungon

Martesar

Në vitin 2023 u regjistruan 17.467 martesa në zyrat e Gjendjes Civile; 7,0 % më pak se një vit më parë.

Në vitin 2023, qarku me numrin më të madh të martesave ishte i Tiranës, me 4.835 martesa, ndërsa qarku me numrin më të vogël të martesave ishte i Gjirokastrës, me 386 martesa.

Tab 1.2 Numri i martesave sipas qarkut, 2023


Qarku	Martesar
Berat	814
Dibër	815
Durrës	1.879
Elbasan	1.856
Fier	1.971
Gjirokastrë	368
Korçë	1.097
Kukës	480
Lezhë	1.038
Shkodër	1.274
Tiranë	4.835
Vlorë	1.040
*Të panjohur	0
Shqipëria	17.467

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe llogaritjet vjetore të INSTAT-it

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e martesave për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar martesa mungon

Në vitin 2023, bashkia me numrin më të madh të martesave ishte e Tiranës, me 3.587 martesa, ndërsa bashkitë me numrin më të vogël të martesave ishin të Dropullit dhe Pustecit, me 10 martesa secila.

Harta 1: Përqindja e martesave sipas bashkisë, 2023



Vdekjet

Numri i vdekjeve në Shqipëri është ulur gjatë vitit të kaluar. Në vitin 2023 ishin 2.712 vdekje më pak se një vit më parë.

Në vitin 2023, qarku me numrin më të madh të vdekjeve ishte i Tiranës, me 5.345 vdekje, ndërsa qarku me numrin më të vogël të vdekjeve ishte i Kukësit me 521 vdekje.

Në vitin 2023, bashkia me numrin më të madh të vdekjeve ishte e Tiranës, me 4.206 vdekje, ndërsa bashkia me numrin më të vogël të vdekjeve ishte e Pustecit, me 38 vdekje.

Tab 1.3 Vdekjet sipas qarkut dhe gjinisë, 2023

Qarku	Gjithsej	Gjinia	
		M	F
Berat	1.118	585	533
Dibër	877	448	429
Durrës	2.011	1.138	873
Elbasan	2.050	1.099	951
Fier	2.310	1.223	1.087
Gjirokastrë	731	383	348
Korçë	2.058	1.106	952
Kukës	521	286	235
Lezhë	968	549	419
Shkodër	1.726	918	808
Tiranë	5.345	2.872	2.473
Vlorë	1.571	835	736
*Të panjohur	0	0	0
Shqipëria	21.286	11.442	9.844

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Ilogaritjet vjetore të INSTAT-it

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja mungon

Shtesa natyrore e popullsisë

Shtesa natyrore e popullsisë në Shqipëri vijoi trendin pozitiv gjatë vitit 2023. Ajo u rrit nga 690 lindje më shumë se vdekje në vitin 2022, në 2.331 lindje më shumë se vdekje në vitin 2023.

Qarku me shtesën natyrore më të lartë ishte i Tiranës, me 3.548 lindje më shumë sesa vdekje në vitin 2023, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët ishte ai i Korçës, me 760 vdekje më shumë sesa lindje në atë vit.

Tab 1.4 Shtesa natyrore e popullsisë sipas qarkut dhe gjinisë, 2023


Qarku	Gjithsej	Gjinia	
		M	F
Berat	-245	-147	-98
Dibër	187	123	64
Durrës	644	249	395
Elbasan	7	-63	70
Fier	-345	-210	-135
Gjirokastrë	-338	-192	-146
Korçë	-760	-448	-312
Kukës	179	73	106
Lezhë	114	34	80
Shkodër	-248	-160	-88
Tiranë	3.548	1.709	1.839
Vlorë	-412	-211	-201
*Të panjohur	0	0	0
Shqipëria	2.331	757	1.574

Burimi: Llogaritjet vjetore të INSTAT-it

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e eventeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar event i mungon

Në vitin 2023, bashkia me shtesën natyrore më të lartë të popullsisë ishte e Tiranës, me 2.880 lindje më shumë sesa vdekje, ndërsa bashkia me shtesën natyrore më të ulët ishte ajo e Korçës, me 394 vdekje më shumë sesa lindje.

Harta 2: Shtesa natyrore e popullsisë sipas bashkisë, 2023



Lëvizjet e brendshme të popullsisë

Migrimi brenda Shqipërisë ka një ndikim të rëndësishëm në popullsinë e qarqeve.

Në vitin 2023, në nivel qarku, vetëm Tirana, Durrësi dhe Vlora kishin një migrim të brendshëm neto pozitiv (më shumë të ardhur se sa të larguar), respektivisht me 7.365 Tirana, 823 Durrësi dhe 183 Vlora.

Të gjitha qarqet e tjera kanë pasur migracion të brendshëm neto negativ (më shumë të larguar se sa të ardhur) gjatë vitit 2023, në veçanti qarqet e Dibrës dhe Beratit, me -1.670 dhe -1.253 respektivisht.

Tab 1.5 Migracioni i brendshëm sipas qarkut, 2023

Qarku	Të ardhur	Të larguar	Migracioni i brendshëm neto
Berat	951	2.204	-1.253
Dibër	863	2.533	-1.670
Durrës	3.539	2.716	823
Elbasan	1.853	2.817	-964
Fier	2.698	3.842	-1.144
Gjirokastrë	692	1468	-776
Korçë	1.315	2.491	-1.176
Kukës	578	1.192	-614
Lezhë	1.670	2.019	-349
Shkodër	1583	2008	-425
Tiranë	13.557	6.192	7.365
Vlorë	2.783	2.600	183
Shqipëria	32.082	32.082	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe llogaritjet vjetore të INSTAT-it

Në vitin 2023, bashkia me migracionin e brendshëm neto më të lartë ishte Tirana, me 6.415 të ardhur më shumë se sa të larguar, ndërsa bashkia me migracionin e brendshëm neto më të ulët ishte Dibra, me 785 të larguar më shumë se të ardhur.

Ndryshimi i popullsisë


Popullsia e Shqipërisë nisi të zvogëlohet që prej vitit 1990, i cili shënoi një fazë të re në zhvillimin politik, ekonomik dhe demografik të Shqipërisë. Para vitit 1990, vendi përjetoi një rritje të qëndrueshme të popullsisë. Gjatë periudhës pasuese, normat e ulëta të lindshmërisë dhe emigracioni ishin faktorët kryesorë që kontribuan në zvogëlimin e popullsisë.

Popullsia banuese në Shqipëri, sipas numërimit në momentin e censit - mesnatën e së Dielës dhe mëngjesin e së Hënës 17-18 shtator 2023 rezulton 2.402.113, prej të cilëve, 49,6 përqind janë meshkuj dhe 50,4 përqind femra. Referuar Censit të Popullsisë dhe Banesave 2011, popullsia banuese në Shqipëri ishte 2.821.977, me një rënie prej 420 mijë banorë. Kjo rënie përshtatet me trendin e vërejtur gjatë tre dekadave të fundit, që prej Censit të vitit 1989.

Referuar të dhënave të Gjendjes Civile, gjatë vitit 2023, vetëm popullsia e 10 bashkive është rritur, duke marrë parasysh vetëm shtesën natyrore të popullsisë dhe migracionin e brendshëm neto, ndërsa të gjitha bashkitë e tjera patën një rënie të popullsisë, pa migracionin ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2023, bashkia e Tiranës ka pasur rritjen më të lartë të popullsisë, pa migracionin ndërkombëtar, duke u rritur me 9.295 banorë, e ndjekur nga bashkia e Kamzës, e cila u rrit me 1.580 banorë. Nga ana tjetër, bashkia Dibër kishte rënien më të lartë të popullsisë, pa migracionin ndërkombëtar, pasi ajo u ul me 630 banorë, e ndjekur nga bashkia Korçë, e cila u ul me 542 banorë.

Harta 3: Rritja e popullsisë pa migrim ndërkombëtar sipas bashkisë, 2023



Struktura e popullsisë dhe raportet e varësisë


Referuar rezultateve të Censit të Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri 2023 rezultuan 373.929 të rinj të moshës nën 15 vjeç dhe 473.104 të moshuar të moshës 65 vjeç ose më shumë. Popullsia në moshë pune (njerëz të moshës 15 deri 64 vjeç) rezultoi 1.555.080 persona, gjatë të njëjtit vit. (shiko tabelën 1.6 në aneks).

Siç mund të shihet, nga shpërndarja e popullsisë sipas tre grup-moshave kryesore, në tre qarqe ka më shumë të rinj krahasuar me të moshuar: Kukës, Tiranë, Dibër. Në nëntë qarqet e tjerë, numri i të rinjve është më i vogël se numri i të moshuarve: Fier, Vlorë, Korçë, Berat, Elbasan, Gjirokastrë, Shkodër, Lezhë, Durrës.

Qarqet me raportin më të lartë të varësisë së të rinjve janë ato të Kukësit dhe Dibrës, respektivisht me 31,8 dhe 26,5 persona më të rinj se 15 vjet për 100 persona nga 15 deri në 64 vjeç. Ndërsa qarqet me raportin më të ulët të varësisë së të rinjve janë të Gjirokastrës dhe Beratit, me 19,0 dhe 20,3 persona më të rinj se 15 vjet për 100 persona nga 15 deri 64 vjeç.

Nga ana tjetër, qarqet me raportin më të lartë të varësisë së të moshuarve janë ato të Gjirokastrës dhe Vlorës, respektivisht me 46,1 dhe 43,2 persona më të vjetër se 65 vjeç për 100 persona nga 15 deri 64 vjeç. Qarqet me raportin më të ulët të varësisë së të moshuarve janë ato të Kukësit dhe Tiranës, respektivisht me 19,9 dhe 24,2 persona më të vjetër se 65 vjeç për 100 persona nga 15 në 64 vjeç.

Fig 1.1 Raportet e varësisë sipas qarqeve, Cens 2023



Burimi: Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023

Dendësia e popullsisë

Dendësia e popullsisë së Shqipërisë, referuar Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, është 83,6 banorë për km² (shiko tabelën 1.7 në aneks).

Qarku i Tiranës rezultoi me dendësinë më të lartë të popullsisë, rreth 459,1 banorë për km². Qarku me dendësinë e dytë më të lartë të popullsisë, rezultoi ai i Durrësit, me 296,2 banorë për km². Nga ana tjetër, qarqet me dendësinë më të ulët të popullsisë rezultuan ato të Gjirokastrës dhe Kukësit, përkatësisht me 20,8 dhe 26,1 banorë për km²

Anekset

Tab 1.6 Popullsia sipas gjinisë, grup-moshave kryesore dhe qarkut, Cens 2023

Qarku	Meshkuj				Femra				Gjithsej			
	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej
Berat	9.497	44.587	15.758	69.842	8.849	45.794	16.471	71.114	18.346	90.381	32.229	140.956
Dibër	9.759	35.600	8.692	54.051	8.931	35.020	9.176	53.127	18.690	70.620	17.868	107.178
Durrës	19.832	74.012	20.012	113.856	18.170	73.862	20.975	113.007	38.002	147.874	40.987	226.863
Elbasan	18.310	76.229	22.036	116.575	17.253	75.049	23.703	116.005	35.563	151.278	45.739	232.580
Fier	17.938	74.932	27.910	120.780	16.130	74.623	28.844	119.597	34.068	149.555	56.754	240.377
Gjirokastrë	3.536	18.384	8.313	30.233	3.372	17.966	8.442	29.780	6.908	36.350	16.755	60.013
Korçë	12.126	55.614	19.555	87.295	11.537	52.920	21.339	85.796	23.663	108.534	40.894	173.091
Kukës	6.909	20.415	3.797	31.121	6.081	20.444	4.352	30.877	12.990	40.859	8.149	61.998
Lezhë	8.559	31.726	9.380	49.665	7.743	31.787	10.189	49.719	16.302	63.513	19.569	99.384
Shkodër	12.217	48.275	15.900	76.392	11.352	50.196	16.539	78.087	23.569	98.471	32.439	154.479
Tiranë	65.684	243.133	58.611	367.428	61.015	265.463	64.607	391.085	126.699	508.596	123.218	758.513
Vlorë	9.878	44.488	18.844	73.210	9.251	44.561	19.659	73.471	19.129	89.049	38.503	146.681
Gjithsej	194.245	767.395	228.808	1.190.448	179.684	787.685	244.296	1.211.665	373.929	1.555.080	473.104	2.402.113

Burimi: Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023

Tab 1.7 Dendësia e popullsisë sipas qarkut, Cens 2023

Qarku	Sipërfaqe	Banorë / km ²
	km ²	Cens 2023
Berat	1.798	78,4
Dibër	2.586	41,4
Durrës	766	296,2
Elbasan	3.199	72,7
Fier	1.890	127,2
Gjirokastrë	2.884	20,8
Korçë	3.711	46,6
Kukës	2.374	26,1
Lezhë	1.620	61,3
Shkodër	3.562	43,4
Tiranë	1.652	459,1
Vlorë	2.706	54,2
Shqipëria	28.748	83,6

Burimi: Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023

Metodologjia

Burimet e të dhënave

INSTAT mbledh një gamë të gjerë të dhënash për ngjarjet demografike, duke përfshirë statistika të popullsisë në nivel kombëtar dhe rajonal, të cilat kanë ndikim në madhësinë e popullsisë dhe strukturën e saj.

Burime potenciale të dhënash, për Drejtorinë e Statistikave Sociale, me qëllim përmbushjen e objektivave, në llogaritjen e treguesve të veçantë, janë të dhënat administrative dhe Censet e Popullsisë dhe Banesave.

Burimet administrative

Të dhënat për lindjet, vdekjet, martesat dhe lëvizjet e brendshme sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në mënyrë elektronike. Kjo mënyrë e sigurimit të të dhënave të ngjarjeve demografike garanton një plotshmëri më të lartë, gjithashtu edhe përmbushjen e afateve të publikimeve përkatëse.

Censi i popullsisë dhe banesave

Censi i popullsisë dhe banesave i vitit 2023 është një burim shumë i rëndësishëm për statistikat e popullsisë. Është baza për llogaritjet vjetore të numrit të popullsisë.

Përkufizime

Koeficienti bruto i lëvizjeve të brendshme të popullsisë: Është raporti i migracionit neto të brendshëm për një territor të caktuar (qark) me popullsinë përkatëse, në një vit të caktuar, shprehur për 1.000 banorë.

Lindje e gjallë: Konsiderohen lindjet e fëmijëve që shfaqin ndonjë shenjë jete. Është numri i përgjithshëm i lindjeve duke përfshirë lindjet e vdekura (Lindjet totale përfshijnë lindjet e gjalla dhe lindjet e vdekura).

Migracioni i brendshëm neto: Është diferenca e flukseve hyrëse me ato dalëse të popullsisë së një territori të caktuar (qark), në një vit të dhënë.

Migracioni neto: Është diferenca midis imigracionit dhe emigracionit të popullsisë së një territori të caktuar, në një periudhë të dhënë kohe.

Popullsia banuese: Bazohet në konceptin e vendbanimit të zakonshëm. Sipas këtij përkufizimi përfshihen në popullsinë banuese të një viti të gjithë ata persona që banojnë ose kanë si qëllim të banojnë në vend për të paktën 12 muaj, pavarësisht shtetësisë së tyre.

Raporti gjinor në lindje: I referohet numrit të djemve të lindur të gjallë për 100 vajza të lindura të gjalla.

Raporti i varësisë së përgjithshme: Raporti i numrit të personave nën moshën e punës (0-14 vjeç) dhe personave të moshuar, mbi moshën e punës (65+ vjeç) me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje.

Raporti i varësisë së të moshuarve: Raporti i numrit të personave të moshuar, mbi moshën e punës (65+ vjeç), me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje.

Raporti i varësisë së të rinjve: Raporti i numrit të personave nën moshën e punës (0-14 vjeç) me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje.

Rritja e popullsisë pa migracionin ndërkombëtar: Ndryshimet në popullsi si rezultat i rritjes natyrore dhe migrimit të brendshëm neto.

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Statistikat vitale: Janë të dhëna demografike mbi lindjet, vdekjet dhe martesat.

Vdekja: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).

Vdekjet e vonshme të fetusit ose lindjet e vdekura: Nënkupton dëbimin ose nxjerrjen nga nëna e një fetusit të vdekur pas kohës në të cilën normalisht do të supozohej se është i aftë për ekzistencë të pavarur jashtë mitrës (zakonisht merret si pas javës 24 ose 28 të shtatzënisë). Foshnjat që lindin të gjallë, por që vdesin menjëherë pas lindjes, përfshihen nga kjo kategori.




NDËRTE SAT



Qëllimi i kapitullit “Ndërtesa” është të paraqesë të dhëna statistikore mbi zhvillimet më të fundit të këtij treguesi në Republikën e Shqipërisë. Aktualisht, ky kapitull përmban informacion vetëm mbi lejet e ndërtimit të miratuara sipas dy kategorive kryesore: “Ndërtesa rezidente dhe Ndërtesa jo-rezidente”.

Harta 2.1 Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja sipas bashkive, 2023



Tab 2.1 Numri dhe sipërfaqja e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja sipas qarqeve, 2020-2023

Qarku	2020		2021		2022		2023	
	Numër	Sipërfaqe m ²	Numër	Sipërfaqe m ²	Numër	Sipërfaqe m ²	Numër	Sipërfaqe m ²
Berat	44	15.307	54	10.806	30	15.765	36	7.867
Dibër	22	6.560	21	5.145	16	3.831	11	8.912
Durrës	127	150.707	290	240.665	445	435.698	564	338.678
Elbasan	109	62.049	127	45.449	94	36.675	113	42.194
Fier	101	55.109	119	36.666	100	50.684	63	40.560
Gjirokastrë	20	10.765	17	13.188	16	13.100	18	5.006
Korçë	63	23.156	112	59.801	112	55.430	148	62.875
Kukës	27	22.617	36	39.177	12	5.497	11	3.091
Lezhë	51	49.618	178	127.770	95	64.043	88	22.111
Shkodër	35	25.207	33	30.082	38	35.649	48	21.233
Tiranë	313	1.121.722	366	1.649.132	382	1.808.369	411	1.418.551
Vlorë	49	65.394	43	58.828	80	142.756	91	144.741
Shqipëria	961	1.608.211	1.396	2.316.709	1.420	2.667.497	1.602	2.115.819


Burimi: Bashkitë, llogaritje të INSTAT

Gjatë harkut kohor 2020-2023, janë miratuar gjithsej 5.379 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, mesatarisht rreth 1.345 leje të miratuara për çdo vit. Sipas qarqeve, numri më i lartë i lejeve të ndërtimit të miratuara në këtë katërvjeçar, paraqitet në Tiranë me 1.472 leje ose 27,4 % e numrit gjithsej të lejeve të miratuara në nivel vendi.

Kërkesa për leje ndërtimi për ndërtesa për banim dominon në krahasim me kërkesat për ndërtesa të tjera si: hotele dhe të ngjashme, zyra, industriale, tregtare apo të tjera. Lejet e miratuara për ndërtesa banimi në vitet 2020-2023 zënë 76,7 % të numrit gjithsej të lejeve, ndërsa lejet e ndërtimit të miratuara për ndërtesa të tjera zënë 23,3 % të këtij treguesi.

Gjatë viteve 2020-2023, rreth 68,9 % e sipërfaqes së lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja është përqendruar në qarkun e Tiranës, ndërsa qarku Dibër paraqitet me vlerën më të ulët të këtij treguesi me rreth 0,3 %. Sipërfaqja mesatare e një lejeje ndërtimi referuar të njëjtës periudhë kohore është rreth 1.619 metra katrorë.


Fig 2.1 Shpërndarja e numrit të lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa banimi sipas qarqeve, 2020-2023



Burimi: Bashkitë, llogaritje të INSTAT

Në katërvjeçarin e fundit, janë miratuar gjithsej 4.127 leje ndërtimi për ndërtesa banimi. Në vitin 2023, ky tregues u paraqit me një rritje prej 16,0 % krahasuar me vitin 2022, ndikuar kryesisht nga rritja e numrit të lejeve të miratuara për banesa në qarkun Durrës në të cilin u miratuan përkatësisht 114 leje më shumë se viti paraardhës.


Fig 2.2 Struktura e numrit të lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa jo-rezidente sipas qarqeve, 2023



Burimi: Bashkitë, llogaritje të INSTAT

Në vitin 2023, lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa jo-rezidente u miratuan kryesisht për "Ndërtesa industriale". Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për "Ndërtesa për zyra" në vitin 2023 shënoi rritje prej 71,4 % krahasuar me vitin 2022. Qarku i Korçës shënoi numrin më të lartë në lejet e miratuara për "Hotele dhe të ngjashme" me rreth 35,6 % të lejeve gjithsej në nivel vendi. Gjatë vitit 2023 qarku Gjirokastrë shënoi uljen vjetore më të lartë në numrin e lejeve të miratua për "Ndërtesa tregtare" me përkatësisht 85,7 % krahasuar me vitin 2022. Qarku Fier paraqitet me numrin më të lartë të lejeve për "Ndërtesa të tjera" me 14 leje të miratuara gjithsej ose rreth 24,6 % e lejeve të miratuara të këtij treguesi në Shqipëri gjatë vitit 2023.

Fig 2.3 Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për "Hotele dhe të ngjashme" sipas bashkive bregdetare dhe jo-bregdetare, 2020-2023



Burimi: Bashkitë, llogaritje të INSTAT

Lejet e ndërtimit për “Hotele dhe të ngjashme” në vitet 2020-2023 u përqendruan kryesisht në bashkitë Jo – Bregdetare, ku lejet e miratuara për “Hotele dhe të ngjashme” gjatë këtij katërvjeçari u përqendruan në bashkinë Korçë me 33,3 % dhe bashkinë Tiranë me 12,9 %. Ndërsa sa i përket bashkive bregdetare lejet e miratuara për “Hotele dhe të ngjashme” u përqendruan në bashkitë Durrës dhe Himarë me përkatësisht 36,5 % dhe 39,7%.

Burimi i të dhënave

Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara, janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet me frekuencë tremujore nga zyrat rajonale të INSTAT, në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse.

Përkufizime

Leja e ndërtimit: Autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat: Struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo-rezidente), ku përfshihen: hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Ndërtesat rezidente: Ndërtime ku të paktën gjysma e sipërfaqes së objektit do të shfrytëzohet për qëllime banimi. Në rast se më pak se gjysma e sipërfaqes së objektit do të shfrytëzohet për qëllime banimi, ndërtesa duhet të klasifikohet në kategorinë e ndërtesave jo-rezidenciale, duke u bazuar në qëllimin e projektit të hartuar.

Ndërtesat jo-rezidente: Ndërtime ku të paktën gjysma e sipërfaqes së objektit do të shfrytëzohet për qëllime të ndryshme nga ato të banimit. Në rast se të paktën gjysma e sipërfaqes së objektit do të shfrytëzohet për qëllime banimi, ndërtesa klasifikohet si ndërtesë rezidenciale.

Sipërfaqja: Hapësira gjithsej ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.




TREGU I PUNËS
DHE PAGAT

3

Forcat e Punës

Në vitin 2023¹, shkalla e Forcës së Punës në Shqipëri është 62,4%, e cila përfaqëson popullsinë aktive të përbërë nga të punësuarit dhe të papunët në vend. Për të matur shkallën e aktivizimit të popullsisë, është përllogaritur treguesi 'shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës', që hedh dritë mbi potencialin e ekonomisë së një vendi për të angazhuar popullsinë në veprimtari produktive. Ky tregues varion sipas qarqeve, duke reflektuar karakteristikat e tregut të punës në secilën prej tyre. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës është regjistruar në qarkun e Kukësit (73,8 %), Berat (66,9 %), Durrës dhe Elbasan (me 66,1 % përkatësisht), ndërsa më e ulëta në qarkun e Vlorës dhe të Lezhës (57,3 % dhe 58,3 % përkatësisht). (Figura 3.1).

Fig 3.1 Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas qarkut, 2023




Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

Punësimi

Raporti i të punësuarve të moshës 15 vjeç e lart ndaj popullsisë të së njëjtës moshë është 56,5 % në vitin 2023. Shkalla më e lartë e punësimit është regjistruar në qarkun e Kukësit (67,9 %), ndjekur nga qarku i Beratit (64,8 %) (Figura 3.2). Shkalla më e ulët regjistrohet në qarkun e Lezhës (46,9 %) dhe të Dibrës (50,5 %).

Fig 3.2 Shkalla e punësimit sipas qarkut, 2023




Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

1. Rezultatet e Anketës së Forcave të Punës të paraqitura në këtë botim janë kalibruar duke përdorur popullsinë rezidente sipas rezultateve të Cens të Popullsisë dhe Banesave 2023

Nga këndvështrimi gjinor, diferenca më e madhe e shkallës së punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart, është shënuar në qarkun e Vlorës, ku hendeuku është 16,0 pp, ndërsa mesatarja në Shqipëri është 10,5 pp. Gjatë vitit 2023, në të gjitha qarqet e vendit shkalla e punësimit është më e lartë për meshkujt se sa për femrat. (Figura 3.3).


Fig 3.3 Shkalla e punësimit sipas qarkut dhe gjinisë, 2023



Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

Analiza e punësimit sipas veprimtarive ekonomike (Figura 3.4), tregon se shërbimet dhe bujqësia kanë pjesën më të madhe të të punësuarve, 43,2 % dhe 37,2 % përkatësisht, ndërsa të punësuarit në industri përbëjnë vetëm 19,6 %. Tirana është qarku me përqindjen më të lartë të punësimit në shërbime (64,8%) dhe me përqindjen më të ulët të punonjësve në bujqësi (10,4%). Qarku me përqindjen më të lartë të punësimit në industri është Durrësi (30,1%), ndërsa qarku i Kukësit ka përqindjen më të ulët të punonjësve në këtë sektor (7,2%). Berati është qarku me përqindjen më të lartë të punësimit në bujqësi (67,8%), gjithashtu paraqet nivelin më të ulët të punonjësve në shërbime (19,2%).

Fig 3.4 Shkalla e punësimit sipas qarkut dhe veprimtarisë ekonomike, 2023




Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

Papunësia

Në vitin 2023, shkalla e papunësi në Shqipëri është e barabartë me 9,5 %. Shkalla më e ulët e papunësisë është regjistruar në qarkun e Beratit (3,1 %) dhe Gjirokastrës (5,3 %), ndërsa ajo më e larta është regjistruar në Lezhë (19,6 %), Dibër (16,5 %) dhe Elbasan (15,9 %). Qarku i Tiranës, Korçës dhe Kukësit paraqesin nivele të shkallës së papunësisë të ngjashme me mesataren e vendit, ndërsa qarqet e tjera e kanë këtë tregues nën nivelin mesatar.


Fig 3.5 Shkalla e papunësisë sipas qarkut, 2023



Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

Analiza gjinore tregon se qarku me nivelin më të lartë të papunësisë për femrat është ai i Lezhës me 18,8 %, ndjekur nga qarku i Elbasanit me 16,9 %. Shkalla më e lartë e papunësisë për meshkujt është regjistruar në qarkun e Dibrës (23,6 %), dhe të Lezhës (20,2 %). Shkalla e papunësisë për femrat regjistron vlerën e saj më të ulët në qarkun e Beratit (1,7 %) dhe Gjirokastrës (4,5 %). Shkalla më e ulët e papunësisë për meshkujt regjistrohet në Berat dhe Fier (me 4,2 % dhe 5,8% respektivisht).

Fig 3.6 Shkalla e papunësisë sipas qarkut dhe gjinisë, 2023



Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës


Vlerësime të statistikave të punësimit sipas bashkive

Të dhënat e anketës së forcave të punës nuk mundësojnë tregues sipas 61 bashkive të përcaktuara nga ndarja administrative. Për viti 2023, janë kryer disa vlerësime lidhur me dy bashkitë më të mëdha në vend, Tiranës dhe Durrësit, për sa u përket treguesve kryesorë: shkallës së punësimit, shkallës së papunësisë dhe shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës.

Në bashkinë e Tiranës, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 58,7 %. Hendeku gjinor i pjesëmarrjes në forcat e punës është 12,7 pp (Figura 3.7).

Në Bashkinë e Tiranës, gjatë vitit 2023 shkalla e punësimit është 52,9% dhe shkalla e papunësisë është 10,0%.


Fig 3.7 Treguesit kryesorë të tregut të punës për Bashkinë Tiranë, 2021-2023



Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

Në Bashkinë e Durrësit, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe shkallën e punësimit, janë 62,6% dhe 57,5%. (Figura 3.8). Hendeku gjinor në shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për Bashkinë e Durrësit është 11,0%.

Fig 3.8 Treguesit kryesorë të tregut të punës për Bashkinë Durrës, 2021-2023




Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

Analiza sipas veprimtarive ekonomike në të dy bashkitë, Tiranë dhe Durrësi ku mbizotëron sektori i shërbimeve, tregon për një dinamikë të ndryshme të peshës që zë ky sektor gjatë viti 2023 (Figura 3.9).

Në Bashkinë e Tiranës, pesha e të punësuarve në sektorin e bujqësisë është 5,7 %. Personat e angazhuar në sektorët e shërbimeve dhe industrisë janë (70,7% dhe 23,6% përkatësisht).

Në Bashkinë e Durrësit, shërbimet regjistrojnë përqindjen më të lartë të të punësuarve me 49,7 %, ndërsa pesha e të punësuarve në sektorin e bujqësisë dhe të industrisë është 16,8 % dhe 33,6% për vitin 2023 (Figura 3.9).

Fig 3.9 Punësimi sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë për Bashkinë Tiranë dhe Durrës, 2021-2023



Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës


Pagat

Gjetjet kryesore

Paga mesatare mujore në Shqipëri në vitin 2023 ishte 70.539 lekë. Qarku i Tiranës ka pagën mesatare mujore më të lartë, (79.212 lekë), ndërsa qarqet Lezhë dhe Shkodër kishin pagën më të ulët (afërsisht 56.802 lekë dhe 57.043 lekë).

Krahasuar me mesataren mujore në nivel kombëtar, qarku i Tiranës ka pagën mesatare mujore më të lartë me 12,3 %, ndërsa qarku i Lezhës ka pagën më të ulët 19,5%, (Figura 3.10).


Fig 3.10 Paga mesatare mujore bruto sipas qarkut, 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, llogaritje nga INSTAT


Harta 3.1 tregon se cilat bashki kishin nivelet më të larta dhe më të ulëta të pagave nëpër rajone.

Harta 3.1 Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë sipas bashkive, 2023



Referuar të dhënave sipas gjinisë, gjatë vitit 2023, meshkujt kanë nivelin e pagave më të lartë në qarkun e Tiranës (82.012 lekë) dhe më të ulët në qarkun e Lezhës (56.717 lekë). Pagat e punonjësve femra ishin përgjithësisht më të ulëta se ato të punonjësve meshkuj, por gjithashtu gratë kishin nivelin më të lartë të pagave në qarkun e Tiranës (76.194 lekë) dhe më të ulët në qarkun e Shkodrës (56.713 lekë). Në qarkun e Gjirokastrës, meshkujt paguhen më shumë se femrat me rreth 12,26 %, ndërsa në qarkun e Beratit meshkujt paguhen më pak se femrat me -1,9 % (Figura 3.11).


Fig 3.11 Paga mesatare mujore bruto sipas gjinisë dhe qarkut, 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, llogaritje të INSTAT

Krahasuar me vitin 2022, paga mesatare mujore bruto në nivel kombëtar, gjatë vitit 2023 u rrit me 14 %. Qarku Shkodër kishte rritjen më të madhe të nivelit pagave me 15,9 %, ndërsa qarku Dibër kishte rritjen më të vogël me 11,2 % (Figura 3.12).


Fig 3.12 Ndryshimi vjetor në përqindje i pagës mesatare mujore bruto sipas qarkut, 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, llogaritje të INSTAT

Studimet mbi pagën mesatare mujore bruto tregojnë se grup-aktiviteti Informacioni dhe komunikacioni; Veprimtari financiare dhe të sigurimit; Veprimtari të pasurive të paluajtshme, shkencore, profesionale dhe teknike, Shërbimeve administrative dhe mbështetëse ka paga më të larta se sektorët e tjerë. Ndërsa pagat më të ulëta janë në sektorin e Bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit. (Figura 3.13).

Fig 3.13 Niveli i pagave sipas qarkut dhe grup-veprimtarisë ekonomike, 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,
Ilogaritje të INSTAT

Burimi i të dhënave

Statistikat mbi punësimin dhe papunësinë bazohen në Anketën e Forcave të Punës realizuar nga INSTAT në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2012. Rezultatet e vrojtimit publikohen në baza tremujore dhe vjetore, dhe nga viti 2016, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në atë rajonal.

Statistikat e tregut të punës mbi pagat, janë të bazuara në informacionin e të dhënave administrative nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore. Të dhënat për pagat publikohen nga INSTAT me periodicitet tremujor dhe vjetor.

Përkufizime

Paga mesatare mujore bruto: Paga bruto që merr një i punësuar për punën që ka kryer.

Ajo përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

- Paga bazë për punën e kryer
- Shtesa mbi pagë për funksione drejtuese
- Shtesa mbi pagë për vjetërsi në punë
- Shtesa mbi pagë për vështirësi në punë
- Shtesa të tjera të rregullta (tituj, grada etj.)

Në pagën mesatare mujore bruto nuk zbriten kontributet personale dhe tatimi mbi të ardhurat.

Të punësuar: Të gjithë personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës. Të punësuar janë konsideruar edhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkohshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trajnim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet që (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal ose (b) personi merr 50 përqind ose më shumë të pagës; (3) të vetëpunësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin / fermën / praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetë-konsum, janë konsideruar të punësuar.

Të punësuar me pagë: Të gjithë të punësuarit që kryejnë një apo më shumë punë me pagesë, për të cilët Institucioni/ ndërmarrja punëdhënëse është përgjegjëse për pagesën e taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe/ ose ku marrëdhënia kontraktuale është subjekt i legjislacionit kombëtar të punës.

Të papunë: Të gjithë personat që gjatë javës së referencës ishin: 1. pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi; 2. aktualisht të disponueshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës); 3. duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyre) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Si hapa specifike për të kërkuar punë konsiderohen: Kontakt me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë; kontakt me një agjensi private punësimi për të gjetur punë; aplikim direkt pranë ndonjë punëdhënësi; kërkuar miqve/shokëve, të afërmeve, sindikatave etj; vendosur ose përgjigjur lajmërimeve në gazeta; studiuar lajmërimet në gazeta; marrë pjesë në një test apo intervistë; kërkuar për tokë, godinë ose pajisje; aplikuar për leje, liçenca ose burime financiare.

Popullsia në moshë pune: Popullsia 15-64 vjeç.

Forca e Punës: Të gjithë personat e punësuar dhe të papunë.

Popullsia jo-ekonomikisht aktive: Të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtëpiakë, në shërbim të detyrueshëm ushtarak, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

Shkalla e punësimit: Raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

Shkalla e papunësisë: Raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës: Raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.





KONSUMI I NJËSIVE EKONOMIKE FAMILJARE

4


Hyrje

Statistikat e konsumit sigurojnë përshkrime të nivelit dhe strukturës së shpenzimeve për konsum të Njësive Ekonomike Familjare (NjEF) në Shqipëri si dhe të treguesve të tjerë bazuar në shpenzimet e konsumit. Të dhënat e konsumit llogariten bazuar në Anketën e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare, e cila është një vrojtim statistikor që kryhet pranë NjEF-ve me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jep një panoramë të qartë të situatës socio-ekonomike të tyre. Struktura e konsumit të NjEF-ve shqiptare është paraqitur sipas ndarjes në 12 grupet bazë të konsumit (klasifikimi COICOP - ABF 2012), shpenzime për ushqim, shpenzime jo-ushqimore (veshje, artikuj për shtëpi etj.), shpenzime për shërbime bazë (elektricitet, ujë, gaz, telefon etj.), shpenzime për arsim, komunikim, shëndet dhe pajisje afatgjatë.

Shpërndarja e shpenzimeve mesatare për konsum të NjEF sipas qarqeve, viti 2021 – 2023.

Shpenzimet mesatare për konsum sipas qarqeve kanë ndryshuar gjatë periudhës 2021-2023 duke shprehur në përgjithësi tendenca të ndryshme për nga madhësia e shpenzimeve. Rritja më e lartë e shpenzimeve për konsum nga viti 2021 është regjistruar në qarkun Durrës dhe Vlorë, përkatësisht 14,9 dhe 10,8 përqind. Ndërsa rritja më e ulët të shpenzimeve të konsumit është regjistruar në qarkun Kukës, me 2,2%.

Fig 4.1 Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve, viti 2021-2023 (në Lek)




Burimi: "INSTAT, Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare".

Shpërndarja e strukturës së shpenzimeve për konsum për grupet "Ushqime, pije joalkoolike, pije alkoolike dhe duhan" të NjEF-ve sipas qarqeve, 2021-2023.

Shpenzimet mesatare mujore për konsum të grupeve "Ushqime, pije joalkoolike, pije alkoolike dhe duhan" kanë ndryshuar gjatë periudhës 2021 - 2023, duke shprehur në përgjithësi sjellje të ndryshme konsumatore. Peshat më të larta të shpenzimeve për këto grupe në vitin 2023, janë regjistruar në qarqet: Dibër 53,8%, Elbasan 49,5% dhe Shkodër 47,9%.

Harta 4.1 Pesha e shpenzimeve mesatare mujore për konsum të grupeve “Ushqime, pije joalkoolike, pije alkoolike dhe duhan” sipas qarqeve, viti 2023.




Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve dhe nivelit të arsimit të kryefamiljarit, 2023.

Për sa i përket shpenzimeve në nivel qarku të disagreguara sipas nivelit të arsimit të kryefamiljarit, vihet re që shpenzimet më të larta janë regjistruar në kategorinë e kryefamiljarëve me arsim të lartë apo pasuniversitar. Vlerat më të larta të shpenzimeve për vitin 2023 në kategoritë e arsimit të lartë/pasuniversitar janë regjistruar në qarqet

Tiranë dhe Lezhë, ndërsa për kategorinë e të arsimuarve në shkolla të mesme të përgjithshme ose profesionale janë regjistruar në qarqet Tiranë dhe Korçë, (Shih Tabelën 4.2/Aneks). Shpërndarja e njësive ekonomike familjare sipas nivelit të arsimit të kryefamiljarit dhe shpenzimeve mesatare mujore paraqet tendenca të ndryshme përqendrimi në qarqe.

Harta 4.2 Shpërndarja e familjeve sipas arsimit të kryefamiljarit dhe konsumit mesatar mujor sipas qarqeve, viti 2023 (në %).



Burimi i të dhënave:

Statistikat e Konsumit bazohen në të dhëna të mbledhura nga anketa me bazë vjetore. Anketa e Buxhetit të Familjes është një vërtetim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF). Statistikat e Konsumit sigurojnë përshkrime të nivelit dhe strukturës së shpenzimeve për konsum të Njësive Ekonomike Familjare (NjEF) me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri si dhe të treguesve të tjerë me bazë shpenzimet e konsumit.

Përkufizime

Shpenzimet për konsum të NjEF-ve: përfshijnë çdo lloj blerjeje produktesh dhe shërbimesh për të plotësuar nevojat individuale të NjEF-ve dhe individëve, me përjashtim të blerjeve për pajisje afatgjata, investimeve kapitale, parave për të tretët dhe qirasë së imputuar.

Kryefamiljari: është një person, që përcaktohet si i tillë për qëllimet e anketës (person që është pronar i banesës ose person i identifikuar si i tillë nga anëtarët e tjerë të NjEF-së). Nëse anëtarët e NjEF-së nuk e përcaktojnë vetë këtë person, normalisht do të jetë personi që kontribuon më shumë në të ardhurat totale të NjEF-së.

Një njësi ekonomike familjare (NjEF): i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo, të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

Periudha e referencës: është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar.

Aneks:

Tab 4.1 Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve, viti 2021-2023 (në Lek).

Qarku	Viti		
	2021	2022	2023
Berat	77.402	82.850	83.006
Dibër	72.048	72.724	74.479
Durrës	77.925	83.473	89.561
Elbasan	74.609	75.899	80.070
Fier	80.752	83.371	85.237
Gjirokastrë	76.877	81.522	82.021
Korçë	83.591	85.398	91.034
Kukës	71.636	73.099	73.225
Lezhë	78.163	82.557	84.083
Shkodër	78.764	83.014	84.546
Tiranë	99.416	104.426	108.098
Vlorë	75.481	79.337	83.611
Shqipëria	84.548	88.367	91.675

Burimi: INSTAT, "Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare"

Tab 4.2 Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas arsimit të kryefamiljarit dhe qarqeve, viti 2021-2023 (në Lek).

Qarku	Viti	Deri në arsim 8/9 vjeçar	Arsimi i mesëm i përgjithshëm /profesional	Arsimi i lartë / Pas universitar	Gjithsej
Berat	2021	69.591	82.443	112.152	77.402
	2022	86.954	75.873	85.766	82.850
	2023	76.525	95.066	126.563	83.006
Dibër	2021	70.325	70.455	100.641	72.048
	2022	76.320	66.877	77.712	72.724
	2023	71.688	80.064	61.547	74.479
Durrës	2021	73.453	80.473	88.201	77.925
	2022	81.407	83.448	91.150	83.473
	2023	86.685	91.586	103.270	89.561
Elbasan	2021	70.354	77.552	84.409	74.609
	2022	70.645	75.360	95.861	75.899
	2023	78.751	83.087	85.691	80.070
Fier	2021	72.533	88.401	102.069	80.752
	2022	81.140	81.384	98.221	83.371
	2023	78.921	93.298	102.288	85.237
Gjirokastrë	2021	77.560	77.494	72.431	76.877
	2022	68.664	87.243	94.245	81.522
	2023	81.999	82.762	79.971	82.021

Vazhdon

Qarku	Viti	Deri në arsim 8/9 vjeçar	Arsimi i mesëm i përgjithshëm /profesional	Arsimi i lartë / Pas universitar	Gjithsej
Korçë	2021	70.987	98.270	125.869	83.591
	2022	81.022	83.562	103.327	85.398
	2023	82.400	102.680	126.086	91.034
Kukës	2021	63.574	80.081	103.846	71.636
	2022	81.265	64.498	68.659	73.099
	2023	71.653	71.547	99.365	73.225
Lezhë	2021	72.776	78.947	98.589	78.163
	2022	80.678	76.103	112.824	82.557
	2023	72.693	95.278	127.056	84.083
Shkodër	2021	71.957	85.212	94.908	78.764
	2022	80.260	75.065	121.492	83.014
	2023	79.816	86.738	111.085	84.546
Tiranë	2021	88.300	96.399	122.773	99.416
	2022	99.703	101.769	123.570	104.426
	2023	104.909	105.619	127.097	108.098
Vlorë	2021	66.808	80.230	94.471	75.481
	2022	77.482	76.644	97.217	79.337
	2023	79.517	85.782	103.576	83.611
Shqipëria	2021	74.809	87.967	109.208	84.548
	2022	85.388	85.175	107.233	88.367
	2023	85.119	96.176	115.893	91.675

Burimi: INSTAT, "Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare"

Tab 4.3 Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas tipit të familjes dhe qarqeve, viti 2021-2023 (në Lek).

Qarku	Year	Tipi i familjes						Gjithsej
		Person i vetëm	Person i vetëm me fëmijë në varësi	Dy të rritur pa fëmijë	Dy të rritur me fëmijë	Tri ose më shumë të rritur pa fëmijë	Tri ose më shumë të rritur me fëmijë	
Berat	2021	37.283	91.300	59.496	74.621	83.249	104.957	77.402
	2022	36.990	35.074	69.811	82.367	104.508	103.606	82.850
	2023	45.738	67.015	71.795	87.161	94.320	104.256	83.006
Dibër	2021	40.801	64.521	60.585	64.508	78.239	84.520	72.048
	2022	48.483	-	70.895	70.530	71.096	80.541	72.724
	2023	51.646	-	64.616	74.921	72.993	93.762	74.479
Durrës	2021	43.630	61.427	58.976	83.426	83.695	89.698	77.925
	2022	38.646	82.930	58.201	80.704	90.360	98.554	83.473
	2023	51.170	-	72.232	88.334	94.888	102.425	89.561
Elbasan	2021	55.205	66.888	63.470	76.888	79.881	81.581	74.609
	2022	51.591	107.458	61.751	81.364	79.636	85.961	75.899
	2023	53.250	69.046	61.816	79.979	85.403	98.692	80.070

Vazhdon

Qarku	Year	Tipi i familjes						Gjithsej
		Person i vetëm	Person i vetëm me fëmijë në varësi	Dy të rritur pa fëmijë	Dy të rritur me fëmijë	Tri ose më shumë të rritur pa fëmijë	Tri ose më shumë të rritur me fëmijë	
Fier	2021	44.716	49.478	62.879	86.724	86.697	98.056	80.752
	2022	40.784	82.605	64.412	83.634	94.589	103.110	83.371
	2023	44.678	63.105	71.472	89.114	88.046	110.202	85.237
Gjirokastrë	2021	46.213	-	61.871	95.682	86.908	93.840	76.877
	2022	38.747	-	64.064	126.893	98.272	82.315	81.522
	2023	57.706	*	73.055	86.379	93.244	109.522	82.021
Korçë	2021	45.754	98.405	64.179	90.623	92.732	104.294	83.591
	2022	44.002	69.502	70.254	98.329	92.977	101.100	85.398
	2023	64.760	77.572	80.638	99.564	97.585	105.132	91.034
Kukës	2021	40.577	*	58.669	70.745	71.565	79.999	71.636
	2022	44.355	-	55.592	71.739	70.865	84.360	73.099
	2023	31.158	*	64.351	73.558	69.126	81.856	73.225
Lezhë	2021	40.716	72.213	66.953	73.652	84.342	94.513	78.163
	2022	36.105	58.986	61.886	80.531	91.709	102.604	82.557
	2023	51.799	*	67.275	82.446	92.788	101.697	84.083
Shkodër	2021	41.861	71.499	56.870	74.668	88.781	97.783	78.764
	2022	36.841	122.505	59.318	75.686	89.517	111.916	83.014
	2023	44.429	*	66.270	99.338	98.102	98.949	84.546
Tiranë	2021	51.363	69.893	70.545	98.222	112.847	112.729	99.416
	2022	58.395	71.389	74.426	107.656	114.221	119.824	104.426
	2023	71.307	87.037	80.341	103.190	116.314	122.222	108.098
Vlorë	2021	46.460	78.780	59.884	90.897	77.627	86.245	75.481
	2022	40.752	77.655	58.900	94.121	85.618	90.216	79.337
	2023	46.512	*	64.203	96.312	88.171	105.806	83.611
Shqipëria	2021	46.815	72.307	63.557	87.439	94.467	98.795	84.548
	2022	46.660	79.342	66.049	92.889	97.929	104.177	88.367
	2023	55.940	74.120	71.792	92.476	98.931	109.671	91.675

Burimi: INSTAT, "Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare"

* Vlera të fshehura për arsye konfidencialiteti.

Tab 4.4 Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas madhësisë së familjes dhe qarqeve, viti 2021-2023 (në Lek).

Qarku	Year	Madhësia e NjEF					Gjithsej
		Familje me një person	Familje me 2 persona	Familje me 3 persona	Familje me 4 persona	Familje me 5+ persona	
Berat	2021	37.283	60.167	76.426	90.626	103.684	77.402
	2022	36.990	69.811	81.760	107.206	104.529	82.850
	2023	45.738	71.643	78.561	101.527	104.888	83.006

Vazhdon

Qarku	Year	Madhësia e NJEF					
		Familje me një person	Familje me 2 persona	Familje me 3 persona	Familje me 4 persona	Familje me 5+ persona	Gjithsej
Dibër	2021	40.801	60.776	75.365	74.743	80.217	72.048
	2022	48.483	70.895	63.730	70.384	81.864	72.724
	2023	51.646	64.616	60.895	78.459	92.349	74.479
Durrës	2021	43.630	59.066	71.990	84.367	93.887	77.925
	2022	38.646	58.592	77.418	90.592	101.411	83.473
	2023	51.170	72.232	84.015	93.910	105.939	89.561
Elbasan	2021	55.205	63.620	74.692	81.098	80.976	74.609
	2022	51.591	61.923	79.071	81.632	87.594	75.899
	2023	53.250	61.967	77.582	90.807	94.310	80.070
Fier	2021	44.716	62.949	77.279	88.191	101.962	80.752
	2022	40.784	64.281	81.862	95.903	106.388	83.371
	2023	44.678	71.427	85.628	97.707	104.233	85.237
Gjirokastrë	2021	46.213	61.871	81.526	93.087	100.111	76.877
	2022	38.747	64.064	98.816	81.101	121.980	81.522
	2023	57.706	73.055	87.045	83.802	119.804	82.021
Korçë	2021	45.754	64.736	89.120	93.048	106.449	83.591
	2022	44.002	70.193	91.158	96.156	103.604	85.398
	2023	64.760	80.578	95.022	104.825	102.351	91.034
Kukës	2021	40.577	58.465	72.802	84.478	71.608	71.636
	2022	44.355	55.592	69.106	73.314	81.976	73.099
	2023	31.158	64.276	69.559	72.064	78.421	73.225
Lezhë	2021	40.716	66.710	73.896	80.763	96.900	78.163
	2022	36.105	61.326	75.670	91.356	107.258	82.557
	2023	51.799	67.147	88.647	93.091	97.340	84.083
Shkodër	2021	41.861	56.873	73.229	86.974	99.720	78.764
	2022	36.841	59.318	77.261	87.531	114.479	83.014
	2023	44.429	66.527	94.849	99.304	100.347	84.546
Tiranë	2021	51.363	70.456	93.854	110.982	114.847	99.416
	2022	58.395	74.230	97.832	114.799	122.113	104.426
	2023	71.307	80.307	106.818	113.709	121.935	108.098
Vlorë	2021	46.460	59.696	76.124	80.744	95.481	75.481
	2022	40.752	58.934	91.523	84.554	88.902	79.337
	2023	46.512	64.209	78.155	97.922	107.836	83.611
Shqipëria	2021	46.815	63.627	81.824	94.884	101.223	84.548
	2022	46.660	66.001	86.480	99.012	107.439	88.367
	2023	55.940	71.791	89.686	101.261	109.111	91.675

Burimi: INSTAT, "Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare".





MBROJTJA SOCIALE

5

Mbrojtja sociale përfshin tërësinë e politikave dhe programeve sociale që realizojnë organet shtetërore dhe private të cilat kanë si synim zvogëlimin e pasojave të varfërisë dhe përjashtimit social në familjet dhe individët që janë më të riskuar në qasjen dhe sigurimin e një sërë nevojash dhe funksionesh të domosdoshme ekonomike dhe sociale. Ndërhyrjet që bëjnë organet publike dhe private në drejtim të mbrojtjes sociale në Shqipëri përfshijnë mbështetje financiare në formën e pagesave në para kesh, shërbimet në formën e rimbursimeve të shpenzimeve të bëra nga personat e mbrojtur si dhe shërbimet në formën e mallrave që u ofrohen drejtpërsëdrejti njerëzve të mbrojtur.


Statistikat e mbrojtjes sociale në këtë kapitull pasqyrojnë të dhëna të disagreguara në nivel qarku lidhur me përfituesit e skemës së pensioneve, ndihmën ekonomike, pagesës për aftësinë e kufizuar, pagesës së papunësisë si dhe të dhëna për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror në institucione.

Pensionet

Pensionet janë kategoria kryesore e përfitimeve sociale dhe kanë numrin më të madh të përfituesve si dhe shpenzimet më të mëdha financiare në sistemin e mbrojtjes sociale në Shqipëri.

Në vitin 2023, sipas llojit të pensioneve, pensionet e pleqërisë zënë rreth 84 % të numrit të pensioneve gjithsej, pensionet e invaliditetit rreth 9 % dhe ato familjare 7 %, (Figura 5.1). Përqindjen më të lartë të numrit të pensioneve të pleqërisë e ka qarku i Tiranës me 24,9 % dhe përqindjen më të ulët e ka qarku i Kukësit me 1.9 % të numrit gjithsej të pensioneve të pleqërisë në shkallë vendi (Tabela 5.1).

Fig 5.1 Llojet e pensioneve në përqindje sipas qarqeve, 2023



Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, llogaritjet INSTAT

Tab 5.1 Pensione pleqërie urbane dhe rurale sipas qarqeve, 2023


Qarku	Pensione pleqërie		
	Urbane	Rurale	Gjithsej
Berat	27.706	5.443	33.149
Dibër	13.912	4.873	18.785
Durrës	46.292	7.022	53.314
Elbasan	40.389	10.452	50.841
Fier	59.008	11.980	70.988
Gjirokastrë	20.500	3.773	24.273
Korçë	47.185	7.802	54.987
Kukës	8.361	2.754	11.115
Lezhë	19.644	4.385	24.029
Shkodër	36.890	7.770	44.660
Tiranë	133.800	13.457	147.257
Vlorë	50.060	7.191	57.251
Shqipëria	503.747	86.902	590.649

Shënim: Në numrin Gjithsej të pensioneve nuk përfshihen pensionet që transferohen ndërmjet Drejtorive Rajonale që në momentin e raportimit nuk kanë arritur ende destinacionin e tyre.

Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Në vitin 2023, numrin më të madh të përfituesve të pensioneve për 1.000 banorë e kishte qarku i Gjirokastrës me 456 përfitues, ndërsa numrin më të ulët të përfituesve e kishte Dibra me 221 përfitues për 1.000 banorë, (Figura 5.2).

Fig 5.2 Përfitues të pensioneve gjithsej për 1.000 banorë sipas qarqeve, 2023



Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, llogaritjet INSTAT

Ndihma ekonomike

Ndihma ekonomike është një pagesë periodike në para kesh që u jepet familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme bazuar në sistemin e pikëzimit ose të fondin prej 6 % që bashkitë përdorin për të mbuluar familjet e varfra të papërfshira në sistemin e pikëzimit si dhe disa kategorive të personave në nevojë. Ndhmën ekonomike e përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe burime të tjera si remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera. Përfitues të ndihmës ekonomike janë gjithashtu disa kategori të personave në nevojë si prindërit në nevojë me më shumë se dy fëmijë të lindur në të njëjtën kohë, jetimët, fëmijët në familje kujdestare, viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit shqiptar.

Në vitin 2023, numri mesatar i familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike në shkallë vendi ishte 55.410 familje. Qarku i Elbasanit kishte numrin më të madh të familjeve me ndihmë ekonomike rreth 25.5 %, e ndjekur nga Dibra me 17.9 %, ndërsa numrin më të vogël të familjeve përfituese e kishte qarku i Durrësit dhe ai i Gjirokastrës përkatësisht me 1,2 % dhe 1,5 % (Tabela 5.2).

Tab 5.2 Numri mesatar i familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike sipas llojit të familjes dhe qarqeve, 2023

Qarku	Familje përfituese në skemën e ndihmës ekonomike	Nga gjithsej familje përfituese sipas llojit, në %		
		Familje me persona me aftësi të kufizuar	Familje me persona nga komuniteti rom	Familje me kryefamiljare gra
Berat	1.168	11	1	11
Dibër	9.941	10	0	8
Durrës	690	24	6	20
Elbasan	14.152	18	2	9
Fier	1.717	9	7	11
Gjirokastrë	840	9	2	6
Korçë	8.197	15	6	10
Kukës	7.847	11	0	8
Lezhë	2.563	17	3	8
Shkodër	3.995	15	1	12
Tiranë	2.700	17	6	15
Vlorë	1.601	11	4	26
Shqipëria	55.410	14	2	10

Shënim: Numri mesatar i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike përfshin vetëm familjet përfituese nga sistemi i pikëzimit
Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, llogaritjet INSTAT

Gjithashtu në vitin 2023, kanë përfituar ndihmë ekonomike rreth 2.389 persona në nevojë. Midis kategorive të përfituesve, përqindja më e madhe ka qenë për viktimat e dhunës dhe trafikimit (39 %). Në nivel qarku përqindjen më të madhe të përfituesve për këtë kategori e kishte Lezha (56 %), Fieri (55 %) dhe Elbasani (54 %) (Tabela 5.3).

Tab 5.3 Numri mesatar i personave në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike, 2023

Qarku	Përfitues gjithsej	Përfitues sipas kategorive në %			
		Jetim jashtë institucionit	Nëna që kanë lindur më shumë se dy fëmijë njëherësh	Viktima të dhunës dhe trafikimit	Fëmijë në shërbim kujdestarie
Berat	83	62	10	15	13
Dibër	117	26	23	38	14
Durrës	188	42	11	29	19
Elbasan	234	27	4	54	14
Fier	339	19	8	55	18
Gjirokastrë	56	63	5	20	12
Korçë	195	46	8	29	17
Kukës	52	19	34	21	25
Lezhë	131	16	9	56	18
Shkodër	76	14	16	27	43
Tiranë	831	49	7	37	8
Vlorë	87	40	11	35	14
Shqipëria	2.389	38	9	39	14

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, llogaritjet INSTAT

Pagesa për aftësinë e kufizuar

Pagesa e aftësisë së kufizuar është një përfitim në para dhe në natyrë që u jepet personave me aftësi të kufizuara për të mbështetur nevojat e tyre të përditshme bazë. Përfitues janë personat që janë shpallur të tillë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë dhe/ose Komisionit Multidisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Në vitin 2023, rreth 72.474 persona ishin përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar. Në fund të vitit 2023, qarku me numrin më të madh të përfituesve në pagesën për aftësinë e kufizuar ishte Elbasani me 56 persona për 1.000 banorë, ndërsa qarku me numrin më të vogël për 1.000 banorë ishte Tirana me 17 persona në pagesë të aftësisë së kufizuar (Tabela 5.4).

Nëse analizojmë shpërndarjen e kësaj pagese sipas llojit të aftësisë së kufizuar, vërehet se aftësia e kufizuar mendore dhe fizike është kategoria që zë pjesën më të madhe me 74 %, e ndjekur nga të verbërit me 18 % dhe paraplegjikë-tetraplegjikë me 8 % të totalit të përfituesve.

Tab 5.4 Numri mesatar i përfituesve të pagesës së paaftësisë sipas llojit të paaftësisë dhe qarqeve, 2023

Qarku	Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar	Sipas llojit të paaftësisë, në %		
		Të verbër	Paraplegjik-tetraplegjik	Paaftësi mendore dhe fizike
Berat	3.625	22	6	72
Dibër	3.434	13	7	80
Durrës	6.772	18	9	73
Elbasan	12.629	17	5	78
Fier	8.636	21	9	70
Gjirokastrë	2.176	20	7	73
Korçë	6.114	18	7	75
Kukës	2.434	8	8	83
Lezhë	4.381	16	9	75
Shkodër	5.091	14	8	78
Tiranë	12.623	19	10	71
Vlorë	4.559	21	11	68
Shqipëria	72.474	18	8	74

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, llogaritjet INSTAT

Institucione të përkujdesit shoqëror

Institucionet e përkujdesit shoqëror përfshijnë një sistem të integruar dhe të organizuar përfitimesh dhe lehtësirash të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të shërbimeve publike ose jo publike, për të garantuar mirëqënien, pavarësinë dhe përfshirjen sociale të individëve dhe familjeve që kanë nevojë për përkujdes shoqëror.

Në vitin 2023, mesatarisht 14.929 persona kanë qenë përfitues të përkujdesit shoqëror, nga të cilët 1.728 janë vendosur në qendrat rezidenciale të përkujdesit shoqëror dhe 13.201 kanë marrë shërbim në qendrat ditore të institucioneve të përkujdesit shoqëror. Numri më i madh i përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror ishte në qendrat sociale të qarkut Shkodër, Tiranë, Durrës dhe Elbasan. (Tabela 5.5).

Tab 5.5 Institucione publike dhe private të përkujdesit shoqëror dhe numri i përfituesve në këto qendra, 2023

Qarku	Institucione të kujdesit shoqëror			Përfitues		
	Gjithsej	Rezidenciale	Kujdes ditor	Gjithsej	Rezidenciale	Kujdes ditor
Berat*	5	3	2	206	86	120
Dibër	4	0	4	117	0	117
Durrës	27	6	21	1.703	119	1584
Elbasan	33	8	25	1.617	93	1524
Fier	4	1	3	300	53	247
Gjirokastrë	6	2	4	213	71	142
Korçë*	28	7	21	1.102	103	999
Kukës	3	1	2	111	2	109
Lezhë	13	4	9	554	33	522
Shkodër*	80	26	54	5.296	488	4808
Tiranë	49	17	32	3.093	601	2492
Vlorë	19	6	13	619	80	539
Shqipëria	271	80	191	14.929	1.728	13.201

Shënim:* Institucione të përkujdesit shoqëror që kanë shërbim rezidencial dhe ditor
Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, llogaritjet INSTAT

Pagesa e papunësisë

Përfitimet e papunësisë janë një shumë mujore në para, e cila siguron mbështetje në të ardhurat për personat e regjistruar si punëkërkues të papunë të cilët sipas përcaktimeve ligjore kanë të drejtë ta marrin atë.

Gjatë vitit 2023, numri mesatar gjithsej i punëkërkuesve të papunë të regjistruar ishte 76.580 persona, ndërsa numri mesatar i përfituesve të pagesës së papunësisë ishte 2.864 persona, që përfaqësojnë rreth 4 % të totalit të punëkërkuesve të papunë të regjistruar. Përqindja më e lartë e përfituesve të pagesës së papunësisë u konstatua në qarqet e Korçës me 6% si dhe të Beratit, Lezhës dhe Shkodrës përkatësisht me 5 %, ndërsa më e ulta u konstatua në qarqet e Dibrës dhe Kukësit me 2 % (Tabela 5.6).

Tab 5.6 Numri mesatar i punëkërkuessve të papunë të regjistruar, sipas statusit të punëkërkuessve dhe qarqeve, 2023

Qarku	Gjithsej punëkërkuess të papunë të regjistruar	Sipas statusit të punëkërkuessve të papunë të regjistruar në %				
		Gra	Kryefamiljar	Me aftesi të kufizuar	Përfitues të ndihmës ekonomike	Përfitues të pagesës së papunësisë
Berat	2.687	48	40	0	28	5
Dibër	5.022	56	38	3	54	2
Durrës	7.024	56	35	2	12	3
Elbasan	7.953	55	44	3	61	4
Fier	7.042	54	39	3	20	5
Gjirokastrë	5.698	48	37	5	24	3
Korçë	6.158	51	40	1	41	6
Kukës	6.700	52	36	1	65	2
Lezhë	3.550	58	43	1	44	5
Shkodër	5.187	55	35	2	28	5
Tiranë	14.976	57	37	2	25	3
Vlorë	4.583	56	37	2	28	4
Shqipëria	76.580	54	38	2	35	4

Burimi: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, llogaritjet INSTAT

Nga përfituesit e pagesës së papunësisë rreth 61 % janë gra dhe rreth 37 % kryefamiljarë (Tabela 5.7).

Tab 5.7 Numri mesatar i përfituesve të pagesës së papunësisë sipas qarqeve, 2023

Qarku	Përfitues gjithsej	Sipas statusit të përfituesve, në %	
		Gra	Kryefamiljarë
Berat	143	54	41
Dibër	109	60	40
Durrës	203	68	28
Elbasan	301	57	43
Fier	355	45	26
Gjirokastrë	146	53	40
Korçë	363	60	32
Kukës	154	47	45
Lezhë	164	61	39
Shkodër	275	64	37
Tiranë	481	65	36
Vlorë	170	99	35
Shqipëria	2.864	61	37

Burimi: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, llogaritjet INSTAT

Burimet e të dhënave

Informacioni i paraqitur në këtë kapitull bazohet në të dhënat administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Shërbimit Social Shtetëror dhe Agjencisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim, si regjistrat e pensioneve, regjistrat elektronikë të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar, regjistrat e punëkërkesve dhe të shërbimeve të kujdesit social në institucione.

Përkufizime

Përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar: 1. Personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të shpallur të tillë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë pavarësisht nga shkaku dhe mosha; 2. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë shpallen të paaftë për punë, si dhe personat e paaftë për punë, që nuk plotësojnë kushtet për pensionin e aftësisë së kufizuar profesionale sipas ligjit për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë; 3. Personat me aftësi të kufizuar, të shpallur të tillë me vendim të Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Përfitues të ndihmës ekonomike: 1. Familjet në nevojë që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme; 2. Prindër në nevojë me më shumë se dy fëmijë të lindur në të njëjtën kohë; 3. Fëmijët e vendosur në familje kujdestare sipas ligjit nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Social në Republikën e Shqipërisë"; 4. Jetimët që nuk ndodhen në institucione; 5. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit social deri në momentin e punësimit të tyre; 6. Viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat nuk trajtohen në institucionet e përkujdesit shoqëror; 7. Refugjatët që kanë marrë statusin e refugjatit sipas ligjit 121/2014 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".

Përfituesit e pagesës së papunësisë: 1. Personat që kanë kontribuar në fondin e sigurimeve shoqërore për jo më pak se 12 muaj për çdo rast rreziku; 2. Personat që certifikohen nga zyra përkatëse e punës si punëkërkes të papunë të gatshëm për t'u punësuar kur u ofrohet një punë e përshtatshme me pagesë.

Fëmijë në nevojë për mbrojtje të veçantë: Personi deri në moshën 18 vjeç, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit, trafikimit, diskriminimit, dhunës, braktisjes ose veprimtarisë kriminale, si dhe një individ nën moshën 18 vjeç, i cili ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale.

Pension invaliditeti: Pagesë periodike në para për një person që ka humbur aftësinë për të punuar për shkak të një sëmundjeje, një handikapi ose një dëmtimi (përfshirë verbimin) të cilët kanë qënë kontribues në fondin e sigurimeve shoqërore.

Pensioni i pleqërisë: Pagesë periodike me para në dorë që i paguhet një personi të siguruar, me qëllim për të mbajtur të ardhurat nga puna edhe pas arritjes së moshës ligjore të pensionit.

Personat me aftësi të kufizuara: Personi, fëmijë apo i rritur, me dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri.

Shërbime rezidenciale: Shërbime të kujdesit njëzet e katër orësh dhe afatgjatë për individët në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendra rezidenciale, publike dhe jo publike.

Shërbimet e përkujdesit social: Sistemi i integruar dhe i organizuar i përfitimeve dhe lehtësive, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të enteve publike ose jo publike, për të garantuar mirëqenien, pavarësinë dhe përfshirjen sociale të individëve dhe familjeve në nevojë për kujdes shoqëror.

Skema e mbrojtjes shoqërore: Set i veçantë i rregullave, mbështetur nga një ose më shumë njësi institucionale që rregullojnë dhënien e përfitimeve të mbrojtjes sociale dhe financimin e tyre.

Pensioni familjare: Pagesë periodike në para për njerëzit, e drejta e të cilëve rezulton nga marrëdhënia e tyre me një person të vdekur të mbrojtur nga skema e pensioneve.

Viktimat e dhunës në familje: Individë, grupe individësh ose familje që janë viktimat dhe/ose viktimat të mundshme të dhunës, duke përfshirë dhunën në familje ose abuzimin, sipas ligjit në fuqi.

Viktimat e trafikimit: Personi që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përcaktimit të nenit 4, të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore".



ARSIMI



Të dhënat për arsimin zyrtar mbledhen sipas niveleve arsimore dhe shërbejnë si burim kryesor për përgatitjen e statistikave dhe treguesve të arsimit. Në bazë të informacionit të marrë, INSTAT përpunon të dhënat dhe llogarit treguesit sipas niveleve arsimore për arsimin parauniversitar, pas të mesëm jo të lartë dhe arsimin e lartë. Arsimi parauniversitar përfshin: arsimin parashkollor, arsimin e detyruar 9-vjeçar, arsimin e mesëm (gjimnaz, profesional dhe të orientuar/social kulturor). Arsimi i lartë përfshin programe të tilla: si cikli i shkurtër i arsimit të lartë, Bachelor, Master dhe Doktoraturë.

Për sa i përket arsimit të mesëm, arsimi i mesëm i orientuar/social kulturor përfshin programe në fushën e artit, sportit dhe teknologjisë, i cili iu ofrohet nxënësve të talentuar në arte, koreografi, sport, ekonomi dhe teknologji. Kohëzgjatja e këtyre programeve shkollore varion nga tre në katër vjet, sipas përmbajtjes së programit arsimor.

Programet e arsimit profesional zgjasin nga dy deri në katër vjet. Arsimi profesional që nga viti shkollor 2009-2010 bazohet në strukturën e rekomanduar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve.


Treguesit e arsimit llogariten për vite shkollore/akademike në nivel kombëtar, qarku dhe bashkie për arsimin parauniversitar dhe në nivel kombëtar për arsimin pas të mesëm jo-të lartë dhe për arsimin e lartë.

Numri i nxënësve të arsimit parauniversitar ka një ulje të vazhdueshme në vlerë absolute. Në vitin shkollor 2023-24, u regjistruan në arsimin parauniversitar 416.538 nxënës dhe fëmijë, duke shënuar një ulje prej 3,8%, krahasuar me vitin shkollor 2022-23 dhe 13,6% krahasuar me vitin shkollor 2019-2020. Rënia e numrit të nxënësve në vlerë absolute, ndjek rënien e popullsisë së grupmoshës që i përket arsimit parauniversitar.

Në vitin shkollor 2023-24, u regjistruan gjithsej në arsimin parashkollor 66.711 fëmijë, duke shënuar një ulje prej 4,4% krahasuar me vitin paraardhës dhe një ulje prej 14,3% krahasuar me vitin shkollor 2019-20. Në vitin shkollor 2023-24, u regjistruan në arsimin 9-vjeçar 258.072 nxënës, duke shënuar një ulje prej 3,4% krahasuar me vitin paraardhës dhe 12,5% krahasuar me 2019-2020.

Në arsimin e mesëm privat ndjekin studimet 15,0% e nxënësve të arsimit të mesëm gjithsej. Sidoqoftë, vërehen ndryshime të mëdha ndërmjet qarqeve Vlorë, Fier, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Durrës, të cilat kanë përqindjen më të lartë të arsimit të mesëm privat, dhe qarqeve Gjirokastrë, Elbasan dhe Berat ku arsimi privat përbën vetëm një përqindje të vogël. Në qarqet e Kukësit dhe Dibrës nuk ka arsim të mesëm privat.

Fig 6.1 Të regjistruar në arsimin e mesëm publik dhe privat sipas qarqeve, 2023-2024




Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; llogaritjet nga INSTAT

Arsimi profesional ka qenë përparësi vitet e fundit, duke u parë si një mundësi për të plotësuar nevojën e vazhdueshme për punonjës të specializuar në profesione të ndryshme. Të regjistruarit e arsimit të mesëm profesional për vitin 2023-24 përbëjnë 17,9% të numrit të përgjithshëm të të regjistruarve në arsimin e mesëm, ndërsa në vitin 2019-20 përbënin 18,0%.

Rritjen më të lartë në përqindjen që zë arsimi profesional në këtë vit shkollor, krahasuar me vitin 2019-20, e kanë qarqet Lezhë dhe Elbasan me respektivisht me 2,5 dhe 1,6 pikë përqindje. Prefekturat Durrës dhe Vlorë, patën një ulje prej respektivisht 3,8 dhe 1,5 pikë përqindje. Prefekturat e tjera patën një ndryshim prej më pak se 1,0 pikë përqindje.


Fig 6.2 Të regjistruarit në arsimin profesional në përqindje ndaj arsimit të mesëm gjithsej sipas qarqeve, 2019-2020, 2023-2024



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; Ilogaritjet nga INSTAT

Në vitin shkollor 2022-23, 28.488 nxënës u diplomuan në arsimin 9-vjeçar, duke shënuar një ulje prej 4,8%, krahasuar me vitin paraardhës. Në vitin 2022-23, 27.069 nxënës u diplomuan në arsimin e mesëm, me një rënie prej 8,3% krahasuar me vitin 2021-22.

Fig 6.3. Shpërndarja e të diplomuarve në arsimin e mesëm sipas programeve dhe qarqeve, 2022-2023




Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; Ilogaritjet nga INSTAT

Raporti i nxënësve për një mësues shihet si tregues cilësie në procesin e mësimdhënies. Në nivel vendi në vitin shkollor 2023-24, shkollat private kanë pothuaj të njëjtin numër të nxënësve për mësues me ato publike. Por situata nuk është e njëjtë në qarqe të ndryshme të vendit.

Shkollat private, niveli fillor, në Tiranë dhe Durrës kanë më pak nxënës për mësues se sa ato publike, respektivisht 13,8 dhe 15,3 nxënës për mësues, ndërsa shkollat publike kanë 20,8 dhe 19,9 nxënës për mësues.

Qarqet e tjerë kanë tendencë të kundërt përsa i përket nivelit fillor. Për këtë nivel arsimor, shkollat private në qarkun e Gjirokastrës kanë 25,6 nxënës për mësues ndërsa ato publike kanë 10,1. Në Berat shkollat private kanë 23,7 nxënës për mësues dhe shkollat publike 11,5. Ndryshime më pak ekstreme në këtë drejtim kanë qarqet Korçë dhe Lezhë.

Fig 6.4. Raporti nxënës për një mësues në arsimin fillor, publik dhe privat, 2023-2024



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, llogaritjet nga INSTAT

Aneks

Tab 6.1 Treguesit e arsimit publik sipas qarqeve dhe bashkive, 2023-2024

Qarku/ Bashki	Fëmijë në kopshte	Nxënës në arsimin 9-vjeçar	Nxënës për klasë në shkollat 9-vjeçare	Nxënës për mësues në arsimin 9-vjeçar	Nxënës në shkollat e mesme	Nga këto, në %		
						Në Gjimnaze	Në Gjimnaze te orientuara (Social-kul- turore)	Në shkolla Profesionale
Berat	2.748	10.313	13,5	9,0	4.080	86,5	1,3	12,2
Berat	1.316	4.961	16,1	10,1	2.307	76,1	2,3	21,6
Dimal	654	2.326	14,1	9,8	637	100,0	0,0	0,0
Kuçovë	511	1.789	12,7	8,2	625	100,0	0,0	0,0
Skrapar	161	628	6,8	5,5	294	100,0	0,0	0,0
Poliçan	106	609	10,7	6,6	217	100,0	0,0	0,0
Dibër	3.351	11.131	14,2	8,7	3.249	91,0	0,0	9,0
Dibër	1.739	5.480	14,4	9,0	1.710	87,8	0,0	12,2
Bulqizë	761	2.572	14,6	9,5	606	86,0	0,0	14,0
Mat	525	1.863	14,2	8,2	645	100,0	0,0	0,0
Klos	326	1.216	12,4	7,2	288	100,0	0,0	0,0
Durrës	6.099	28.617	20,4	13,0	9.800	76,4	2,8	20,9
Durrës	4.031	20.543	21,4	13,3	7.796	70,3	3,5	26,2
Shijak	593	2.063	17,2	11,6	352	100,0	0,0	0,0
Krujë	1.475	6.011	18,5	12,4	1.652	100,0	0,0	0,0
Elbasan	6.870	23.780	14,1	8,8	8.896	81,5	1,9	16,7
Elbasan	3.709	12.194	16,2	9,9	5.266	71,3	3,1	25,6
Cërrik	512	1.850	13,6	8,2	603	77,6	0,0	22,4
Belsh	278	1.221	11,9	8,1	292	100,0	0,0	0,0
Peqin	394	1.878	13,9	8,9	411	100,0	0,0	0,0
Gramsh	538	1.758	10,0	5,9	567	100,0	0,0	0,0
Librazhd	804	2.539	11,6	7,4	962	100,0	0,0	0,0
Prrenjas	635	2.340	13,9	9,3	795	100,0	0,0	0,0
Fier	6.413	24.072	15,8	9,9	8.899	84,8	0,7	14,5
Fier	2.733	10.683	17,3	10,7	4.357	79,3	1,4	19,3
Lushnjë	1.776	5.886	15,2	9,5	2.200	79,5	0,0	20,5
Patos	405	1.582	14,5	9,5	421	100,0	0,0	0,0
Roskovec	416	1.820	14,6	9,8	583	100,0	0,0	0,0
Divjakë	720	2.497	15,1	9,5	781	100,0	0,0	0,0
Mallakastër	363	1.604	13,0	8,0	557	100,0	0,0	0,0
Gjirokastrë	1.397	4.855	12,5	9,8	1.958	88,5	4,2	7,4
Gjirokastrë	722	2.453	18,6	11,7	1.074	79,0	7,6	13,4
Libohovë	62	212	10,6	6,2	44	100,0	0,0	0,0
Përmet	159	547	11,9	6,9	211	100,0	0,0	0,0
Këlcyrë	72	370	11,6	6,3	178	100,0	0,0	0,0
Tepelenë	175	587	10,3	7,4	190	100,0	0,0	0,0
Memaliaj	155	551	6,6	5,3	194	100,0	0,0	0,0
Dropull	52	135	7,1	5,6	67	100,0	0,0	0,0

Vazhdon

Qarku/ Bashki	Fëmijë në kopshte	Nxënës në arsimin 9-vjeçar	Nxënës për klasë në shkollat 9-vjeçare	Nxënës për mësues në arsimin 9-vjeçar	Nxënës në shkollat e mesme	Nga këto, në %		
						Në Gjimnaze	Në Gjimnaze te orientuara (Social-kul- turore)	Në shkolla Profesionale
Korçë	4.837	16.342	14.4	8.8	6.243	79,4	3,0	17,6
Korçë	1.716	5.683	16.2	9.9	2.814	63,1	6,6	30,2
Pogradec	1.577	5.172	15.5	8.6	2.001	87,7	0,0	12,3
Maliq	832	3.102	12.9	8.4	656	100,0	0,0	0,0
Pustec	30	83	5.2	4.6	15	100,0	0,0	0,0
Kolonjë	163	564	9.7	6.1	212	100,0	0,0	0,0
Devoll	519	1.738	12.6	8.2	545	100,0	0,0	0,0
Kukës	2.484	8.342	13.0	8.6	2.507	97,8	0,0	2,2
Kukës	1.490	5.037	14.0	8.8	1.565	96,5	0,0	3,5
Tropojë	492	1.593	9.7	7.2	489	100,0	0,0	0,0
Has	502	1.712	14.4	9.4	453	100,0	0,0	0,0
Lezhë	3.047	11.624	16.9	9.8	3.948	78,0	0,0	22,0
Lezhë	1.647	6.367	17.7	10.3	2.188	79,6	0,0	20,4
Mirditë	312	1.233	13.9	8.0	704	40,3	0,0	59,7
Kurbin	1.088	4.024	16.8	9.7	1.056	100,0	0,0	0,0
Shkodër	3.576	16.203	14.7	8.5	6.386	69,5	9,7	20,8
Shkodër	2.213	11.842	16.8	9.8	5.227	65,0	11,8	23,1
Vau i Dejës	495	1.707	12.6	7.4	404	71,3	0,0	28,7
Malësi e Madhe	617	1.775	11.8	6.6	475	100,0	0,0	0,0
Pukë	156	494	8.8	4.9	183	100,0	0,0	0,0
Fushë-Arrëz	95	385	7.1	4.3	97	100,0	0,0	0,0
Tiranë	21.853	88.668	22.5	13.8	30.298	76,3	3,2	20,5
Tiranë	16.785	68.875	22.8	13.9	23.872	76,8	4,0	19,2
Kamëz	3.166	12.625	26.4	17.3	4.482	67,3	0,0	32,7
Vorë	609	2.868	20.2	12.1	707	100,0	0,0	0,0
Kavajë	961	3.005	15.9	9.1	894	79,6	1,6	18,8
Rrogozhinë	332	1.295	11.6	7.0	343	100,0	0,0	0,0
Vlorë	4.036	14.125	15.9	9.5	5.491	79,0	1,1	19,9
Vlorë	2.513	8.873	17.9	10.2	3.630	76,0	1,7	22,3
Himarë	143	527	10.1	6.5	159	100,0	0,0	0,0
Sarandë	762	2.657	21.6	14.1	1.009	72,2	0,0	27,8
Konispol	122	436	12.1	5.7	105	100,0	0,0	0,0
Delvinë	153	515	10.3	10.1	151	100,0	0,0	0,0
Finiq	59	269	6.4	4.8	187	100,0	0,0	0,0
Selenicë	284	848	9.5	5.4	250	100,0	0,0	0,0
Shqipëria	66.711	258.072	17.3	10.7	91.755	79,4	2,7	17,9

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; llogaritjet nga INSTAT

Tab 6.2 Kopshte, fëmijë të regjistruar dhe edukatore sipas qarqeve, 2023-2024

Qarku	2023-24			Ndryshimi me vitin 2019-20		
	Kopshte	Fëmijë të regjistruar	Edukatore	Kopshte	Fëmijë të regjistruar	Edukatore
Berat	127	2.748	275	-5	-1.139	-5
Dibër	158	3.351	290	-3	-764	18
Durrës	119	6.099	392	5	-231	53
Elbasan	283	6.870	554	-6	-1.308	6
Fier	265	6.413	524	0	-2.240	-38
Gjirokastrë	77	1.397	177	-1	-1.141	-56
Korçë	196	4.837	486	-5	-1.576	6
Kukës	97	2.484	199	0	-313	21
Lezhë	86	3.047	229	-7	-840	-11
Shkodër	136	3.576	303	-10	-562	20
Tiranë	391	21.853	1.517	-15	-1.084	42
Vlorë	134	4.036	368	-5	51	115
Shqipëria	2.069	66.711	5.314	-52	-11.147	171

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit; llogaritjet nga INSTAT

Tab 6.3 Institucione arsimore, nxënës dhe mësues në shkollat 9-vjeçare sipas qarqeve, 2023-2024

Qarku	2023-24			Ndryshimi me vitin 2019-20		
	Shkolla	Nxënës	Mësues	Shkolla	Nxënës	Mësues
Berat	63	10.313	1.150	-7	-2.650	-49
Dibër	68	11.131	1.278	-8	-3.190	-122
Durrës	99	28.617	2.206	0	-2.740	384
Elbasan	138	23.780	2.711	-19	-4.990	-60
Fier	133	24.072	2.438	-16	-5.826	-5
Gjirokastrë	31	4.855	496	-5	-1.067	-182
Korçë	91	16.342	1.866	-14	-3.567	163
Kukës	53	8.342	974	-12	-1.447	-10
Lezhë	61	11.624	1.188	-9	-2.195	77
Shkodër	89	16.203	1.898	-13	-3.162	61
Tiranë	226	88.668	6.423	3	-3.080	1.588
Vlorë	75	14.125	1.481	-4	-2.893	262
Shqipëria	1.127	258.072	24.109	-104	-36.807	2.107

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit; llogaritjet nga INSTAT

Tab 6.4 Nxënës që kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar publik dhe privat sipas qarqeve, 2022-2023

Qarku	2022-23		Ndryshimi me vitin 2018-19	
	Publik	Privat	Publik	Privat
Berat	1.212	62	-397	14
Dibër	1.216	0	-619	0
Durrës	2.602	292	-820	-36
Elbasan	2.651	94	-694	13
Fier	2.523	313	-832	10
Gjirokastrë	572	42	-85	0
Korçë	1.885	51	-330	-44
Kukës	885	0	-427	0
Lezhë	1.234	95	-442	0
Shkodër	1.604	360	-624	-34
Tiranë	8.012	1.144	-1.015	255
Vlorë	1.451	188	-351	-36
Shqipëria	25.847	2.641	-6.636	142

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit; llogaritjet nga INSTAT

Tab 6.5 Mësues dhe nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm sipas qarqeve, 2023-2024

Qarku	2023-24				Ndryshimi me vitin 2019-20			
	Publik		Privat		Publik		Privat	
	Mësues	Nxënës	Mësues	Nxënës	Mësues	Nxënës	Mësues	Nxënës
Berat	352	3.739	32	341	-36	-1.072	8	44
Dibër	305	3.249	0	0	-27	-1.123	0	0
Durrës	592	8.202	181	1.598	4	-1.866	-1	33
Elbasan	731	8.358	57	538	-64	-1.887	13	158
Fier	649	7.001	127	1.898	-69	-1.860	-4	-2
Gjirokastrë	221	1.875	24	83	-12	-297	-2	40
Korçë	555	5.659	55	584	-16	-1.098	-73	-18
Kukës	238	2.507	0	0	-26	-994	0	0
Lezhë	353	3.149	68	799	-25	-1.295	17	-7
Shkodër	534	5.106	130	1.280	-35	-1.580	-15	-304
Tiranë	1.872	24.881	720	5.417	0	-3.516	66	-252
Vlorë	403	4.310	108	1.181	-49	-950	-13	68
Shqipëria	6.805	78.036	1.502	13.719	-355	-17.538	-4	-240


Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; llogaritjet nga INSTAT

Tab 6.6 Nxënës të diplomuar në arsimin e mesëm sipas qarqeve, 2021-2022, 2022-2023

Qarku	2021-22		2022-23	
	Publik	Privat	Publik	Privat
Berat	1.193	120	1.194	80
Dibër	979	0	847	0
Durrës	2.667	587	2.286	504
Elbasan	2.637	145	2.246	162
Fier	2.313	597	2.110	679
Gjirokastrë	540	100	530	27
Korçë	1.831	179	1.688	179
Kukës	887	0	870	0
Lezhë	1.129	218	938	231
Shkodër	1.666	475	1.475	413
Tiranë	7.793	1.888	7.396	1.627
Vlorë	1.239	320	1.221	366
Shqipëria	24.874	4.629	22.801	4.268

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; Ilogaritjet nga INSTAT

Harta 6.1 Nxënësit e regjistruar në arsimin e mesëm sipas bashkive, 2023-2024



Metodologjia

INSTAT ka organizuar sigurimin e të dhënave mbi arsimin nëpërmjet hartimit të pyetësorëve të ndryshëm të cilët janë edhe pjesë e Programit Statistikor Zyrtar. Informacioni mbi të dhënat mbi arsimin mblidhet fillimisht nga institucioni arsimor. Ky informacion transmetohet në zyrat ose drejtoritë arsimore (sipas mënyrës së organizimit të njësisë vendore) e më pas dërgohet në njësinë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave të arsimit në Ministrinë përkatëse. Këto të dhëna përpunohen më tej nga Ministrinë të cilat hartojnë përmbledhëse të të dhënave të ndryshme që i dërgojnë në INSTAT. Përmbledhëset përmbajnë të dhëna për fëmijë, nxënës dhe studentë të regjistruar, të diplomuar, institucione arsimore, staf mësimdhënës, etj. sipas njësive administrative dhe në nivel vendi.

Në procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të arsimit, përdoret Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Arsimit ISCED 2011, rekomanduar nga Eurostat dhe UNESCO. Ai është i përbërë nga këto nivele sipas programeve arsimore:

Niveli 0 - Arsimi Parashkollor – çerdhe / kopshte

Niveli 1 - Arsimi Fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë (klasat 1-5)

Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët, ose cikli i lartë i arsimit bazë (klasat 6-9)

Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnaz / Profesional / Social kulturor (klasat (10-12,13))

Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes, jo i lartë

Niveli 5 - Arsimi i lartë, cikël i shkurtër

Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent

Niveli 7 - Master ose ekuivalent

Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

Përkufizime

Arsimi bazë: është arsimi i detyruar që fillon në moshën 6 vjeç dhe është i detyruar deri në moshën 16 vjeç. Kohëzgjatja e tij është 9 vjet dhe përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor i cili kryhet në klasat 1-5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6-9.

Arsimi zyrtar: Arsimi i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar përmes institucioneve publike dhe atyre private, të njohura (licensuara) nga autoriteti kombëtar arsimor, të cilët në tërësinë e tyre përbëjnë sistemin arsimor zyrtar të një vendi. Programet e arsimit zyrtar janë të njohura si të tilla nga autoritetet përkatëse të arsimit kombëtar, ato ekuivalente ose vartëse të tij.

Arsimi zyrtar konsiston më tepër në arsimin që fillon nga klasa e parë dhe vazhdon rregullisht vit pas viti, kryesisht në sistemin pa shkëputje nga puna ose me kohë të plotë (përpara se të bëhen pjesë e tregut të punës), në atë profesional, arsimin për nevoja të veçanta dhe disa programe të arsimit për të rritur shpesh të njohura si pjesë e sistemit arsimor zyrtar.

I diplomuar: Nxënësi ose studenti që i ka përfunduar në mënyrë të suksesshme të gjitha kërkesat e programit arsimor.

Arsimi parauniversitar: Arsimi që kryhet nga institucionet arsimore si kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme.

Institucion arsimor publik: Institucioni arsimor veprimtaria e të cilit kontrollohet plotësisht nga autoriteti arsimor publik.

Raporti nxënës për mësues: Numri i nxënësve ose fëmijëve të regjistruar në një nivel arsimi parauniversitar që i përketin një mësuesi të atij niveli. Treguesi tregon numrin mesatar të nxënësve të regjistruar sipas nivelit arsimor në qark, llogaritur veças për arsimin publik ose privat.

Arsimi arsimi i mesëm i orientuar (ose social kulturor): Programe të tilla si: gjuhë të huaja, arte ose sporte. Shkollat e gjuhëve të huaja janë pjesë e arsimit të mesëm dhe seksionet e shkollave dygjuhësore janë pjesë e shkollave të larta dhe kohëzgjatja e tyre është 3 vjet, në varësi të strukturës së arsimit të mesëm. Arsimi në fushën e arteve, sporteve dhe teknologjisë i ofrohet studentëve të talentuar në arte, koreografi, sporte, ekonomi dhe teknologji ku kohëzgjatja e arsimit varion ndërmjet 3 dhe 4 viteve, në varësi të programit arsimor.

Mësues: Personat veprimtaria profesionale e të cilëve përfshin transmetimin e njohurive, sjelljeve dhe aftësive që janë përcaktuar në programin arsimor për nxënësit dhe studentët e regjistruar në institucionet zyrtare arsimore.

Arsimi i mesëm: Gjimnazi, arsimi profesional, si dhe ai i mesëm i orientuar (social-kulturor).



SHËNDETËSIA

7



Në këtë kapitull paraqiten statistikat e shëndetit publik duke ofruar informacion mbi shkaqet e vdekjeve, shpërndarjen e shërbimeve shëndetësore, sëmundshmërinë si dhe personat me aftësi të kufizuar që janë pjesë e skemave të shërbimit social shtetëror.

Shëndeti është përparësi dhe informacioni mbi shëndetin është shumë i rëndësishëm për qytetarët që duan të kenë një jetë të shëndetshme, të parandalojnë sëmundjet dhe që kërkojnë të marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore. Sigurimi dhe shpërndarja e shërbimit të kujdesit shëndetësor publik në Shqipëri është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Shkaqet e vdekjeve dhe sëmundshmëria

Shkaqet e vdekjeve përcaktohen nga disa faktorë si: mosha, gjinia, kushtet e jetesës, puna dhe mjedisi rrethues. Gjithashtu çdo individ mund të ndikojë në mundësitë e tij për të pasur një jetë të gjatë dhe të shëndetshme duke përshtatur zgjedhjet e tij të jetesës, si për shembull, kontrollet mjeksore, aktiviteti fizik, ushqyerja e shëndetshme dhe eliminimi i sjelljeve me risk për shëndetin si: konsumimi i alkoolit, pirja e duhanit, parandalimi i aksidenteve rrugore etj.

Në vitin 2023, në Shqipëri numri i vdekjeve të regjistruara nga të gjitha shkaqet ishte 21.286. Numri i vdekjeve në nivel vendi shënon një rënie me 11,3%, krahasuar me 2022.

Në vitin 2023, vdekjet nga grupsëmundjet “Sëmundje të sistemit të qarkullimit të gjakut” dhe “Tumore” shkaktojnë numrin më të lartë të vdekjeve.

Tabela 7.1 tregon peshën e dy grupsëmundjeve më të mëdha në totalin e vdekjeve në vend, përkatësisht “Sëmundje të sistemit të qarkullimit të gjakut” dhe “Tumore”. Në nivel vendi 51,7% e vdekjeve gjithsej shkaktohen nga “Sëmundje të sistemit të qarkullimit të gjakut” dhe 15,7% si pasojë e grupsëmundjes “Tumore”. Sipas qarqeve, Kukësi dhe Shkodra kanë përqindjen më të lartë të vdekshmërisë nga “Sëmundje të sistemit të qarkullimit të gjakut” me 67,0% dhe 61,6% të vdekjeve të shkaktuara nga ky grup. Ndërsa për grupsëmundjen e “Tumore” qarku i Korçës dhe Gjirokastrës kanë përqindjen më të lartë të vdekshmërisë me 17,6% dhe 17,2%.

Tab 7.1 Pesha që zënë dy grupsëmundjet kryesore në totalin e vdekjeve sipas grupmoshës dhe qarqeve në %, 2023


Qarku	Tumore			Sëmundje të sistemit të qarkullimit të gjakut		
	Nën 65 vjeç	65+ vjeç	Gjithsej	Nën 65 vjeç	65+ vjeç	Gjithsej
Berat	4,3	10,9	15,2	5,1	47,0	52,1
Dibër	5,4	10,7	16,1	6,3	49,6	55,9
Durrës	5,1	9,0	14,1	5,8	38,6	44,5
Elbasan	5,5	11,0	16,5	7,7	39,3	47,0
Fier	4,8	10,7	15,5	5,9	49,1	55,0
Gjirokastrë	5,1	12,2	17,2	5,3	28,2	33,5
Korçë	5,5	12,1	17,6	5,9	40,2	46,2
Kukës	6,5	8,1	14,6	9,4	57,6	67,0
Lezhë	4,6	9,2	13,8	6,3	44,6	50,9
Shkodër	4,3	9,4	13,7	8,7	52,9	61,6
Tiranë	5,1	11,2	16,3	7,3	47,3	54,6
Vlorë	4,1	10,9	15,0	6,2	43,6	49,8
Shqipëria	5,0	10,7	15,7	6,7	45,0	51,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, llogaritjet nga INSTAT

Disa probleme shëndetësore kronike si hipertensioni dhe diabeti, megjithëse klasifikohen si sëmundje, mund të konsiderohen edhe si faktorë risku për sëmundjet e qarkullimit të gjakut. Bazuar në sistemin e recetës elektronike me rimbursim në vitin 2023, 12,9% e pacientëve kronik janë trajtuar për Diabet Mellitus dhe 33,8% e pacientëve kronik për Hipertension Arterial.


Sipas qarqeve, Durrësi ka përqindjen më të lartë të pacientëve kronik të trajtuar për Diabet Mellitus me 16,5%, ndërsa për Hipertension Arterial përqindjen më të lartë e ka qarku Kukës me 39,2%.

Fig 7.1 Përqindja e numrit të pacientëve të trajtuar për Diabet Mellitus ndaj totalit të pacientëve kronik sipas qarqeve, 2023



Burimi: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor, INSTAT

Fig 7.2 Përqindja e numrit të pacientëve të trajtuar për Hipertension Arterial ndaj totalit të pacientëve kronik sipas qarqeve, 2023




Burimi: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor, INSTAT

Aftësia e kufizuar

Pjesë e rëndësishme e kujdesit shëndetësor është kujdesi ndaj personave me aftësi të kufizuar. Evidentimi i personave të kësaj kategorie si dhe i strukturës së paaftësisë sipas qarqeve është një tregues i rëndësishëm për hartimin e politikave të duhura, në funksion të ndihmës dhe përfshirjes së tyre në shkollim, punësim dhe aktivitete të ndryshme shoqërore. Të dhënat administrative për personat me aftësi të kufizuar bazohen në raportin mjekoligjor të lëshuar nga mjeku.

Sipas llojit të aftësisë së kufizuar, profili në të gjithë qarqet është pothuajse i ngjashëm, mbi 60% e personave me aftësi të kufizuar të regjistruar janë të grupuar në kategorinë "Aftësi e kufizuar mendore dhe fizike".

Fig 7.3 Përqindja e personave me aftësi të kufizuar sipas llojit të paaftësisë dhe sipas qarqeve, 2023



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, llogaritjet nga INSTAT

Shërbimi shëndetësor parësor publik

Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor është pika e parë e kontaktit të popullsisë për zgjidhjen e problemeve shëndetësore. Institucionet bazë që ofrojnë këto shërbime janë poliklinikat, qendrat shëndetësore, ambulancat dhe shërbimet e veçanta të konsultoreve të fëmijëve dhe të gruas. Numri më i madh i këtyre institucioneve është përqendruar në qarqet ku dhe numri i popullsisë është më i lartë në Tiranë, Elbasan dhe Fier.

Tab 7.2 Numri qendrave shëndetësore, personelit mjekësor në shërbimin parësor, numri mesatar i kontakteve, 2023

Qarku	Qendra shëndetësore gjithsej	Numri i mjekëve në shërbimin parësor	Numri i infermierëve në shërbimin parësor
Berat	22	65	474
Dibër	32	49	510
Durrës	32	213	625
Elbasan	46	154	706
Fier	40	147	599
Gjirokastrë	22	48	342
Korçë	37	103	583
Kukës	24	46	336
Lezhë	18	77	328
Shkodër	31	106	603
Tiranë	41	649	1.087
Vlorë	30	106	482
Shqipëria	375	1.763	6.675

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, llogaritjet nga INSTAT

Shërbimi spitalor

Tirana vazhdon të jetë qarku që ka numrin më të lartë të spitaleve dhe të shtretërve spitalor në rang kombëtar. Kjo lidhet jo vetëm me numrin e lartë të popullsisë në këtë qark, por dhe me përqëndrimin e shërbimeve spitalore universitare më të specializuara në funksion të popullsisë për të gjithë vendin. Numri i shtretërve spitalorë së bashku me numrin e mjekëve dhe infermierëve që punojnë në spitale është i lidhur dhe me madhësinë e popullsisë në qarqe.

Tab 7.3 Numri i spitaleve, shtretërve spitalorë në rang kombëtar, sipas qarqeve, 2023

Qarku	Numri i spitaleve	Shtretër spitalorë
Berat	3	398
Dibër	3	543
Durrës	2	497
Elbasan	5	1.073
Fier	4	810
Gjirokastrë	3	367
Korçë	4	789
Kukës	3	399
Lezhë	3	373
Shkodër	3	621
Tiranë	7	2.366
Vlorë	3	603
Shqipëria	43	8.839

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, llogaritjet nga INSTAT

Burimi i të dhënave

INSTAT është një nga institucionet kryesore në vend që publikon të dhëna mbi treguesit shëndetësor dhe shëndetin. Burim të dhënash në përgjithësi janë të dhënat administrative si dhe vrojtimet statistikore në vite. Të dhënat statistikore administrative sigurohen nga institucionet shëndetësore, ku burim kryesor për këto të dhëna janë regjistrat kombëtar të pacientëve ose raportet e përvitshme nga regjistra themeltar të institucioneve, që raportohen në formate të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Zgjedhja dhe caktimi i kriterëve metodologjike bëhet duke u mbështetur në koncepte, përkufizime, metoda të krahasueshme ndërkombëtare. Në këtë botim burime të dhënash për tregues të ndryshëm janë ato administrative të marra në bazë të evidencave statistikore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor dhe Studimi Demografik dhe Shëndetësor 2017-18. Të dhënat për shkaqet e vdekjeve merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, informacion i cili bazohet mbi skedat e vdekjeve të plotësuar nga mjeku.

Përkufizime

Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve "ICD-9": Klasifikimi ndërkombëtar i sëmundjeve bën grupimin në mënyrë të koduar të 17 grupeve kryesore të sëmundjeve. Kodimi për shkaqet e vdekjeve bëhet nga mjeku dhe përbëjnë burimin më të plotë zyrtar statistikor të sëmundjeve që janë shkak i vdekjes.

Koeficienti bruto i vdekshmërisë: Numri i vdekjeve për 100 mijë banorë për një vit të dhënë.

Niveli i vdekshmërisë sipas shkaqeve: Numri i vdekjeve që i atribuohen një shkaku specifik për 100 mijë banorë në një vit të dhënë.

Spitali: Një rezidencë institucionale që ofron kujdes mjekësor, hoteleri-24 orë, diagnostikim, trajtim dhe rehabilitim të të sëmurëve që mund të kenë nevojë për ndihmë mjekësore ose kirurgjikale.

Sëmundshmëria: Numri i rasteve të sëmundjeve në një popullsi të përcaktuar. Ajo matet me prevalencën ose incidencën e sëmundjeve. Përhapja e një sëmundje mund të ketë ndikime serioze mbi aspektet e tjera të popullsisë.

Shkaku i vdekjes: Sëmundja ose simptoma që ka shkaktuar ose kontribuar në vdekje, si dhe rrethanat e aksidentit që kanë shkaktuar këto trauma (Përshkruhet në certifikatën e vdekjes).

Vdekja: Nënkupton zhdukjen e qëndrueshme të të gjitha shenjave të jetës në një moment të çfarëdoshëm pas një lindje të gjallë (ndërprerjen e funksioneve jetësore pa mundësi re animimi). Ky përkufizim nuk përmban vdekjen fetale.





KRIMI DHE DREJTËSIA PENALE

8

Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale pasqyrojnë të dhëna për autorët e veprave penale, të dëmtuarit nga vepra penale kundër personit, të dhëna për personat e pandehur si edhe të dhëna për të burgosurit të disagreguara në nivel qarku.

Autorë të veprave penale

Statistikat mbi autorët e veprave penale përfshijnë të dhëna për persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale.

Në vitin 2023, janë evidentuar gjithsej 39.489 autorë për vepër penale, 2.674 (6,8%) janë gra dhe 36.815 (93,2%) janë burra. Përafërsisht e njëjta strukturë gjinore vihet re edhe në qarqe.

Qarqet me numrin më të lartë të autorëve janë Tirana dhe Durrësi; ndërkohë qarqet me numrin më të ulët të autorëve janë Kukësi dhe Dibra.

Sipas dy ndarjeve të mëdha moshore, 2.005 (5,1%) autorë janë të mitur dhe 37.484 (94,9%) janë të rritur. Qarku i Tiranës dhe Durrësit ka numrin më të lartë të të miturve autorë të veprave penale, përkatësisht 47,0% dhe 8,4% ndaj totalit të autorëve të mitur.

Tab 8.1 Autorë për vepër penale sipas qarqeve, gjinisë dhe moshës, 2023

Qarku	Gjinia		Mosha		Gjithsej
	Gra	Burra	Nën 18 vjeç	18 vjeç +	
Berat	43	1.154	60	1.137	1197
Dibër	40	826	51	815	866
Durrës	447	4.140	169	4.418	4.587
Elbasan	106	2.663	96	2.673	2.769
Fier	169	2.212	123	2.258	2.381
Gjirokastrë	55	1.016	65	1.006	1.071
Korçë	121	2.105	87	2.139	2.226
Kukës	29	879	62	846	908
Lezhë	106	1.956	76	1.986	2.062
Shkodër	137	1.975	112	2.000	2.112
Tiranë	1.202	13.851	943	14.110	15.053
Vlorë	142	2.642	149	2.635	2.784
DPP	77	1.396	12	1.461	1.473
Shqipëria	2.674	36.815	2.005	37.484	39.489

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet nga INSTAT

Shënim: Totali i autorëve paraqet numrin e autorëve për vepër penale. Një autorë mund të jetë i pranishëm në më shumë se një vepër penale. Kategoria "DPP" përfshin raportime direkt në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, ku kategorizimi në qarqe është i pamundur të kryhet.

Të dëmtuar nga veprat penale

Të dëmtuarit i referohen personave të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti. Ky seksion paraqet të dhënat mbi totalin e personave të dëmtuar nga veprat penale.

Të dëmtuar gjithsej, në vitin 2023 janë evidentuar 17.021 persona; 4.981 (29,3%) janë gra dhe 12.040 (70,7%) janë burra.

Të dëmtuarit nga vepra penale kundër personit përbëjnë 38,4% të totalit të personave të dëmtuar. Në 2023 janë 6.543 të dëmtuar nga vepra penale kundër personit; 2.396 (36,6%) janë gra dhe 4.147 (63,4%) janë burra.


Tab 8.2 Të dëmtuar nga vepra penale kundër personit sipas gjinisë dhe qarqeve, 2023

Qarku	Gra	Burra	Gjithsej
Berat	68	150	218
Dibër	50	110	160
Durrës	401	578	979
Elbasan	166	280	446
Fier	163	239	402
Gjirokastrë	52	103	155
Korçë	166	320	486
Kukës	29	88	117
Lezhë	98	198	296
Shkodër	77	178	255
Tiranë	1.002	1.704	2.706
Vlorë	124	199	323
Shqipëria	2.396	4.147	6.543

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet nga INSTAT

Qarku i Gjirokastrës dhe Vlorës ka përqindjen më të ulët të personave të dëmtuar për vepra penale kundër personit ndaj totalit të personave të dëmtuar. Qarku i Korçës dhe Dibrës kanë përqindjen më të lartë.

Fig 8.1 Të dëmtuar nga vepra penale kundër personit dhe vepra të tjera penale në përqindje sipas qarqeve, 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet nga INSTAT

Të pandehur

Statistikat për të pandehurit paraqesin të dhëna për numrin e të pandehurve të regjistruar gjatë vitit referues sipas gjinisë dhe qarqeve. Në sistemin e drejtësisë, në këtë fazë të pandehurit janë persona të akuzuar.

Në 2023, janë regjistruar 13.963 persona të pandehur, 740 (5,3%) janë gra dhe 13.223 (94,7%) janë burra.

Tab 8.3 Të pandehur sipas qarqeve dhe gjinisë, 2023

Qarku	Gra	Burra	Gjithsej
Berat	14	442	456
Dibër	10	503	513
Durrës	69	1.899	1.968
Elbasan	75	1.598	1.673
Fier	74	998	1.072
Gjirokastrë	26	812	838
Korçë	73	852	925
Kukës	11	204	215
Lezhë	7	339	346
Shkodër	78	845	923
Tiranë	278	3.956	4.234
Vlorë	25	775	800
Shqipëria	740	13.223	13.963

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, llogaritjet nga INSTAT

Të burgosurit

Të dhënat për personat në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i referohen numrit gjithsej të personave të dënuar me burg dhe të paraburgosur, në burgje, qendrat e paraburgimit, institucionet e burgosjes së të miturve si edhe spitale të burgut, deri në 31 dhjetor të çdo viti.

Numri i të burgosurve gjithsej, në vitin 2023 është 5.169 të burgosur, 2.192 janë persona të dënuar me burg dhe 2.977 janë të paraburgosur, persona të cilët kanë marrë vendim arrest me burg. Qarku i Tiranës dhe Fierit ka numrin më të lartë të të burgosurve, përkatësisht 18,8% dhe 14,2% e të burgosurve gjithsej. Qarku i Kukësit dhe Gjirokastrës ka numrin më të ulët të të burgosurve, respektivisht 3,3% dhe 3,1% në totalin e të burgosurve.

Treguesi i të paraburgosurve shpreh numrin e përgjithshëm të personave të mbajtur në paraburgim që ende nuk janë dënuar, si përqindje ndaj numrit të përgjithshëm të personave të burgosur. Qarqet me përqindjen më të lartë të të paraburgosurve ndaj numrit gjithsej të të burgosurve janë Gjirokastra dhe Kukësi, respektivisht me 74,1% dhe 64,3% të paraburgosur. Ndërkohë ndër qarqet me përqindjen më të ulët, edhe këtë vit, renditen Tirana me 52,0% të paraburgosur dhe Fieri me 48,1% të paraburgosur.

Tab 8.4 Të dënuar me burg dhe të paraburgosur sipas qarqeve, 2023


Qarku	2022			
	Të dënuar	Të paraburgosur	Të burgosur gjithsej	Treguesi i të paraburgosurve
Berat	67	114	181	63.0%
Dibër	91	129	220	58.6%
Durrës	216	358	574	62.4%
Elbasan	166	250	416	60.1%
Fier	366	339	705	48.1%
Gjirokastrë	42	120	162	74.1%
Korçë	200	288	488	59.0%
Kukës	61	110	171	64.3%
Lezhë	142	187	329	56.8%
Shkodër	178	210	388	54.1%
Tiranë	467	506	973	52.0%
Vlorë	164	272	436	62.4%
Foreigners	32	94	126	74.6%
Shqipëria	2.192	2.977	5.169	57.6%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, llogaritjet nga INSTAT

Shënim: Qarku i referohet vendbanimit të të burgosurve

Popullata në burgje krahasuar me vitin e kaluar është rritur me 4,6%. Gjatë vitit 2023, në qarkun e Tiranës, Beratit, Gjirokastrës, Durrësit, Lezhës, Elbasanit dhe Vlorës numri i të burgosurve është rritur. Gjithë qarqet e tjera kanë normë negative të rritjes së të burgosurve në burgje. Qarku i Vlorës ka pasur nivelin më të lartë të rritjes së numrit të të burgosurve gjatë vitit 2023, me +21,4% krahasuar me vitin 2022. Nga ana tjetër, qarku me normën më të ulët të rritjes së numrit të të burgosurve ishte ai i Kukësit, me -22,3%, gjatë vitit 2023.

Fig 8.2 Norma e ndryshimit në përqindje të numrit të të burgosurve, 2023-2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, llogaritjet nga INSTAT

Burimi i të dhënave

Burim të dhënash për statistikën e krimeve dhe drejtësisë penale janë të dhënat administrative, me periodicitet vjetor. Të dhënat mbi autorët e veprave penale dhe personat e dëmtuar janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Të dhënat mbi numrin e të pandehurve janë siguruar nga Prokuroria e Përgjithshme. Të dhënat mbi numrin e të dënuarve me burg dhe të paraburgosur janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Përkufizime

Autorë: persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejojnë ndodhjen ose jo të një veprë penale, pra shkaktojnë pasojën e veprës penale. Bëhet fjalë për persona të dyshuar në kryerjen e një veprë penale.

Të rritur: Persona mbi 18 vjeç.

Të mitur: Persona mbi moshën 14 vjeç dhe nën moshën 18 vjeç.

Vepra penale: Shkelje e ligjit që ndiqet penalisht. Veprat ndahen në krime kundër personit dhe vepra të tjera penale.

Vepra penale kundër personit: kuptohen ato vepra (veprime ose mosveprime) të kundërligjshme, të kryera me dashje ose nga pakujdesia, të cilat prekin ose vënë në rrezik jetën, shëndetin, liritë, paprekshmërinë seksuale, nderin e dinjitetin e personit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal. Përfshihen nenet 76-133 të Kodit Penal.

I pandehur: konsiderohet personi të cilit i është atribuar vepra penale përmes aktit të njoftimit të akuzës, i cili përmban dëshmi të mjaftueshme për marrjen e personit si i pandehur.

Norma e të pandehurve: paraqet numrin e personave të akuzuar të moshës 14+ shprehur për 10 mijë banorë të moshës 14+.

I paraburgosur: përfshihen personat, shtetas shqiptar, të huaj apo pa shtetësi, ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi "arrest në burg".

I dënuar me burg: çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale.

Numri i të burgosurve: tregon numrin e personave të mbajtur në ambjentet e burgjeve, institucione të tjera, institucionet e burgosjes së të miturve, spitalet psikiatrike ose spitale të tjera. Përfshijnë si të dënuarit me burg dhe të paraburgosurit.

I dëmtuar: personi të cilit çfarëdo e drejtë personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar si pasojë e një veprë penale.

I dëmtuar nga vepra penale kundër personit: konsiderohet personi të ciit i janë prekur ose rrezikuar të drejta që vënë në rrezik jetën, shëndetin, liritë, paprekshmërinë seksuale, nderin e dinjitetin e personit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal.



STATISTIKAT E BIZNESIT

9



Hyrje

Ky kapitull jep një informacion mbi regjistrat e biznesit. Të dhënat përshkruajnë ecurinë e njësive ligjore, fermerëve, ndërmarrjeve dhe karakteristikat kryesore të tyre përgjatë dy viteve të fundit. Regjistrat e biznesit janë shtylla kryesore e prodhimit të statistikave ekonomike.

Regjistrat e biznesit prej vitit 2015 përmbajnë edhe fermerët e pajisur me numër identifikimi të personit të tatueshëm, NIPT.

Gjetje

- 226.778 është numri i njësive ligjore aktive në fund të vitit 2023, nga 209.591 në vitin 2022;
- 96.440 janë fermerë të pajisur me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm NIPT, krahasuar me 84.369 fermerë të regjistruar deri në fund të vitit 2022;
- 26.319 njësi ligjore aktive janë regjistruar gjatë vitit 2023, krahasuar me 37.491 gjatë 2022;
- 130.338 janë ndërmarrje ekonomike aktive (përfshirë fermerët). Në fund të vitit 2022 numërohen 125.222 ndërmarrje aktive.

Tab 9.1 Njësitë ligjore, fermerët dhe ndërmarrjet sipas qarqeve, viti 2023

Qarku	Gjithsej	Njësi ligjore nga të cilat:	
		Ndërmarrje	Fermerë
Berat	15.245	4.044	11.201
Dibër	5.400	2.221	3.179
Durrës	15.783	13.441	2.342
Elbasan	19.852	7.728	12.124
Fier	35.794	9.684	26.110
Gjirokastrë	6.463	2.543	3.920
Korçë	23.274	6.240	17.034
Kukës	2.891	1.408	1.483
Lezhë	6.499	4.432	2.067
Shkodër	13.692	6.483	7.209
Tiranë	65.563	61.602	3.961
Vlorë	16.322	10.512	5.810
Shqipëria	226.778	130.338	96.440


Burimi: INSTAT, Regjistrat e Biznesit, viti 2023

Struktura e bizneseve sipas aktivitetit ekonomik

Bizneset shqiptare (përfshirë fermerët) janë fokusuar kryesisht në aktivitetin tregtar dhe shërbime të tjera. Ndërmarrjet në grupin “Prodhues të të mirave” (Bujqësia, pyjet dhe peshkimi, Industria dhe Ndërtimi) numërojnë 13,8 % të totalit të ekonomisë, ku sektori i industrisë ka ndikimin më të madh me 7,4% të numrit të ndërmarrjeve aktive.

Në grupin “Prodhues të shërbimeve” operojnë 86,2% e ndërmarrjeve aktive. Në këtë grup ndërmarrjesh, rolin kryesor e luan tregtia me 34,0 % të ndërmarrjeve aktive. Të punësuarit gjithsej në tregti zënë 19,1% të numrit të të punësuarve gjithsej.

Fig 9.1 Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik, viti 2022-2023



Burimi: INSTAT, Regjistrat e Biznesit, viti 2022-2023

Në qarqet Tiranë, Durrës e Vlorë janë përqendruar rreth 65,6% e ndërmarrjeve. Numri më i madh i ndërmarrjeve shënohet në qarkun e Tiranës me 61.602 ndërmarrje, ndërsa numri më i vogël në qarkun e Kukësit me 1.408 ndërmarrje.

Mbizotërimi i grupit të prodhuesve të shërbimeve është dukuri në të gjitha qarqet. Në qarqet Tiranë dhe Durrës janë përqendruar 58,2% e grupit të prodhuesve të shërbimeve.

Tab 9.2 Ndërmarrjet aktive sipas veprimtarisë ekonomike dhe qarqeve, 2022-2023

Qarku	Gjithsej Shqipëria		Prodhuesit e të mirave							
			Gjithsej Prodhuesit e të mirave		Bujqësia, pyjet, peshkimi		Industria		Ndërtimi	
	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023
Berat	4.044	17	629	13	54	6	455	-5	120	12
Dibër	2.221	14	452	27	44	5	305	9	103	13
Durrës	13.441	720	2.344	167	178	-12	1.339	78	827	101
Elbasan	7.728	55	1.209	77	91	-11	794	36	324	52
Fier	9.684	120	1.499	78	239	24	860	15	400	39
Gjirokastrë	2.543	28	382	-6	46	3	254	-9	82	-
Korçë	6.240	73	847	23	99	1	516	-7	232	29
Kukës	1.408	66	207	11	16	-3	127	5	64	9
Lezhë	4.432	151	730	68	91	6	347	24	292	38
Shkodër	6.483	168	849	28	90	1	514	18	245	9
Tiranë	61.602	2.774	7.293	481	217	-6	3.497	168	3.579	319
Vlorë	10.512	930	1.591	123	240	6	664	18	687	99
Shqipëria	130.338	5.116	18.032	1.090	1.405	20	9.672	350	6.955	720

Tab 9.2 Ndërmarrjet aktive sipas veprimtarisë ekonomike dhe qarqeve, 2022-2023 (vazhdim)

Qarku	Gjithsej Shqipëria		Prodhuesit e shërbimeve											
			Gjithsej Prodhuesit e shërbimeve		Tregtia		Transporti dhe magazinimi		Akomodimi dhe shërbimi ushqimor		Informacioni dhe komunikacioni		Shërbime të tjera	
	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023
Berat	4.044	17	3.415	4	1.693	-19	210	-8	701	-3	60	-1	751	35
Dibër	2.221	14	1.769	-13	843	-13	108	-6	348	-13	34	-	436	19
Durrës	13.441	720	11.097	553	4.927	114	780	42	1.632	58	337	50	3.421	289
Elbasan	7.728	55	6.519	-22	2.886	-35	495	15	1.317	-46	173	22	1.648	22
Fier	9.684	120	8.185	42	4.243	-19	475	15	1.392	-61	170	34	1.905	73
Gjirokastrë	2.543	28	2.161	34	900	-5	176	1	498	24	44	2	543	12
Korçë	6.240	73	5.393	50	2.470	-14	460	20	1.061	-27	122	12	1.280	59
Kukës	1.408	66	1.201	55	466	18	104	14	279	15	26	1	326	7
Lezhë	4.432	151	3.702	83	1.612	-10	204	7	807	15	64	2	1.015	69
Shkodër	6.483	168	5.634	140	2.511	21	216	2	1.149	41	198	11	1.560	65
Tiranë	61.602	2.774	54.309	2.293	18.554	240	2.605	216	6.186	93	3.964	356	23.000	1.388
Vlorë	10.512	930	8.921	807	3.162	104	567	36	2.592	414	186	17	2.414	236
Shqipëria	130.338	5.116	112.306	4.026	44.267	382	6.400	354	17.962	510	5.378	506	38.299	2.274

Burimi: INSTAT, Regjistrat e Biznesit, viti 2022-2023

Forma ligjore

Bizneset në Shqipëri janë organizuar kryesisht si “Persona Fizikë”, ku gjatë vitit 2023 numërohen 74,1% të totalit të ndërmarrjeve (përfshijtur fermerët). Personat juridikë edhe pse pak në numër, japin kontributin kryesor në ekonominë e vendit.

Tab 9.3 Ndërmarrjet aktive sipas formës ligjore dhe qarqeve, viti 2022-2023

Qarku	Gjithsej		Persona Fizikë		Persona Juridikë	
	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023
Berat	4.044	17	3.365	11	679	6
Dibër	2.221	14	1.633	27	588	-13
Durrës	13.441	720	9.852	541	3.589	179
Elbasan	7.728	55	6.389	32	1.339	23
Fier	9.684	120	7.906	55	1.778	65
Gjirokastrë	2.543	28	1.953	23	590	5
Korçë	6.240	73	5.199	80	1.041	-7
Kukës	1.408	66	970	53	438	13
Lezhë	4.432	151	3.526	120	906	31
Shkodër	6.483	168	5.009	125	1.474	43
Tiranë	61.602	2.774	42.442	1.795	19.160	979
Vlorë	10.512	930	8.278	763	2.234	167
Shqipëria	130.338	5.116	96.522	3.625	33.816	1.491


Burimi: INSTAT, Regjistrat e Biznesit, viti 2022-2023

Gratë në ekonomi

Gratë menaxhojnë/zotërojnë 31,2% të ndërmarrjeve aktive gjithsej. Qarku i Tiranës ka përqindjen më të lartë të ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë, përkatësisht me 33,5%.

Aktivitetet “Tregti” dhe “Shërbime të tjera” shënon pjesëmarrjen më të lartë të grave në vendimmarrje, respektivisht me 33,9% dhe 40,5%. Ndërmarrjet e drejtuara nga gratë janë kryesisht ndërmarrje me 1- 4 të punësuar.

Fig 9.2 Ndërmarrjet aktive sipas gjinisë të pronarit/administratorit dhe qarqeve, 2023



Burimi: INSTAT, Regjistrat e Biznesit, viti 2023

Tab 9.4 Ndërmarrjet aktive sipas gjinisë së pronarit/administratorit dhe qarqeve, 2022-2023

Qarku	Gjithsej		Pronarë / CEO				
			Burra		Gra		Gra
	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	
Berat	4.044	17	2.805	2	1.239	15	1,0
Dibër	2.221	14	1.678	3	543	11	0,4
Durrës	13.441	720	9.645	527	3.796	193	2,9
Elbasan	7.728	55	5.520	76	2.208	-21	1,7
Fier	9.684	120	6.885	131	2.799	-11	2,1
Gjirokastrë	2.543	28	1.792	10	751	18	0,6
Korçë	6.240	73	4.433	82	1.807	-9	1,4
Kukës	1.408	66	1.110	51	298	15	0,2
Lezhë	4.432	151	3.061	113	1.371	38	1,1
Shkodër	6.483	168	4.633	101	1.850	67	1,4
Tiranë	61.602	2.774	40.950	1.855	20.652	919	15,8
Vlorë	10.512	930	7.221	634	3.291	296	2,5
Shqipëria	130.338	5.116	89.733	3.585	40.605	1.531	31,2

Burimi: INSTAT, Regjistrat e Biznesit, viti 2022-2023

Madhësia e ndërmarrjeve

Rreth 85,9% e ndërmarrjeve janë ndërmarrje të vogla me 1-4 të punësuar. Këto ndërmarrje luajnë një rol vendimtar në ekonomi duke krijuar vende pune, dhe duke kontribuar në zhvillimin rajonal në nivel qarku apo bashkie. Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar përfaqësojnë 1,6% të totalit të ndërmarrjeve.

Tab 9.5 Ndërmarrjet aktive sipas madhësisë dhe qarqeve, 2022-2023

Qarku	Gjithsej		Të punësuar 1-4		Të punësuar 5-9		Të punësuar 10-49		Të punësuar 50+	
	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023
Berat	4.044	17	3.599	-5	215	24	186	5	44	-7
Dibër	2.221	14	1.877	15	146	7	155	-12	43	4
Durrës	13.441	720	11.329	614	1.038	74	849	40	225	-8
Elbasan	7.728	55	6.856	51	421	7	361	0	90	-3
Fier	9.684	120	8.628	113	496	-7	424	17	136	-3
Gjirokastrë	2.543	28	2.213	47	131	-12	147	-8	52	1
Korçë	6.240	73	5.486	84	372	-9	305	-7	77	5
Kukës	1.408	66	1.165	58	111	4	109	6	23	-2
Lezhë	4.432	151	3.894	139	282	11	207	-	49	1
Shkodër	6.483	168	5.626	169	419	5	350	4	88	-10
Tiranë	61.602	2.774	51.863	2.585	4.807	28	3.789	126	1.143	35
Vlorë	10.512	930	9.402	845	597	73	436	20	77	-8
Shqipëria	130.338	5.116	111.938	4.715	9.035	205	7.318	191	2.047	5

Burimi: INSTAT, Regjistrat e Biznesit, viti 2022-2023

Pronësia

Ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë të huaj zënë 5,3% të ndërmarrjeve gjithsej, shifër kjo e njëjtë me vitin 2022.

Ndërmarrjet nga vendet Bashkimit Evropian përfaqësojnë 63,1% të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta. Pronarët apo bashkëpronarët me origjinë italiane dhe greke përfaqësojnë 48,4% të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta gjithsej. Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta janë përqendruar kryesisht në bashkitë Tiranë, Durrës, Vlorë.

Tab 9.6 Ndërmarrjet aktive sipas pronësisë dhe qarqeve, 2022-2023

Qarku	Gjithsej		Shqiptare		Të huaja e të përbashkëta	
	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023	2023	Ndryshimi 2022-2023
Berat	4.044	17	4.012	22	32	-5
Dibër	2.221	14	2.206	15	15	-1
Durrës	13.441	720	12.590	626	851	94
Elbasan	7.728	55	7.609	39	119	16
Fier	9.684	120	9.492	98	192	22
Gjirokastrë	2.543	28	2.486	29	57	-1
Korçë	6.240	73	6.141	77	99	-4
Kukës	1.408	66	1.372	64	36	2
Lezhë	4.432	151	4.276	119	156	32
Shkodër	6.483	168	6.342	164	141	4
Tiranë	61.602	2.774	56.802	2.635	4.800	139
Vlorë	10.512	930	10.072	879	440	51
Shqipëria	130.338	5.116	123.400	4.767	6.938	349

Burimi: INSTAT, Regjistrat e Biznesit, viti 2022-2023

Xhiro vjetore

Ekonomia shqiptare është e fokusuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve dhe ndërmarrjet në qarkun Tiranë kontribuojnë me 62,7% të xhiros vjetore në këtë grup. Qarqet Tiranë dhe Durrës kanë kontributin më të madh në xhiron vjetore, me 75,5% të xhiros gjithsej. Ndërmarrjet e vendosura në Tiranë japin kontributin kryesor në çdo madhësi, me më shumë se 47 % të xhiros vjetore.

Tab 9.7 Xhiro vjetore e ndermarrjeve sipas aktivitetit ekonomik dhe qarqeve (në %), 2023

Qarku	GjithsejSh-qipëria %	Prodhuesit e të mirave%				Prodhuesit e shërbimeve %					
		Gjithsej Prodhuesit e të mirave	Bujqësia, pyjet,pe-shkimi	Industria	Ndërtimi	Gjithsej Prodhuesit e shërbimeve	Tregtia	Transporti dhe magazinimi	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Shërbime të tjera
Berat	1,5	1,4	5,5	1,6	1,3	1,6	1,5	1,0	1,5	0,3	2,4
Dibër	1,2	1,5	0,6	1,9	1,0	1,1	1,1	0,5	0,8	0,2	1,6
Durrës	12,0	9,1	20,3	11,6	6,1	13,4	17,2	23,8	10,7	1,7	7,2
Elbasan	3,1	4,4	3,0	5,7	3,0	2,5	2,9	1,8	3,0	0,6	2,4
Fier	5,5	6,8	22,1	7,7	5,3	4,8	6,6	3,0	3,2	0,8	2,6
Gjirokastrë	2,1	1,1	1,1	1,1	1,1	2,7	3,6	1,2	1,3	0,2	2,0
Korçë	2,0	1,7	2,8	2,4	0,9	2,1	2,8	1,4	3,7	0,6	1,0
Kukës	0,7	0,4	0,2	0,5	0,5	0,9	0,8	0,7	0,7	0,1	1,6
Lezhë	1,8	1,6	3,2	1,5	2,2	1,9	1,9	1,5	4,9	0,3	2,2
Shkodër	2,4	2,5	9,4	2,6	2,2	2,4	2,6	1,4	4,6	1,3	2,2
Tiranë	63,6	65,3	19,1	61,5	69,5	62,7	55,2	60,4	48,8	93,1	71,2
Vlorë	4,0	4,0	12,9	1,9	6,7	3,9	3,8	3,3	16,8	1,0	3,6
Shqipëria	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: INSTAT, Regjistrat e Biznesit, viti 2023

Tab 9.8 Xhiro vjetore e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe qarqeve (në %), 2023

Qarku	Gjithsej	Të punësuar 1-4	Të punësuar 5-9	Të punësuar 10-49	Të punësuar 50+
Berat	1,5	2,1	2,2	1,9	0,9
Dibër	1,2	1,7	2,6	1,1	0,8
Durrës	12,0	9,5	13,2	12,1	12,6
Elbasan	3,1	4,2	8,1	4,1	1,3
Fier	5,5	5,7	7,0	5,6	5,1
Gjirokastrë	2,1	1,4	1,8	1,6	2,8
Korçë	2,0	3,3	3,5	2,5	0,9
Kukës	0,7	0,7	0,8	1,0	0,6
Lezhë	1,8	2,3	2,2	2,3	1,3
Shkodër	2,4	3,6	3,6	2,9	1,5
Tiranë	63,6	58,2	47,0	60,9	70,2
Vlorë	4,0	7,1	8,1	4,1	1,9
Shqipëria	100	100	100	100	100

Burimi: INSTAT, Regjistrat e Biznesit, viti 2023

Metodologjia

Regjistrat e biznesit përmbajnë të gjitha njësitë ligjore, ndërmarrjet dhe të gjitha njësitë lokale, aktivitetet ekonomike të të cilave kontribuojnë në Prodhimin e Brendshëm Bruto (P.B.B).

Burimi i të dhënave

Regjistrat e biznesit mirëmbahen dhe përditësohen me burime administrative dhe statistikore.

Burimet administrative

- Informacioni nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);
- Informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT);
- Skedari i TVSH-së;
- Llogaritë vjetore të ndërmarrjeve.

Burime statistikore(vrojtimet pranë ndërmarrjeve):

- Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, ASN;
- Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve, ATN;
- Anketa Strukturat Akomoduese", ASA;
- Anketa të tjera.

Përkufizime

Njësia ligjore: Person juridik, ekzistenca e të cilit njihet nga ligji. pavarësisht nga individët apo institucionet që mund ta zotërojnë apo janë anëtarë në të.

Person Fizik: Personi që zotëron të drejtën për të kryer aktivitet ekonomik.

Ndërmarrja: Kombinimi më i vogël i njësive ligjore pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime që ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)".

Fermerët e regjistruar gjatë viteve të fundit janë pajisur me NIPT dhe i nënshtrohen skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të TVSH. Fermerët e regjistruar pranë zyrave tatimore zotërojnë personalitet juridik, e si të tillë janë objekt i regjistratit të njësive ligjore që INSTAT mirëmban dhe përditëson.

Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE): Klasifikim në nivel katërshifror i veprimtarive ekonomike të ushtruara në subjekte të ndryshme. Kjo nomenklaturë është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 320, datë 28.5.2014.


Madhësia e ndërmarrjes përcaktohet nga numri i të punësuarve:

- Ndërmarrjet me 1-4 të punësuar klasifikohen si ndërmarrje shumë të vogla;
- Ndërmarrjet me 5-9 të punësuar klasifikohen si ndërmarrje të vogla;
- Ndërmarrjet me 10-49 të punësuar klasifikohen si ndërmarrje të mesme;
- Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar klasifikohen si ndërmarrje të mëdha.

Të punësuar: përfshijnë të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjestarët e familjes të papaguar.

Shitjet neto: Shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës referuese dhe i korrespondojnë shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tretëve.





BUJQËSIA

10

Hyrje

Bujqësia është një ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë në Shqipëri. Produktet bujqësore janë pjesë e formimit të identitetit rajonal të vendit, me një gamë të gjerë të ndryshimeve mjedisore, natyrore dhe klimatike.

Shqipëria megjithëse në shtrirje jo të madhe gjeografike karakterizohet nga një larmishmëri klimash në rajonet e saj, duke bërë që kushtet e pafavorshme të motit në një rajon për kultivimin e kulturave të ndryshme, shpesh kompensohet nga kushtet optimale në një rajon tjetër. Gjithashtu, nga viti në vit, vërehet një rritje e konsiderueshme e prodhimit bujqësor në serra, duke bërë që nevojat e tregut të brendshëm dhe të jashtëm, (kryesisht perime), të mbulohen në të gjithë vitin pavarësisht kushteve klimaterike.

Informacioni statistikor, në lidhje me statistikën e prodhimit bimor, bazohet në të dhënat e mbledhura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nga vrojtimit, të dhënat administrative dhe vlerësimet e ekspertëve.

Drithërat kryesore të kultivuara në vendin tonë janë gruri, misri, elbi, thekra dhe tagjitë. Një peshë të konsiderueshme në prodhimin e bimëve të arave zënë gjithashtu dhe perimet, patatet dhe fasulet. Grupet kryesore të drufrutorëve të kultivuara në vendin tonë janë pemët frutore (molla, dardha, pjeshka, kumbulla, qershia, aroret, etj), ulliri, agrumet dhe rrushi.

Bimët e arave


Në vitin 2023, sipërfaqja e mbjellë me bimë të arave ishte 415,0 mijë ha, e cila krahasuar me vitin 2022 është ulur me 0,4%. Ritmi i rritjes që tregon sipërfaqen e mbjellë në përqindje për vitin 2023 krahasuar me vitin 2018, është 1,3% më pak në rang vendi. Qarqet me përqindjen më të lartë të sipërfaqes së mbjellë, për vitin 2023, janë Fieri me 20,7%, pasuar nga Korça me 11,2% dhe Elbasani me 11,1%. Qarqet me përqindjen më të ulët të sipërfaqes së mbjellë të bimëve të arave janë Gjirokastra me 4,6% dhe Kukësi me 2,8%.

Tab 10.1 Sipërfaqja e mbjellë me bimë të arave sipas qarqeve, 2023

Qarku	Sipërfaqja e mbjellë (000 ha)	Sipërfaqja e mbjellë (në %)	Ritmi i rritjes 2023/2018 (në %)
Berat	24,3	5,9	-8,1
Dibër	38,7	9,3	29,5
Durrës	29,8	7,2	-4,4
Elbasan	46,0	11,1	-7,7
Fier	85,9	20,7	-5,3
Gjirokastrë	18,9	4,6	-2,5
Korçë	46,5	11,2	-1,2
Kukës	11,7	2,8	-2,5
Lezhë	24,4	5,9	-0,9
Shkodër	33,2	8,0	-11,2
Tiranë	35,7	8,6	-1,8
Vlorë	20,0	4,8	28,2
Shqipëria	415,0	100	(1,3)

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të dhëna administrative

Harta 10.1. Sipërfaqja e mbjellë në tokë arë sipas bashkive, 2023



Drithërat kryesore të kultivuara janë gruri, misri, elbi, thekra dhe tagjitë dhe prodhimi i tyre në vitin 2023 arriti në 701,3 mijë tonë. Drithërat përdoren kryesisht për konsum njerëzor dhe ushqim për kafshët, por ato mund të përdoren gjithashtu, për prodhimin e pijeve dhe produkteve industriale.

Qarqet me nivelin më të lartë të prodhimit të drithërave janë qarku i Fierit me 176,6 mijë tonë, pasuar nga qarku i Elbasanit me 95,6 mijë tonë dhe qarku i Korçës me 83,9 mijë tonë. Qarqet me nivelin më të ulët të prodhimit të drithërave janë Kukësi me 12,9 mijë tonë dhe Gjirokastra me 17,6 mijë tonë.

Tab 10.2 Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave sipas qarqeve, 2023


Drithërat		Shqipëria	Qarku											
Destinacionet më të preferuara për udhëtime për qëllime personale apo biznesi në Shqipëri, për vitin 2023, janë qarqet: Tiranë (23,2 %), Vlorë (18,5 %), Korçë (15,0%) dhe Durrës (12,4 %).

Fig 12.4 Shpërndarja e udhëtimeve brenda vendit sipas destinacioneve, viti 2023 (në %)



Burimi: INSTAT, Anketa Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime"

Në tabelën 12.1 tregohet se për vitin 2023, përqindjet më të larta të udhëtimeve për "pushime dhe kohë të lirë" kanë si destinacion Vlorën me 32,5 %, Korçën 20,7 % dhe Durrësin 16,3 %.


Tab 12.1 Shpërndarja e udhëtimeve në Shqipëri sipas qëllimit dhe destinacionit, viti 2023 (në %)

Qarku	Pushime dhe kohë e lirë	Vizita te të afërm dhe miq	Tjetër	Biznes
Berat	1,8	5,1	-	-
Dibër	3,8	8,3	0,7	0,7
Durrës	16,3	9,3	4,4	2,0
Elbasan	0,5	6,8	2,1	1,6
Fier	0,7	4,6	1,1	8,8
Gjirokastër	1,7	2,1	0,1	8,5
Korçë	20,7	9,8	7,0	6,6
Kukës	1,7	4,6	1,2	-
Lezhë	4,4	7,4	2,1	-
Shkodër	5,2	6,1	0,8	21,3
Tiranë	11,0	31,5	72,9	38,7
Vlorë	32,5	4,3	7,6	12,0

Burimi: INSTAT, Anketa Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime"

Nëse do të analizojmë udhëtimet e kryera brenda qarqeve sipas qëllimit të tyre vërejmë se në qarqet Elbasan, Fier dhe Berat përgjithësisht prevalojnë udhëtimet të kryera për “vizita te të afërm dhe miq”.

Fig 12.5 Shpërndarja e udhëtimeve sipas qëllimit në qarqe, viti 2023 (në %)



Burimi: INSTAT, Anketa Turizmit në Familje “Pushime dhe Udhëtime”

Në tremujorin e tretë, të katërt, të dytë dhe të parë është shënuar përqindja më e lartë në ato udhëtime që kanë si origjinë qarkun e Tiranës përkatësisht 44,2 %, 41,9 %, 37,8 % dhe 37,4%.


Tab 12.2 Shpërndarja e udhëtimeve në Shqipëri sipas tremujorit, viti 2023 (në %)

Qarku	Tremujori			
	I parë	I dytë	I tretë	I katërt
Berat	3,8	3,3	6,5	3,1
Dibër	3,5	7,5	5,8	3,3
Durrës	7,3	5,8	6,6	4,2
Elbasan	8,3	3,6	5,0	5,5
Fier	7,9	14,6	4,1	8,8
Gjirokastrë	1,0	1,9	1,2	2,8
Korçë	3,7	5,3	7,0	7,6
Kukës	2,8	3,0	3,7	6,4
Lezhë	8,5	7,2	4,8	6,2
Shkodër	9,0	5,5	4,9	3,3
Tiranë	37,4	37,8	44,2	41,9
Vlorë	6,8	4,3	6,1	6,9

Burimi: INSTAT, Anketa Turizmit në Familje “Pushime dhe Udhëtime”

Pjesa më e madhe e udhëtimeve si brenda dhe jashtë vendit kanë si vend origjinë qarkun e Tiranës, nga të cilët 48,6 % janë udhëtime jashtë Shqipërisë dhe 40,7 % janë udhëtime brenda saj.

Fig 12.6 Shpërndarja udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë sipas vendit të origjinës, viti 2023, në %.



Burimi: INSTAT, Anketa Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime"

Burimi i të dhënave

Të dhënat mbi statistikat e turizmit sigurohen nga burime administrative dhe nga vrojtime.

Ana e Ofertës:

- Anketa e Strukturave Akomoduese që INSTAT zhvillon, mbledh të dhëna periodike mujore mbi treguesit e kapacitetit dhe shfrytëzimit të strukturave akomoduese në të gjithë Shqipërinë.
- Lëvizja e shtetasve në Shqipëri, të dhëna administrative që sigurohen nga Ministria e Punëve të Jashtme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë).
- Regjistri statistikor i ndërmarrjeve, INSTAT

Ana e Kërkesës:

- Anketa Turizmit në Familje “Pushime dhe Udhëtime” u krye nga INSTAT përgjatë gjithë vitit dhe ka objekt të gjithë individët me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri mbi 15 vjeç. Anketa mbledh të dhëna mbi udhëtimet me të paktën një natë fjetjeje për pushime, udhëtime pune dhe udhëtime të tjera, si brenda dhe jashtë vendit, gjithashtu edhe ato brenda ditës brenda/ jashtë vendit të ndarë në katër tremujorë.

Përkufizime:

Shtrat: përcaktohet nga numri i personave që mund të qëndrojnë gjatë natës në një shtrat, duke përjashtuar shtretërit shtesë të vendosur sipas kërkesës së vizitorit.

Dhomë: në një strukturë akomodimi apo banesë, është njësia e përbërë nga një dhomë ose grupe dhomash të cilat janë të marra me qira nga vizitorët (turistët) si një e tërë (qira e pandashme)

Turizëm i brendshëm: aktivitetet e një vizitori rezident brenda vendit (bashki ose qark).

Turizëm i jashtëm: aktivitetet e një vizitori rezident jashtë vendit të referencës.

Destinacioni kryesor i udhëtimit: në rastin e një udhëtimi jashtë vendit, individit deklaron se ku ka qëndruar. Në qoftë se udhëtari nuk është në gjendje për të vendosur, udhëtari do vendosë si destinacionin kryesor vendin ku ai ka shpenzuar kohën më të madhe të netëve të qëndrimit; në qoftë se ka shumë vende me numër të njëjtë të qëndrimeve me fjetje atëherë do vendoset destinacioni më i largët apo vendi ku i udhëtari ka shpenzuar më shumë para.

Netë qëndrim: çdo natë që një vizitor / turist (rezident ose jo-rezident) aktualisht shpenzon (fle apo qëndron) në një njësi akomodimi.

Jo-rezident: konsiderohet ai person që nuk ka banuar në Shqipëri për më shumë se 12 muaj radhazi.

Rajonet statistikore në nivelin 1, 2 dhe 3 përcaktohen sipas ndarjes territoriale NUTS II, tre Makro Rajone të Shqipërisë, të përcaktuara sipas ndarjes territoriale NUTS të EUROSTAT dhe grupimit të prefekturave të ndryshme (shih kapitullin II, Struktura Administrative dhe Njësitë Territoriale të Shqipërisë).

Norma e shfrytëzimit të shtretërve: mat përqindjen e shfrytëzimit të shtretërve për “Hotelet dhe akomodime të ngjashme”.

Rezident: konsiderohet ai person që ka banuar në Shqipëri për më shumë se 12 muaj radhazi

Turizmi: veprimtaria e vizitorëve duke ndërmarrë një udhëtim për një destinacion kryesor jashtë vend-banimit të zakonshëm ku jeton, për më pak se një vit, për çfarëdo qëllimi kryesor, duke përfshirë biznesin, kohën e lirë apo qëllime tjera personale. Personi vizitor nuk duhet të jetë i punësuar nga një subjekti rezident në vendin e vizituar.

Vizitor: klasifikohet një turist (ose vizitori për një ose më shumë netë), në qoftë se udhëtimi i tij / saj përfshin një qëndrim me fjetje.

Udhëtar: individ i cili lëviz në vendeve të ndryshme gjeografike për çdo qëllim dhe kohëzgjatje.

Udhëtimi: i referohet veprimtarisë së udhëtarëve.



TRANSPORTI

13



Statistikat e transportit mbështeten në të dhëna administrative dhe mbulojnë transportin detar, transportin ajror, transportin hekurudhor dhe transportin rrugor të përfaqësuar me numrin e mjeteve për pasagjerë, mallra si dhe statistikat mbi aksidentet rrugore.

Statistikat rajonale të transportit kanë si qëllim të përcaktojnë flukset e udhëtarëve dhe të mallrave si brenda rajoneve ashtu edhe ndërmjet tyre. Këto lëvizje shpesh janë të lidhura ngushtë me aktivitetet ekonomike të këtyre rajoneve.

Gjatë periudhës 2019-2023, vihet re një rritje prej 39,6 % të numrit të mjeteve rrugore për pasagjerë në vendin tonë. Në vitin 2023, qarku i Tiranës zë 34,8 % të mjeteve rrugore gjithsej për pasagjerë. Gjatë periudhës 2019-2023, qarku i Durrësit paraqitet me rritjen më të lartë në vend duke u rritur me 62,1 %, i pasuar nga qarku i Kukësit me 55,9 %, ndërsa qarku i Tiranës ka shënuar rritjen më të ulët me 29,9 % i pasuar nga qarku i Shkodrës me 35,5 %.

Në tabelën 13.1 paraqiten mjetet rrugore për pasagjerë për vitin 2019 dhe 2023 në vlerë absolute.

Tab 13.1 Mjetet rrugore për pasagjerë në numër absolut sipas qarqeve, 2019-2023

Qarku	Numri i mjeteve rrugore për pasagjerë		
	2019	2023	Ndryshimi (%) 2019-2023
Berat	18.516	26.316	42,1
Dibër	13.813	20.975	51,8
Durrës	60.108	97.419	62,1
Elbasan	33.174	48.766	47,0
Fier	46.613	63.949	37,2
Gjirokastrë	11.314	15.353	35,7
Korçë	24.901	35.207	41,4
Kukës	11.421	17.804	55,9
Lezhë	25.328	36.113	42,6
Shkodër	36.761	49.829	35,5
Tiranë	189.589	246.255	29,9
Vlorë	35.734	49.913	39,7
Shqipëria	507.272	707.899	39,6

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Ilogaritje INSTAT

Mjetet e transportit rrugor për mallra përfshijnë kategoritë e mjeteve të cilat përdoren vetëm për transportin e mallrave si kamionë, rimorkio, mjete teknologjike dhe mjetet bujqësore. Në periudhën 2019-2023, vihet re një tendencë rritje e numrit të mjeteve rrugore për mallra.

Mjetet e transportit rrugor për mallra ashtu si dhe mjetet e transportit rrugor për pasagjerë kanë një shpërndarje në të 12 qarqet e vendit. Në vitin 2023, qarku i Tiranës zë 33,7 % të mjeteve rrugore gjithsej për mallra. Gjatë periudhës 2019-2023, vihet re një rritje prej 72,4 % të numrit të mjeteve rrugore për mallra, ku qarku i Shkodrës paraqitet me rritjen më të lartë në vend duke u rritur me 128,9 %, i pasuar nga qarku i Tiranës me 90,0 %, qarku i Lezhës me 82,2 % dhe qarku i Vlorës me 67,7 %.

Tab 13.2 Mjetet rrugore për mallra në numër absolut sipas qarqeve, 2019-2023

Qarku	Numri i mjeteve rrugore për mallra		
	2019	2023	Ndryshimi (%) 2019-2023
Berat	1.245	1.944	56,1
Dibër	910	1.446	58,9
Durrës	3.955	6.590	66,6
Elbasan	2.066	3.063	48,3
Fier	3.018	4.390	45,5
Gjirokastrë	941	1.340	42,4
Korçë	1.975	3.292	66,7
Kukës	789	1.171	48,4
Lezhë	1.326	2.416	82,2
Shkodër	1.568	3.589	128,9
Tiranë	8.525	16.200	90,0
Vlorë	1.584	2.657	67,7
Shqipëria	27.902	48.098	72,4

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT

Mjetet rrugore për transport të përzier përfshijnë kategoritë e mjeteve si: motomjetet, automjete për transport të përzier dhe automjete për transport të veçantë, autokampet si dhe mjetet të cilat përdoren për transportin e pasagjerëve dhe mallrave si dhe mekanizmave të ndryshëm. Në periudhën 2019-2023, vihet re një tendencë rritje e numrit të mjeteve rrugore për transport të përzier, në një shkallë më të ulët se dy kategoritë e tjera.

Mjetet e transportit rrugor për transport të përzier kanë një shpërndarje në të 12 qarqet e vendit. Në vitin 2023, qarku i Tiranës zë 34,5 % të mjeteve rrugore gjithsej për transport të përzier. Gjatë periudhës 2019-2023, vihet re një rritje prej 19,2 % e numrit të mjeteve rrugore për transport të përzier, ku qarku i Durrësit paraqitet me rritjen më të lartë në vend duke u rritur me 47,5 %, i pasuar nga qarku i Kukësit me 36,3 %, ndërsa qarku i Shkodrës me rritjen më të ulët me 7,1 % i pasuar nga qarku i Tiranës me 8,9 %.

Tab 13.3 Mjetet rrugore për transport të përzier në numër absolut sipas qarqeve, 2019-2023

Qarku	Numri i mjeteve rrugore për transport të përzier		
	2019	2023	Ndryshimi (%) 2019-2023
Berat	6.094	7.007	15,0
Dibër	1.457	1.941	33,2
Durrës	8.564	12.630	47,5
Elbasan	6.722	8.290	23,3
Fier	9.530	12.243	28,5
Gjirokastrë	1.899	2.298	21,0
Korçë	3.864	4.960	28,4
Kukës	986	1.344	36,3
Lezhë	3.685	4.500	22,1
Shkodër	7.903	8.464	7,1
Tiranë	35.388	38.543	8,9
Vlorë	7.671	9.548	24,5
Shqipëria	93.763	111.768	19,2


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje INSTAT

Aksidentet rrugore

Mundësitë për ndodhjen e aksidenteve rrugore mund të lidhen me një sërë faktorësh, si: numri i kilometrave të përshkruar, shtrirja dhe cilësia e infrastrukturës rrugore, kushtet klimaterike dhe gjeografike si dhe dendësia e popullsisë. Sjellja e drejtuesve të mjeteve mund të përbëjë shkak për mundësitë e ndodhjes së aksidenteve, si p.sh eksperiencia në drejtim, mungesa e përqendrimit, shpejtësia tej normave të lejuara, mosrespektim i rregullave të qarkullimit si dhe konsumi i pijeve alkoolike.

Nëse do t'i referohemi numrit absolut të aksidenteve rrugore gjatë viteve 2019-2023, qarku i Tiranës shënon numrin më të lartë të aksidenteve rrugore, më pas vjen qarku Durrës, Lezhë, ndërsa qarqet e Dibrës, Beratit dhe Shkodrës janë qarqet me numrin më të ulët të aksidenteve.

Fig 13.1 Ndryshimi në përqindje e numrit të aksidenteve rrugore sipas qarqeve, 2023/2019



Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Llogaritje INSTAT

Në tabelën 13.4 paraqitet numri i të aksidentuarve sipas 12 qarqeve të vendit në vlerë absolute për vitet 2019 dhe 2023.

Tab 13.4 Numri i të aksidentuarve sipas qarqeve në vlerë absolute për vitin 2019 dhe 2023

Qarku	Numri i të aksidentuarve nga aksidentet rrugore		
	2019	2023	Ndryshimi (%) 2019-2023
Berat	31	33	6,5
Dibër	25	43	72,0
Durrës	177	212	19,8
Elbasan	115	70	-39,1
Fier	207	116	-44,0
Gjirokastrë	103	109	5,8
Korçë	149	67	-55,0
Kukës	51	59	15,7
Lezhë	245	180	-26,5
Shkodër	49	45	-8,2
Tiranë	802	692	-13,7
Vlorë	90	105	16,7
Shqipëria	2044	1731	-15,3

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Llogaritje INSTAT

Burimi të dhënave

Të dhënat statistikore mbi transportin rrugor dhe aksidentet rrugore sipas qarqeve në vend grumbullohen nga burime administrative. Këto të dhëna janë të shprehura në njësi absolute. Insitucionet të cilat sigurojnë këto të dhëna janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Mjet rrugor: Mjet rrugor që lëviz me rrota dhe i cili është i destinuar për përdorim në rrugë.

Aksidente rrugore me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, duke rezultuar në të paktën një person të plagosur ose të vrarë.

Të aksidentuar: Çdo person i vrarë ose i plagosur si rezultat i një aksidenti rrugor.



MJEDISI

14



Hyrje

Analiza e situatës mjedisore përfshin të gjithë elementët kompleksë me ndikim global dhe faktorë të lidhur, përfshirë zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, presionin mbi kushtet e mjedisit etj. Analiza mjedisore bëhet e arritshme dhe e interpretueshme duke pasur në dispozicion tregues të matshëm fizikisht që lidhen qartë me situatën mjedisore dhe ndikimin e faktorëve përkatës.

Kuptimi i qartë i situatës mjedisore në një moment të caktuar bazohet në sintezën e treguesve statistikorë, midis të cilëve emetimet në ajër dhe ujë, mbetje, tokë dhe ekosisteme, pyje dhe struktura të tjera të përdorimit të tokës përbëjnë elementët kryesorë. Treguesit statistikorë për mjedisin kanë për qëllim të bëjnë të disponueshme për publikun informacionin mjedisor dhe të informojnë institucionet dhe individët për arritjen e qëllimeve për të përmirësuar situatën mjedisore.

Fokusi i Vjetarit Statistikor Rajonal 2023 është në statistikat e mbetjeve shtëpiake sepse të dhëna të tjera mjedisore nuk janë të disponueshme për rajonet në këtë moment kohor. Statistikat e mbetjeve janë një mjet kryesor për politikat mjedisore, për të matur dimensionin e mbetjeve të ekonomisë qarkore dhe për të monitoruar progresin drejt Synimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. INSTAT zhvillon dhe prodhon statistika të mbetjeve urbane që nga viti 2013.

Trajtimi i mbetjeve

Mbetjet e menaxhuara trajtohen kryesisht duke depozituar mbetjet në landfille dhe vende të tjera depozitimi të miratuara nga organet përkatëse të qeverisjes vendore. Në vitin 2023, struktura e trajtimit të mbetjeve ishte: 76,49 % të depozituara në landfille, 18,81 % të ricikluara, 0,12 % hedhje në mënyre jo të rregullt në natyrë, 4,55 % të djegur në inceneratorë (për prodhim të energjisë) dhe 0,03 % të djegur për eliminim.


Prefektura me pjesën më të madhe të mbetjeve të ricikluara ishte Lezha me 25,00 %, e ndjekur nga Vlora me 21,59 % dhe Kukësi me 21,2% të mbetjeve totale të ricikluara.

Tab 14.1 Trajtimi i mbetjeve në tonë sipas qarkut, 2023

Qarku	Djegje në inceneratore	Djegje për eliminim	Riciklim	Depozituar në landfille	Hedhur jashtë landfilli
Berat	-	2	5.123	30.573	-
Dibër	-	18	3.108	15.669	80
Durrës	-	-	18.808	73.714	-
Elbasan	38.414	116	7.563	28	20
Fier	-	-	8.080	39.636	-
Gjirokastrë	-	75	3.836	13.631	200
Korçë	-	23	8.769	33.761	-
Kukës	-	36	4.243	15.396	326
Lezhë	-	-	9.272	27.894	-
Shkodër	-	-	7.886	35.436	410
Tiranë	-	-	63.892	292.125	-
Vlorë	-	-	18.203	67.791	-
Shqipëria	38.414	270	158.783	645.654	1.036

Burimi: INSTAT Anketa e mbetjeve urbane

Fig 14.1 Trajtimi i mbetjeje sipas mënyrës të trajtimit në tonë, Shqipëri, 2023



Burimi: INSTAT Anketa e mbetjeje urbane

Mbetje të menxhuara sipas bashkive

Në vitin 2023, u menaxhuan afërsisht 843 mijë tonë mbetje urbane nga të gjitha bashkitë e vendit. Bashkitë me sasinë me të lartë të mbetjeje të menaxhuara ishin Tirana me 246.139 tonë, Durrësi me 63.010 tonë dhe Vlora me 60.000 tonë. Ndërkohë që bashkitë me sasinë më të ulët të mbetjeje të menaxhuara ishin Klosi me 651,0 tonë, Finiqi me 645,0 tonë dhe Fushë-Arrëz me 590,0 tonë.

Tab 14.2 Totali i mbetjeve të menxhuara sipas bashkive, 2023

Qarku / Bashki	Mbetje te menaxhuara(tonë)	% referuar totalit te menaxhuar
Berat	35.679	4,23
Berat	17.821	2,11
Dimal	6.679	0,79
Kuçovë	8.460	1,00
Poliçan	1.168	0,14
Skrapar	1.551	0,18
Dibër	18.857	2,24
Bulqizë	4.300	0,51
Dibër	9.425	1,12
Mat	4.472	0,53
Klos	660	0,08
Durrës	92.494	10,96
Durrës	67.094	7,95
Shijak	7.300	0,87
Krujë	18.100	2,15
Elbasan	46.113	5,47
Peqin	3.587	0,43
Belsh	2.061	0,24
Elbasan	29.345	3,48
Gramsh	2.163	0,26
Librazhd	2.969	0,35
Prrenjas	2.369	0,28
Cërrik	3.619	0,43
Fier	47.691	5,65
Fier	24.000	2,84
Patos	2.725	0,32
Roskovec	2.342	0,28
Mallakastër	3.060	0,36
Divjakë	4.048	0,48
Lushnjë	11.516	1,37
Gjirokastër	17.728	2,10
Gjirokastër	5.823	0,69
Dropull	1.600	0,19
Këlcyrë	1.210	0,14
Libohovë	1.320	0,16
Memaliaj	720	0,09
Përmet	4.500	0,53
Tepelenë	2.555	0,30


vazhdon

Qarku / Bashki	Mbetje te menaxhuara(tonë)	% referuar totalit te menaxhuar
Korçë	42.526	5,04
Korçë	17.142	2,03
Maliq	6.280	0,74
Pustec	847	0,10
Pogradec	12.920	1,53
Kolonjë	1.532	0,18
Devoll	3.805	0,45
Kukës	19.986	2,37
Has	1.760	0,21
Kukës	13.380	1,59
Tropojë	4.846	0,57
Lezhë	37.148	4,40
Kurbin	13.200	1,56
Lezhë	20.070	2,38
Mirditë	3.878	0,46
Shkodër	43.726	5,18
M.Madhe	2.507	0,30
Pukë	2.000	0,24
Shkodër	34.048	4,04
Vau-Dejës	4.536	0,54
Fushë-Arrëz	635	0,08
Tiranë	355.712	42,16
Tiranë	249.820	29,61
Vorë	14.078	1,67
Kamëz	34.942	4,14
Kavajë	33.704	4,00
Rrogozhinë	23.168	2,75
Vlorë	85.961	10,19
Vlorë	60.000	7,11
Selenicë	5.259	0,62
Himarë	5.282	0,63
Sarandë	12.858	1,52
Delvinë	1.147	0,14
Konispol	700	0,08
Finiq	715	0,08
Shqipëria	843.621	100

*Në totalin e menaxhuar sipas bashkive nuk janë përfshirë mbetjet spitalore,këto të dhëna disponohen vetëm në rang qarku

Burimi: INSTAT Anketa e mbetjeje urbane

Harta 14.1 Sasia e përgjithshme e mbetjeve të menxhuara sipas bashkive, 2023



Burimet e të dhënave

Statistikat e mbetjeve urbane paraqesin të dhëna vjetore për mbetjet e gjeneruara nga familjet dhe të ngjashme me ato si dhe trajtimin e tyre. Klasifikimet, përkufizimet dhe treguesit standardë statistikorë të përdorur përcaktohen nga kërkesat Shqiptare dhe legjislacioni evropian, duke zbatuar rregulloret përkatëse. Të dhënat e mbetjeve për vitin 2023 janë mbledhur nga INSTAT direkt nga bashkitë. Në vitin 2020, INSTAT aplikoi për herë të parë metodën inovative të pyetësorëve "online" për të gjitha bashkitë. Kjo metodë e re ishte një hap përpara për të prodhuar dhe zëbërthyer treguesit përkatës mjedisorë jo vetëm në nivelin kombëtar, por edhe në atë rajonal dhe bashkiak.

Përkufizime

Mbetjet urbane: Çdo substancë ose objekt që mbajtësi dëshiron të hedhë ose i kërkohet të hedhë. Mbajtësit i heqin këto materiale fizike nga vetja, duke humbur kështu çdo interes konkret pavarësisht vlerës që substancat ose objektet mund të mbajnë në kohën e braktisjes. Mbetjet urbane janë të dallueshme nga mbetjet e gjeneruara nga aktivitetet ekonomike.

Menaxhimi i mbetjeve: Të gjitha aktivitetet dhe veprimet e kërkuara për të menaxhuar mbetjet nga fillimi i tij deri në asgjësimin përfundimtar. Kjo përfshin mbledhjen, transportimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve, përfshirë monitorimin dhe rregullimin e procesit të menaxhimit të mbetjeve.

Trajtimi i mbetjeve: Metodatat kryesore të trajtimit të mbetjeve gjatë menaxhimit të tyre.

Ato mund të përfshijnë ; ruajtjen, riciklimin, transformimin ose eliminimin e mbetjeve.



DCA

+0.15 High / Low

Deal 27,228

539.24 +2.35
1,528.50 -7.9

0.75
0.63

ime
500
100
500

(Derivative)

FINANCAT PUBLIKE

15



Hyrje

Qeverisja vendore luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në zhvillimin ekonomik vendor por edhe në atë kombëtar.

Ky kapitull pasqyron të dhëna mbi financat publike dhe përdorimin e tyre në mënyrë sistematike dhe transparente. Menaxhimi i këtyre financave në mënyrë efikase ka si qëllim kryesor uljen e nivelit të pabarazisë ndërmjet bashkive dhe rritjen e nivelit të shërbimeve të ofruara.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVQV) janë bashkitë dhe qarqet. Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, ndërsa Qarku është njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore. Me miratimin e ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive vendore në Republikën e Shqipërisë”, ndarja e re territoriale përcakton si njësi të qeverisjes vendore 61 bashki dhe 12 qarqe.

Funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Funksionet bazë të njësive të vetëqeverisjes vendore janë në fushën e:

- Infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
- Shërbimeve sociale;
- Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- Mbrojtjes së mjedisit;
- Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit;
- Zhvillimit ekonomik vendor;
- Sigurisë publike;
- Funksioneve dhe kompetencat e deleguara.

Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore. Në fondet e transferuara nga qeverisja qendrore përfshihen transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike për funksionet e reja që i transferohen Bashkisë.

Burimi i të dhënave për financat publike për njësitë e vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë (Bashkitë) është Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), Drejtoria e Financave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave. Treguesit e financave publike të njësive të vetëqeverisjes vendore në nivel qarku zënë një pjesë shumë më të vogël krahasuar me ato në nivel bashkie, (shih Tabelat 15.4 dhe 15.5).

Karakteristika të përgjithshme për financat publike vendore

Financat publike vendore janë thelbësore për një qeverisje sa më të mirë dhe të pavarur. Disa prej treguesve më të rëndësishëm që shprehin zhvillimin social-ekonomik të një njësie të qeverisjes vendore janë:

- Madhësia e buxhetit të bashkive dhe qarqeve;
- Të ardhurat gjithsej të bashkive dhe qarqeve sipas burimit të financimit;
- Shpenzimet gjithsej të bashkive dhe qarqeve sipas burimit të financimit;
- Shpenzimet gjithsej të bashkive dhe qarqeve sipas funksionit (COFOG);
- Investimet gjithsej sipas bashkive dhe qarqeve.

Pozicioni i Bashkisë Tiranë në Republikën e Shqipërisë

Bashkia e Tiranës, është një ndër bashkitë më të mëdha nga 61 njësitë e qeverisjes vendore. Disa nga faktorët kryesorë që e veçojnë nga bashkitë e tjera janë:

- Këtu janë të pozicionuara shumica e institucioneve qeveritare, si dhe zyrat qendrore të shoqërive më të rëndësishme.
- Janë të përqendruara disa prej sektorëve kryesorë të ekonomisë si: dega e ndërtimit, tregtisë, administratës publike, shërbimeve (bankat, sigurimet, si dhe telekomunikacioni), etj.
- Niveli mesatar i pagave të punonjësve është më i lartë në krahasim me ato të punonjësve të bashkive të tjera.
- Fluksi hyrës i punonjësve që vijnë nga bashkitë e tjera për qëllime pune.


Madhësia e buxhetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore

Burimet financiare të disponueshme për shumicën e bashkive rezultojnë të jenë rritur në terma nominalë vitet e fundit. Madhësia e buxhetit të përgjithshëm të bashkive për vitin 2023 është rritur me 36,3% në terma nominalë krahasuar me vitin 2022. Shpërndarja e buxhetit vendor ndërmjet bashkive evidenton qartë diferencat ndërmjet tyre në terma nominalë, duke segmentuar bashkinë e Tiranës si entitetin me buxhetin më të lartë krahasuar me bashkitë e tjera (Figura 15.1).

Krahas rritjes në terma nominalë të nivelit të buxhetit mesatar, gjerësia e variacionit (diferencës mes vlerës minimale dhe maksimale) ndërmjet bashkive është zgjeruar ndjeshëm. Këto diferenca vlerësohet të jenë të ndikuara kryesisht nga popullsia dhe numri i ndërmarrjeve të përqendruara në një territor të caktuar.

Në Figurën 15.1 paraqiten të ardhurat e përgjithshme të mbledhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të ndara në bashki të tjera (60 njësi) dhe pjesa që zë Bashkia e Tiranës (1 njësi) në raport me buxhetin gjithsej. Madhësia e buxhetit të bashkisë Tiranë në raport me buxhetin gjithsej të të gjithë bashkive ishte 34,1% për vitin 2023 ndërsa për vitin 2022 ishte 34,9%.

Fig 15.1 Madhësia e buxhetit të bashkisë Tiranë krahasuar me buxhetin gjithsej të të gjithë bashkive, vitet 2018-2023




Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Në figurën 15.2 është paraqitur buxheti i njërive të vetëqeverisjes vendore (60 njësi) dhe nuk është përfshirë Bashkia Tiranë, duke e konsideruar si rast të veçantë (outlier).

Bashkitë me buxhetin më të lartë paraqiten: Bashkia Durrës, Kamëz, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Kavajë, Fier dhe Kurbin. Ndërsa bashkitë me buxhetin më të ulët paraqiten: Bashkia Pustec, Libohovë, Këlcyrë, Konispol, Delvinë, Dropull, Fushë-Arrëz dhe Memaliaj. Bashkitë e tjera janë pothuajse në të njëjtin nivel të shpërndarjes së buxhetit të disponueshëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Fig 15.2 Madhësia e buxhetit në % sipas bashkive (nuk përfshihet Bashkia Tiranë), viti 2023




Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Në figurën 15.3 është paraqitur buxheti sipas qarqeve (12 njësi). Qarqet me buxhetin më të lartë janë: Tiranë, Durrës, Lezhë, Elbasan, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, ndërsa qarqet e tjera kanë një buxhet të tyre pothuajse në të njëjtin nivel, ku buxhetin më ulët e ka Qarku Berat ndjekur nga Qarku Kukës.

Fig 15.3 Madhësia e buxhetit në % të qarqeve, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Të ardhurat për njësitë e vetëqeverisjes vendore

Të ardhurat që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore duke përfshirë të ardhurat nga burimet e veta dhe transfertat e buxhetit qendror, janë 63,4 miliard Lekë për vitin 2022 dhe 86,3 miliard Lekë për vitin 2023, duke shënuar një rritje në terma nominale prej 36,1% për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Tabela 15.1 më poshtë, tregon të ardhurat nga burimet e veta dhe transfertat e buxhetit qendror që përbëjnë përbëjnë 2,95% për vitin 2022 dhe 3,64% për vitin 2023. Të ardhurat publike për njësitë e vetëqeverisjes vendore ndaj të ardhurave publike gjithsej në nivel vendi përbëjnë 11,07% për vitin 2022 dhe 13,41% për vitin 2023.

Tab 15.1: Të ardhurat publike gjithsej për njësitë e vetëqeverisjes vendore, në raport me të ardhurat publike gjithsej dhe PBB-në, 2019-2023

Year	Totali i të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore	Totali i të ardhurave publike gjithsej	Prodhimi i Brendshëm Bruto	Pesha që zënë të ardhurat e NJVQV ndaj totalit të të ardhurave publike gjithsej	Pesha që zënë të ardhurat për NJVQV ndaj PBB-së
	(Në milion Lekë)	(Në milion Lekë)	(Në milion Lekë)	(Në %)	(Në %)
2019	52.418	460.349	1.712.037	11,39%	3,06%
2020	52.555	425.905	1.655.984	12,34%	3,17%
2021	59.885	510.572	1.866.674	11,73%	3,21%
2022	63.412	572.790	2.149.741	11,07%	2,95%
2023*	86.313	643.678	2.369.906	13,41%	3,64%

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Të ardhurat nga burimet e veta janë thelbësore për një qeverisje vendore të mirë dhe të pavarur. Të ardhurat e njësive të qeverisjes vendore, sipas burimit të financimit në nivel bashkie, janë të klasifikuara në disa kategori kryesore si më poshtë:

- Të ardhurat tatimore të njësive vendore;
- Të ardhura jo tatimore (ku bëjnë pjesë të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia; të ardhura nga shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare);
- Transferta dhe të ardhura të tjera (ku bëjnë pjesë të ardhurat nga transfertat e buxhetit qendror; të ardhura të jashtëzakonshme).


Pjesën më të madhe të të ardhurave bashkitë e marrin nga qeveria qendrore, të klasifikuara në kategorinë “transferta dhe të ardhura të tjera”. Përjashtim bëjnë: Bashkia Tiranë, Bashkia Himarë dhe Bashkia Sarandë, ku të ardhurat nga “grantet dhe të ardhura të tjera” janë më të ulëta krahasuar me “të ardhurat tatimore” dhe ato “jo-tatimore”.

Zgjerimi i hendeut të të ardhurave sipas burimit të financimit, nuk është një fenomen i shtrirë në mënyrë homogjene ndërmjet bashkive, por është i udhëhequr nga ecuria e të ardhurave nga burime të veta në një numër të kufizuar bashkish dhe nën efektin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe nga ndërtimet e reja.

Më poshtë janë paraqitur të dhënat mbi të ardhurat e njësive të qeverisjes vendore (bashkitë), sipas burimit të financimit në nivel bashkie dhe sipas rajoneve statistikore nivel NUTS 2 (shih Figura 15.4, 15.5 dhe 15.6). Figura 15.7 paraqet vetëm pjesën e të ardhurave të qarqeve sipas burimit të financimit.

2023* PBB gjysëm finale


Fig 15.4 Të ardhurat e bashkive sipas burimit të financimit, Rajoni Statistikor Veri, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT


Fig 15.5 Të ardhurat e bashkive sipas burimit të financimit, Rajoni Statistikor Qendër, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT


Fig 15.6 Të ardhurat e bashkive sipas burimit të financimit, Rajoni Statistikor Jug, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Fig 15.7 Të ardhurat e qarqeve sipas burimit të financimit, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Pjesën më të madhe të të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, qarqet e marrin nga qeveria qendrore nën kategorinë "grante dhe të ardhura të tjera". Vërehet se të ardhurat e realizuara nga qarqet varen nga transfertat e qeverisjes qendrore përveç Qarkut Lezhë ku të ardhurat e klasifikuara nën kategoritë "të ardhurat tatimore" dhe ato "jo-tatimore" zënë një peshë shumë të vogël (shiko Figurën 15.7).

Shpenzimet për njësitë e vetëqeverisjes vendore

Shpenzimet gjithsej të vetëqeverisjes vendore rezultojnë të jenë rritur nga 58,7 miliard Lekë për vitin 2022 në 69,2 miliard Lekë për vitin 2023, duke shënuar një rritje në terma nominale prej 17,95% për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Tabela 15.2 më poshtë, tregon se shpenzimet për njësitë e vetëqeverisjes vendore përbëjnë 2,73% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2022 dhe 2,92% për vitin 2023. Shpenzimet për njësitë e vetëqeverisjes vendore ndaj shpenzimeve publike në nivel vendi përbëjnë 9,02% për vitin 2022 dhe 10,26% për vitin 2023.

Tab 15.2: Shpenzimet publike gjithsej për njësitë e vetëqeverisjes vendore, shpenzimeve publike gjithsej dhe PBB, 2019-2023

Viti	Totali i shpenzimeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore	Totali i shpenzimeve publike gjithsej	Prodhimi i Brendshëm Bruto	Pesha që zënë shpenzimet e NJVQV ndaj totalit të shpenzimeve publike gjithsej	Pesha që zënë shpenzimet e NJVQV ndaj PBB-së
	(Në milion Lekë)	(Në milion Lekë)	(Në milion Lekë)	(Në %)	(Në %)
2019	56.227	491.897	1.712.037	11,43%	3,28%
2020	51.627	536.507	1.655.984	9,62%	3,12%
2021	52.593	595.968	1.866.674	8,82%	2,82%
2022	58.696	651.015	2.149.741	9,02%	2,73%
2023*	69.233	674.857	2.369.906	10,26%	2,92%

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT


2023* PBB gjysëm finale

Të dhënat mbi shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore, sipas burimit të financimit në nivel bashkie, janë të ndara në dy kategori kryesore:

- Shpenzime të kryera me fonde të veta të bashkive (ku përfshihen të ardhurat nga burimet e veta, taksat e ndara);
- Shpenzime të kryera nga transfertat e pakushtezuar e pergjithshme dhe sektoriale.

Më poshtë janë paraqitur të dhënat mbi shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore (bashkitë), sipas burimit të financimit në nivel bashkie dhe sipas rajoneve statistikore nivel NUTS 2 (shih Figurën 15.8, 15.9 dhe 15.10). Figura 15.11 paraqet vetëm pjesën e shpenzimeve të qarqeve sipas burimit të financimit.


Fig 15.8 Shpenzimet e bashkive sipas burimit të financimit, Rajoni Statistikor Veri, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT


Fig 15.9 Shpenzimet e bashkive sipas burimit të financimit, Rajoni Statistikor Qendër, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT


Fig 15.10 Shpenzimet e bashkive sipas burimit të financimit, Rajoni Statistikor Jug, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Fig 15.11 Shpenzimet e qarqeve sipas burimit të financimit, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Shpenzimet për njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas funksionit të qeverisë (COFOG)

Të dhënat lidhur me shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore sipas funksioneve të qeverisë, në nivel bashkie, janë të ndara në 10 kategori kryesore:

01. Shërbimet e përgjithshme publike
02. Mbrojtja
03. Rendi dhe siguria publike
04. Çështjet ekonomike
05. Mbrojtja e mjedisit
06. Strehimi dhe komoditetet e komunitetit
07. Shëndetësia
08. Argëtimi, kultura dhe feja
09. Arsimi
10. Mbrojtja sociale

Nga të dhënat për vitin 2023 të klasifikuara në 10 kategori kryesore, vërehet se njësitë e vetëqeverisjes vendore pjesën më të madhe të shpenzimeve e kryejnë për kategoritë “Çështjet ekonomike” me 21,0%, “Shërbimet e përgjithshme publike” me 20,3%, “Arsimi” me 18,6%, “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit” me 15,6%, “Mbrojtja e mjedisit” me 9,4%, dhe “Argëtimi, kultura dhe feja” me 6,1% ndaj shpenzimeve publike gjithsej të vetëqeverisjes vendore.

Tab 15.3 Struktura e shpenzimeve publike të vetëqeverisjes vendore sipas funksionit

Shpenzimet e bashkive sipas funksioneve të qeverisë (cofog)	Viti 2023
01 Shërbimet e përgjithshme publike	20,3%
02 Mbrojtja	0,0%
03 Rendi dhe siguria publike	5,3%
04 Çështjet ekonomike	21,0%
05 Mbrojtja e mjedisit	9,4%
06 Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	15,6%
07 Shëndetësia	0,1%
08 Argëtimi, kultura dhe çështjet fetare	6,1%
09 Arsimi	18,6%
10 Mbrojtja sociale	3,6%
Gjithsej	100,0%


Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Shpenzimet sipas funksionit për kategoritë: “Mbrojtja sociale”, “Rendi dhe siguria publike”, “Shëndetësia”, dhe “Mbrojtja” janë shpenzime të cilat kryhen kryesisht nga qeveria qendrore, dhe për këtë arsye shpenzimet për këto kategori mungojnë ose zënë një pjesë shumë të vogël ndaj shpenzimeve publike gjithsej të vetëqeverisjes vendore.

Më poshtë janë paraqitur të dhënat mbi shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore (bashkitë), sipas funksioneve të qeverisë, në nivel bashkie dhe sipas rajoneve statistikore nivel NUTS 2 (shih Figurën 15.12, 15.13 dhe 15.14). Figura 15.15 paraqet vetëm pjesën e shpenzimeve të qarqeve sipas funksioneve të qeverisë.


Fig 15.12 Shpenzimet e bashkive sipas funksioneve të qeverisë (COFOG-eng), Rajoni Statistikor Veri, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT


Fig 15.13 Shpenzimet e bashkive sipas funksioneve të qeverisë (COFOG-eng), Rajoni Statistikor Qendër, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Fig 15.14 Shpenzimet e bashkive sipas funksioneve të qeverisë (COFOG-eng), Rajoni Statistikor Jug, viti 2023




Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore sipas funksioneve të qeverisë për secilën bashki, kanë karakteristika të ndryshme, megjithatë, shumica e tyre pjesën më të madhe të shpenzimeve e kryejnë kryesisht për kategoritë: “Shërbimet e përgjithshme publike”, “Çështjet ekonomike”, “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit” dhe “Arsimi”.

Pjesa tjetër e shpenzimeve, për nga rëndësia, shkojnë për kategoritë: “Argëtimi, kultura dhe çështjet fetare”, “Mbrotjtja sociale”, “Mbrotjtja e mjedisit”. Shpenzimet për kategorinë “Mbrotjtja” nuk ekzistojnë në nivel vendor për shkak se ky është një funksion plotësisht qendror.

Fig 15.15 Shpenzimet e qarqeve sipas funksioneve të qeverisë (COFOG-eng), viti 2023



Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Nga të dhënat për vitin 2023 të klasifikuara në 10 kategori kryesore, vërehet se njësitë vendore, qarqet pjesën më të madhe të shpenzimeve kryejnë kryesisht për kategoritë “Shërbimet e përgjithshme publike”, ndërsa për funksione të tjera janë të shpërndara në varësi të nevojave për shpenzime të planifikuara në fillim të vitit.


Investimet për njësitë e vetëqeverisjes vendore

Investimet publike të kryera nga bashkitë rezultojnë të jenë rritur vitin e fundit. Investimet publike gjithsej të njësive të vetëqeverisjes vendore (bashkive) për vitin 2023 rezultojnë me një rritje me 38,2% në terma nominalë krahasuar me vitin 2022.

Në figurën 15.16 janë paraqitur shpenzimet për investimet e realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të ndara në: bashki të tjera (60 njësi), dhe bashkia Tiranë (1 njësi) në raport me investimet gjithsej.

Investimet në Bashkinë Tiranë në raport me investimet gjithsej të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2022 ishte 28,2%, ndërsa për vitin 2023 janë 35,4%. Investimet në bashkitë e tjera në raport me investimet gjithsej për vitin 2022 ishin 71,8%, ndërsa për vitin 2023 rezultojnë 64,6%.

Fig 15.16 Investimet në Bashkinë Tiranë ndaj investimeve gjithsej të bashkive, vitet 2018-2023




Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Figura 15.17 paraqet shpërndarjen e investimeve publike sipas bashkive (60 njësi) ku nuk është përfshirë Bashkia e Tiranës. Tirana është konsideruar si rast i veçantë (outlier), pasi investimet zënë 35,4% ndaj investimeve gjithsej të njësive të qeverisjes vendore.

Shpërndarja e investimeve evidenton qartë diferencat ndërmjet bashkive më të mëdha dhe atyre të vogla (duke pasur parasysh sipërfaqen dhe popullsinë). Bashkitë me buxhetin më të lartë për investime të kryera paraqiten: Bashkia Kamëz, Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Lezhë. Bashkitë me investimet më të ulëta të kryera paraqiten: Bashkia Libohovë, Tepelenë, Këlcyrë, Pustec dhe Peqin.

Fig 15.17 Investimet publike në % sipas bashkive (nuk përfshihet Bashkia Tiranë), viti 2023




Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Figura 15.18 janë paraqitur investimet sipas qarqeve (12 njësi). Qarqet me investimet më të larta janë: Qarku Berat, Vlorë, Korçë, Durrës, Shkodër dhe Tiranë. Ndërsa, në qarqet e tjera investimet për vitin 2023 janë pothuajse në të njëjtin nivel, ku nivelin më të ulët e ka Qarku Dibër ndjekur nga qarku Kukës.

Fig 15.18 Investimet publike në % sipas qarqeve, viti 2023



Burimi: Ministria e Financave
Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Tab 15.4 Të ardhurat, shpenzimet dhe investime gjithsej sipas bashkive, viti 2023

Bashki	Totali i të ardhurave sipas bashkive	Totali i shpenzimeve sipas bashkive	Totali i investimeve sipas bashkive
	Në milion Lekë	Në milion Lekë	Në milion Lekë
Belsh	310	350	114
Berat	1.169	1.243	300
Bulqizë	632	647	206
Cërrik	457	460	127
Delvinë	203	189	21
Devoll	512	506	94
Dibër	1.062	1.004	169
Divjakë	583	534	88
Dropull	233	252	78
Durrës	7.353	3.547	843
Elbasan	2.426	2.415	388
Fier	2.106	1.966	294
Finiq	319	334	106
Fushë-Arrëz	248	210	21
Gramsh	580	566	151
Gjirokastrë	768	808	179
Has	347	318	29
Himarë	859	694	318
Kamëz	4.303	2.882	1.537
Kavajë	2.195	1.036	64
Këlcyrë	175	150	14

Vazhdon

Bashki	Totali i të ardhurave sipas bashkive	Totali i shpenzimeve sipas bashkive	Totali i investimeve sipas bashkive
	Në milion Lekë	Në milion Lekë	Në milion Lekë
Klos	321	302	94
Kolonjë	363	360	59
Konispol	183	182	31
Korçë	1.720	1.737	202
Krujë	1.419	879	232
Kuçovë	580	576	159
Kukës	890	842	161
Kurbini	1.788	594	76
Lezhë	1.519	1.346	373
Libohovë	112	103	4
Librazhd	702	780	322
Lushnje	1.372	1.213	189
Malësi e Madhe	710	694	238
Maliq	755	735	186
Mallakastër	554	615	229
Mat	586	596	123
Memaliaj	261	247	30
Mirditë	1.059	442	38
Patos	531	552	196
Peqin	400	372	18
Përmet	341	427	155
Pogradec	1.161	1.194	150
Polican	356	272	45
Prrenjas	461	427	107
Pukë	322	288	30
Pustec	105	90	16
Rogozhinë	586	442	78
Roskovec	483	451	146
Sarandë	1.140	947	226
Selenicë	423	419	150
Skrapar	375	348	21
Shijak	631	434	77
Shkodër	2.321	2.068	387
Tepelenë	268	276	7
Tiranë	29.138	22.883	5.710
Tropojë	464	447	100
Dimal	460	447	132
Vau Dejës	535	559	136
Vlorë	2.308	1.925	191
Vorë	962	714	186
Gjithsej	85.505	68.336	16.151

Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

Tab 15.5 Të ardhurat, shpenzimet dhe investimet gjithsej, sipas Qarqeve, viti 2023

Qarku	Totali i të ardhurave të qarqeve	Totali i shpenzimeve të qarqeve	Totali i investimeve të qarqeve
	Në milion Lekë	Në milion Lekë	Në milion Lekë
Berat	43	112	90
Dibër	46	30	-
Durrës	85	88	52
Elbasan	84	50	10
Fier	49	41	14
Gjirokastrë	46	50	4
Korçë	73	104	65
Kukës	45	44	3
Lezhë	85	44	8
Shkodër	72	141	47
Tiranë	110	80	44
Vlorë	70	110	70
Gjithsej	808	896	408

Burimi: Ministria e Financave

Përpunuar të dhënat: Sektori i Administratës Publike Qendrore, INSTAT

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Statistikave

Vjetari statistikor rajonal 2024 : Qarqe dhe Bashki
/ Instituti i Statistikave ; drejt. bot. Elsa Dhuli. -
Tiranë : INSTAT, 2025.

.
.. f. : me il. ; ... cm.

ISBN 9789928390202

1.Statistika 2.Vjetarë statistikorë 3.Shqipëri

311.312(496.5) "2024" (058)

VJETARI 2024

Statistikor Rajonal

Q A R Q E D H E B A S H K I



9 789928 390202